ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 17 DHJETOR 2022. NUMËR 212 VITI V I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Dom Nikë Ukgjini është meshtar katolik me formim të thelluar në histori; shqiptar i Malit të Zi i cili prej dekadash shërben në famullinë e Kuklit, vendi ku shërbeu edhe Ndre Mjeda e ku u shkrua pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij. Dom Nika ka punuar pareshtur për ringritjen e ndërtesës ku ka jetuar Mjeda dhe kishës pranë duke krijuar kështu *Qendrën Muzeore "Ndre Mjeda"* në kuadër të së cilës bëhen disa aktivitete si *Ditët e Mjedës* dhe botohet një revistë shkencore, "Mjedologji".

Me Dom Nikë Ukgjinin për *mjedologjinë*, familjen e gazullorëve dhe Kuvendin e Arbnit

Së fundmi, Ukgjini ka bërë të mundur realizmin e *Kompleksit Përkujtimor të Gazullorëve* si dhe, falë këmbënguljes së tij, po rindërtohet *Kisha e Shën Gjon Kryepremit* në Mërqi të Lezhës, vendi ku u mbajt *Kuvendi i Arbnit* më 1703.

Bisedoi Andreas Dushi

EPISODI I KATËRT:

MES VIZIONESH DHE FIGURASH AMËSORE. FRAGMENTET E ORNELA VORPSIT.

Nga Dr. Fabio M. Rocchi

Ornela Vorpsi ka shkruar në gjuhën italiane pjesën e parë të krijimtarisë së vet. Librat e parë dallohen për një zgjedhje shprehëse – e deklaruar disa herë nga vetë autorja si e pashmangshme – që ka privilegjuar gjuhën italiane për t'i dhënë zë botës së brendshme.

(fq. 6)

PROFILE MJEDOLOGËSH

Nga Prof. dr. Alfred Çapaliku

Shkenca e mjedologjisë nis më 1917, në Shkodër, me recensionin e At Gjergj Fishtës te gazeta "Posta e Shqypnis" për vëllimin poetik "Juvenilia". Kritiku letrar vuri re gjuhën e pastër, shquajti stilin e lartë dhe gjeti figurat e gjalla plot njomësi: *"Autori para se me e botue veprën e vet, e ka përshkue kushedin sa herë nën limë të mëndjes e të teknikës. Prandaj kjo vepër ka me kenë domosdo e nevojshme me u perdorue si tekst ndër shkolla të Shqypnis."*

(fq. 4)

Ligjërata e Nobelit për letërsinë

ANNIE ERNAUX

Nuk e shoh si fitore individuale çmimin Nobel që më është blatuar

(fq. 19)

SHËNIME MBI LIBRAT

Zija Çela vjen me romanin e ri "Banka e Ankesave"

NJË "BANKË" PLOT ME THESARE LETRARE

Nga Xheladin A. Çitaku

(fq. 5)

ZHGËNJIMI SI PIKA E TAKIMIT DHE PIKA E NDARJES MES "ILUZIONE TË HUMBURA" DHE "KOMEDIANIA"

Nga Noeh Pantalija

(fq. 9)

Shënime për librin "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë"

YLLI ÇABIRI MES SAMIUT E KONICËS

Nga Ilir Mborja

(fq. 8)

NJË VEPËR FABULARE E FERIT LAMAJT KUSHTUAR KADARESË

Nga Astrit Bishqemi

(fq. 10)

100-vjetori i botimit të parë

"ULIKSI" I XHOJSIT-ROMANI "KATEDRALE"

nga Feride Papleka

(fq. 21)

BIBLIOTEKË

Mieko Kawakami *(fq. 16)*
Gjinj dhe vezë

Qazim Shehu *(fq. 13)*
Dy tregime

Sadedin Mezuraj *(fq. 15)*
Lundërtar i vonuar

Elivjana Shukulli *(fq. 20)*
Vjeshta nga sytë e gjethes

Një vështrim i shkurtër mbi romanin "Puthja e Amazonës" të Mira Meksit.

HIMN I DASHURISË PËR JETËN

Nga Artur Spanjolli

(fq. 12)

Rreth vëllimit me lirika "Nga çʼqiell ra trëndafili?" të S.Mezurajt

PËR SHKAK TË DASHURISË DHE VETËM ASAJ

Nga Alisa Velaj

(fq. 14)

Besnik Mustafaj: "Letrat e mia kredenciale (një rrëfim me Arta Markun")

ANAMNEZA E KRIJIMIT...

Nga Jusuf Buxhovi

(fq. 11)

Dom Nikë Ukgjini është meshtar katolik me formim të thelluar në histori; shqiptar i Malit të Zi i cili prej dekadash shërben në famullinë e Kuklit, vendi ku shërbeu edhe Ndre Mjeda e ku u shkrua pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij. Dom Nika ka punuar pareshtur për ringritjen e ndërtesës ku ka jetuar Mjeda dhe kishës pranë duke krijuar kështu *Qendrën Muzeore "Ndre Mjeda"* në kuadër të së cilës bëhen disa aktivitete si *Ditët e Mjedës* dhe botohet një revistë shkencore, "Mjedologji".

Me Dom Nikë Ukgjinin për *mjedologjinë*, familjen e gazullorëve dhe Kuvendin e Arbnit

Së fundmi, Ukgjini ka bërë të mundur realizmin e *Kompleksit Përkujtimor të Gazullorëve* si dhe, falë këmbënguljes së tij, po rindërtohet *Kisha e Shën Gjon Kryepremit* në Mërqi të Lezhës, vendi ku u mbajt *Kuvendi i Arbnit* më 1703.

bisedoi Andreas Dushi

A.D: *Dom Nika, prej vitesh me radhë i jeni përkushtuar rinxjerrjes në dukje të personalitetit shumëdimensional të dom Ndre Mjedës. Me vështirësitë e zakonshme, shpesh në heshtjen e bezdisshme të atyre që mund e duhet t'ju ndihmonin, ja keni dalë të çoni thuajse nga asgjëja një kompleks fizik të Mjedës si dhe një tjetër shpirtëror – kulturor me një korpus botimesh cilësore. Cila qe shtysa fillestare dhe ku e gjetët forcën për ta përfunduar gjithë këtë projekt?*

N.U: Me ardhjen time për të vepruar në famullin e Kuklit në vitin 2007, krahas ëndrrave të mia që të bëja shkencë në fushën e historisë, këtu më lindi dhe një "ëndërr" tjetër e madhe, për të filluar punimet në rikonstruksionin e Kompleksit "Ndre Mjeda" në fshatin Kukël, komuna e Bushatit.

Meqë, Kisha dhe shtëpia (qela) ku ruhet pjesa më e madhe e jetës së poetit të "Vajit të bylbylit", "Shtegtarit", "Tringës", "Shkodrës", "Lissus", të projektuara dhe punuara nga ai vetë, ishin në degradim e sipër nga sistemi komunist, për shumë vite u përpoqa të gjeja rrugëdalje.

Pas shumë kërkesave për gjetjen e donatorëve që do ndihmonin në investimin e këtij projekti të hartuar nga ark. Zef Çuni, më në fund ajo u arrit duke bërë të mundur fillimin e punimeve në qershor të vitit 2011. Ata, të cilët i dhanë shtytje fillimit të punimeve janë mërgimtarë të Kuklit në Itali dhe ata nga Kosova e Mali i Zi, që jetonin në Amerikë, e të tjerë, cilët edhe pse jetonin larg, mbeten dashamirës të atdheut. Nga Shkodra duhet veçuar, sipërmarrësin Z. Gjergj Leqejza, i cili mbeti bashkudhëtar i imi në shtigjet restauruese të objekteve të tjera kulturorë gjatë viteve në vazhdim. Kisha e poetit e ndërtuar në vitin 1913 dhe gjithë ambienti përreth si dhe vendosja e shtatores së dom Ndreut në bronz u inauguruan më 1 gusht të vitit 2012. Pas grumbullimit të fondeve të tjera u arrit restaurimi edhe i shtëpisë dhe krijimi i muzeut e ku spikat tryeza e restauruar e poetit, duke i vendosur në dispozicion të vizitorëve në vitin 2014.

A.D: *Një shkencë e re në fushën e filologjisë shqipe është edhe mjedologjia, studimi i Mjedës. Ajo është mbështetur shumë fort nga ju, por kur e diskutoj me miq, të njohur madje edhe persona të fushës, shoh se nuk njihet gjerësisht. Objektin e saj e thamë, Dom Ndre Mjeda. Po pikarritjet më të çmuara cilat janë dhe, mendoni se ajo është aty ku duhet, meriton e mbi të gjitha, aty ku takon?*

N.U: Ideja e mbajtjes së takimeve "Ditët e Mjedës" e hedhur nga një grup intelektualësh nga Shkodra u konkretizua në ditën përkujtimore të vdekjes së poetit, me 1 gusht 2011 dhe datëlindjes së Mjedës, më 20 nëntor, organizuar nga *Qendra e Studimeve Albanologjike* në Tiranë. *Ditët e Mjedës*, të organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeore *Ndre Mjeda* dhe Komuna Bushat, vazhduan të mbaheshin edhe në vitin në vazhdim.

Më 1 gusht 2012, nga këto tri subjekte, u organizua në Bushat Konferenca Shkencore për Mjedën, më pjesëmarrjen e studiuesve nga Shkodra, Tirana, Kosova dhe Maqedonia. Ndërsa në orët e pasdites në Kukël u zhvillua përurimi i Qendrës dhe i shtatores së Mjedës. Me këtë rast lindi ideja që krahas krijimit të Qendrës kushtuar poetit, të botohej dhe një revistë e cila do përmbante materiale studimore e kulturore që kanë te bëjmë për poetin Mjeda, duke e titulluar thjesht "Mjedologji". Numri i parë do startonte në vitin 2014, më botimin e të gjitha materialeve studimore, gjithsej njënjëzet të dala nga Konferenca e vitit 2012, botim i Qendrës se Studimeve Albanologjike e Qendrës Muzeore Ndre Mjeda. Deri tani kemi nxjerrë në dritë pesë vëllime, ku i fundi është kushtuar letërsisë për fëmije të Ndre Mjedës, botim i Qendrës sonë dhe Departamenti të Gjuhës e Letërsisë të Universitetit te Shkodrës. Revista duke qenë prodhim i qarqeve studimore, qoftë më parë i Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe tani i departamentit të lartcituar, ka arritur mjaftueshëm suksesin e vet si e tillë dhe krahas botimeve të ndryshme të autorëve të tjerë për Mjedën, plotëson boshllëkun e krijuar me vite me dashje apo pa dashje për personin shumëdimensional që aq shumë i dha të mira shqiptarisë.

A.D: *Kur u krijua kompleksi muzeal i Mjedës në Kukël, vendbanimin e vendshërbimin e tij, interesi ishte i madh. Studiues, madje edhe turistë apo pushtetarë vinin aty, me dëshirën për t'u thënë të tjerëve se e kishin vizituar. Po tani si e shihni interesin, vijon të jetë i njëjtë, ka rënie (nxitur ndoshta nga harresa e qëllimtë, gjëja më e keqe e mundshme)?*

N.U: Në vitin të 100-vjetoritë të ndërtimit të Kishës, realizuar nga poeti Mjeda në vitin 1913, pati aktivitete të ndryshme të organizuara nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeale *Ndre Mjeda* dhe Komuna e Bushatit. Ndër të tjera do veçoja më 11 maj në ambientet e Kishës u mbajt promovimi i 10 vëllimeve të monografisë seriale *Mjeda*, të autorit Mentor Quku. Puna e palodhur e Mentor Qukut për Mjedën është vlerësuar si kolosale, sepse ai i ka njohur lexuesit me fusha të panjohura deri m**ë** sot, me të cilat është marrë poeti Mjeda.

Qendra Muzeore ka qenë vazhdimisht në vëmendje të vizitorëve të shumtë, nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, nga Shkodra e Tirana, deri tek vizitat e ndryshme të piktorëve, skulptorëve, aktorëve të filmave, studiuesve, diplomatëve të huaj dhe vendas. Qendra është vazhdimisht në fokusin e mediave pamore kombëtare dhe medias së shkruar në Shqipëri dhe Kosovë. Ajo është bërë objekt studimi për shumë studentë nga Universitetet shtetërore e private nga Shkodra e Tirana. Kukli, ku poeti kaloi tredhjet vite të jetës, nga vend i lënë pas dore, tani është shndërruar në një vatër të rëndësime kulturore gjithëkombëtare. Edhe pse poeti Mjeda ende nuk ka një varr, ngritja e kësaj Qendre është një klithmë për strukturat e lidhura me kulturën, shkencën, arsimin, për të qenë sa më të ndërgjegjshëm në përhapjen e kësaj figure të madhe që na nderon para botës së qytetëruar.

Qendra në vitin 2016 është regjistruar si pasuri Kombëtare me emërtim "Shtëpia muze Ndre Mjeda".

A.D: *Pak ditë më parë, nën organizimin tuaj u mbyll edicioni XI i Ditëve të Mjedës që edhe u përmend pak më parë. Si ja ka dalë të mbijetojë kaq gjatë ky aktivitet si dhe, për këtë edicion, cilët ishin ato konkluzione interesante ku u arrit nëpërmjet kumtesave?*

N.U: Ditët e Mjedës mbahen që plotë njëmbëdhjetë vite më radhë më program të larmishëm kulturor e jo vetëm studimor. Me ketë rast do veçoja vizitën me 1 gusht të vitit 2016 të pjesëmarrëseve në Seminarin Ndërkombëtarë të 35, për gjuhen, letërsinë e kulturën shqiptare, që organizohet nga Fakultetit Filologjik i Prishtinës dhe Fakultetit Histori-Filologji i Tiranës, ku para studiuesve të huaj qe mbajtur kumtesa për veprën e Mjedës dhe shfaqja e filmit dokumentar "Andrra e Jetës" kushtuar poetit. Pra krahas programeve kulturore e argëtuese, mbahen dhe dy apo tre tema studimore që lidhen me veprimtarinë e poetit Mjeda. Sivjet me rastin e lindjes së Mjedës, pos prezantimit të pikave muzikore me violinçel, janë shpalosur kumtesa me këndvështrime të ndryshme, mbi *Profile Mjedologësh*; vlerën letrare të poezisë së Mjedës dhe kontributi i Mjedës në Pavarësinë e vendit tonë 1912. Pra flakadani "Ditët e Mjedës" jep mundësinë e shkëlqyer për takime të llojllojshme që kanë të bëjnë me jetën kulturore të Mjedës e të shqiptarëve në përgjithësi.

A.D: *Si historian, fusha juaj e studimeve të thelluara, keni studiuar gjerësisht ato fije identitare që përshkojnë epokat e ndryshme të Shqipërisë dhe, falë të cilave është arritur të ruhej diçka edhe në mesjetë apo të tjerë çaste tepër të errëta. Si e shihni sot studimin e historisë në tërësinë e saj, analizuar edhe me anë të zbulimeve më të reja? Po për trashëgiminë e kulturës sonë, kujt mendoni se duhet t'i apo t'u jemi më mirënjohës?*

N.U: Si meshtar i ri gjatë viteve 1981-1995, shërbeva në Plavë e Guci. Në një vend me shumë pak besimtar katolikë e më një pakicë shqiptaresh të besimit mysliman në krahasim më ata të tjerët që e quanin veten boshnjak, e ku në fakt në rrënjë ishin shqiptarë të islamizuar e sllavizuar në vitet e Kongresit të Berlinit (1878) e në vazhdim. Që atëherë kuptova se jeta e një meshtari duhet të jetë shumëplanëshe. Në shenjë të ringritjes të identitetit kombëtar, atje në vitin 1984 në qelën e famullisë, ngrita një muze etnografik më shumë eksponantë e ku

spikasnin veshjet kombëtare të shqiptarëve në Mal të Zi. Krahas etnografisë në mua u zgjua interesi edhe për fushën e historisë, jo vetëm të asaj zone, por për gjitha trevat ku jetonin shqiptaret në Mal të Zi. Ky zell e kjo nevojë për ta njohur me më thellësi të kaluarën tonë e sidomos atë të mesjetës më mbizotëroi edhe kur erdha në vitin 1995 për të shërbyer në Shqipëri. Puna ime studimore shumëvjeçare në këtë fushë kulmoi më mbrojtjen e doktoraturës pranë Universitetit të Zagrebit në vitin 2002.

Sa i përket situatës shkrimore të historisë, në vitin 2014 qe ringritur një grup pune me studiues vendas e të huaj, pranë Ministrisë se Arsimit dhe Sporti, për rishkrimin e historisë dhe rivlerësimin e figurave kombëtare. Një këshillë i ngjashëm, sa më kujtohet, ka qenë i ngritur formalisht edhe në kohën kur në pushtet ishin të djathtët. Ky këshill tentoi të bëjë një gjë të tillë, duke arritur t'i rishkruajë ca rreshta në librat shkollorë. Ky komision, për shkak të përbërjes se tij, pos zhurmës mediatike të krijuar, nuk arriti që idetë t'i ngulisë në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve këndej dhe andej kufirit. Siç duket, fjala latine "Quot homines, tot sententiae" (sa koka aq mendime), është akoma evidente te ne shqiptarët.

Tani pas një heshtjeje të gjatë kohore përsëri rizgjohet nevoja për rikomentime e rishkrime të historisë nga një grup pune i ngritur prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me studiues edhe nga Kosova, se çfarë dhe si ishte e kaluara jonë dhe roli i figurave kombëtare dhe letrare në këtë drejtim.

Duke pasur parasysh se historia është shkruar gjithherë nga pala fituese, qeveritë në pushtet apo kushtet rrethanore, është e drejtë dhe e pranueshme që gjërat të rishikohen edhe tani, por në mënyrë sa më të plotë dhe reale. Nuk do ndalesha duke hamendësuar se si ky komision do interpretojë ngjarjet e ndryshme historike, të cilat kanë qenë gjithherë të diskutueshme, por do përqendrohesha te shqetësimi, se si do pasqyrohej në librat studimore e shkollorë roli i Kishës Katolike në historinë e kombit tonë dhe nëse ato shkrime do të jenë reale dhe të paanshme. Të shkruash sa më reale, kjo do të thotë se duhet pasqyruar mirë kontributi i Kishës Katolike në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar sidomos gjatë pushtimeve të Perandorisë Osmane e cila tentoi dhunshëm ta zhdukte nga faqja e dheut Kishën Katolike ndër shqiptarë. Të shkruhet historia sa më reale do të thotë të vihet në pah i gjithë kontributi i klerit katolik gjatë rilindjes kombëtare, si: abat Preng Dochit, Dom Nikollë Kaçorrit, Dom Ndoc Nikajt, Dom Ndre Mjedës, Atë Gjergj Fishtës, Atë Anton Harapit, Atë Gjon Shllakut, Imzot Luigj Bumçit, Imzot Lazër Mjedës, Imzot Vinçenc Prenushit, etj., deri me ardhjen e mbreti Zog në pushtet i cili e "goetizoi" Kishën Katolike, duke i baraspeshuar me tri besimet të tjera, të cilat si institucione realisht kontribuuan shumë pak për nacionalizmin shqiptar. Duke pasur parasysh përbërjen e komisioneve këndej e andej kufirit, ku nuk figuron dhe emri i ndonjë kleriku të Kishës Katolike si ekspert i kësaj fushe, kam frikën se ky rishikim i historisë do përsërisë edhe kësaj here gabimet e komisioneve të mëparshëm. Kështu, historia kombëtare në librat studimorë e shkollorë edhe tani e tutje do vazhdojë të mbetet e zymtë dhe e njëanshme, çfarë nuk e uroj.

Por, duhet të kemi parasysh se "Nihil est veritatis luce dulcius" (nuk ke gjë më të ëmbël se sa drita e së vërtetës).

A.D: *Prej kohësh tanimë po punoni në ringritjen e kishës ku u mbajt Kuvendi i Arbrit. Çfarë të veçante ka ky objekt, tek i cili një herë kujtoj se kam vajtur mes një shtegu pylli ndërsa tani kur e vizitova, në ndërtim e sipër, rruga ishte çelur? Kanë ecur punimet sipas pritshmërisë tuaj dhe, edhe sa kohë mbetet për rihapjen dhe rifunksionalizimin e saj?*

N.U: Monumentet kishtare historike e kulturore të mesjetës si vazhdimësi e identitetit Iliro- Arbëror,në vendin tonë kanë ardhur dalëngadalë duke u zhdukur e dëmtuar dhe duke u pakësuar në numër. Kanë ndikuar gjatë shekujve luftrat e shpeshta, pushtimet e huaja, tërmetet etj., por padyshim në dëmtimet e zhdukjen e tyre e ka ndikuar në kohërat e caktuara edhe pakujdesja e njerëzve, mungesa e rezistencës së materialeve të ndërtimit ose të pikturimit. Në shumë raste mbishkrimet e afresket janë mbuluar me suva, janë lyer me gëlqere ose është pikturuar rishtazi sipër tyre etj..

Nder burimet dokumentare historike të Kuvendit të Arbërit (1703) në veri të Shqipërisë, numërohen rreth 85 objekte kishtare të nivelit *ekselent* që ishin të dëmtuar nga pushtuesit osman. Sidoqoftë, ndër këto objekte kishtare të mesjetës në veri të Shqipërisë, me ngrehinë të plotë, më shumë gjurme të afreskeve dhe që i kanë rezistuar furtunave të egra të kohërave deri sot janë Kisha e Balldrenit, e Rubikut të shek. XII dhe e Pllanës e shek. XIII.

Pas sistemimit dhe restaurimit me fonde private e jo nga Ministria e Kulturës siç duhej të ishte, të Kishës të poetit Mjeda në Kukël, (2014) kishave mesjetare Monumente Kulture të Balldrenit (2019) dhe asaj të Pllanës, (2020), duke kuptuar rolin që ka në historinë e popullit tonë Kisha e Kuvendit të Arbrit e vitit 1703 në Merqi të Lezhës, bashkë një grup specialistësh hartuam vitin e kaluar projektin për rivitalizimin të këtij Kuvendi Arbëror. Projekti në fjalë do shtrihet në gjithë hapësirën e oborrit të Kishës, reabilitimin e mureve të rrënuara të qelës si dhe vetë Kishës e cila ka pasur një ndërhyrje të thellë në vitin 1996 nga

famullitari i atëhershëm Dom Dodë Gjergji.

Punimet edhe tani me fonde private kanë filluar që në muajin maj të këtij viti, duke bëre ndërhyrje restauruese si: vendosjen e çatisë, heqjen e suvatimit të jashtëm, ndërtimin e absidës e të narteksit si dhe sistemimin e oborrit. Në brendësi të Kishës, pos të tjerash do të vendosen dy shtatore prej guri të protagonistëve kryesorë të Kuvendit të Arbrit, papa Klementit XI Albani, me origjinë arbërore nga Laçi i Kurbinit i cili hartoi takimin e Kuvendit të Arbërit dhe shtatorja e delegatit të papatit Imzot Vinçenc Zmajeviqit, i cili mblodhi ipeshkvijtë nga të gjitha trevat shqiptare, nga Tivari e Shkupi, për krijimin e një strategjie për ta mbrojtur popullin nga dhuna fizike, kulturore e shpirtërore turke.

Punimet do vazhdojnë edhe gjatë viti Jubilar të 320 vjetorit të këtij Kuvendit që do shpallet në fillim vitit që vjen me 14 janar, data kur u mbajt kuvendi.

Studimi i kishave të mesjetës, konservimi i rrënojave, rikonstruktimi apo ringritja e tyre është tepër e rëndësishme sepse është koha kur formësohet popullsia arbërore. Ato janë sot për sot dëshmia e vetme për ta njohur më mirë, kulturën, gjuhën, historinë e popullit tonë.

A.D: *Gjithashtu vitin e shkuar mbaroi edhe Përkujtimorja e Gazullorëve në Dajç* të Zadrimës. *Pse ishte kaq e rëndësishme të krijohej kjo hapësirë dhe, a është bërë mjaftueshëm për nderimin e figurave si ajo Gjon Gazullit apo të tjerë me peshën dhe rolin e tij por që për vite me radhë, edhe pas '90 nuk u përmendën?*

N.U: Qendra Përkujtimore kushtuar gazullorëve e përuruar më 30 dhjetor 2021 është një monument mbarëkombëtar që simbolizon klerikët gazullorë më të shquar të Shqipërisë në shekuj.

Në këtë Qendër Përkujtimore, spikat emblema e dom Gjon Gazullit të ri (1893-1927) deputet edhe në qeverinë e Fan Nolit, bashkëpunëtor me Koliqin, Avni Rustemin, Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën, të cilin e vari qeveria zogiste në Shkodër më 5 mars 1927. Po këtu spikat dhe emri i gjuhëtarit të njohur për shkencën shqiptare, dom Nikollë Gazulli (1895-1946), vëllai i Gjonit që u vra pa gjyq nga forcat komuniste në Shkrel të Malësisë së Madhe më 23 mars 1946.

Kjo Qendër mban në gjirin e saj edhe vëllezërit të kohës së Skënderbeut: Gjon Gazulli (1400-1465) astronom, fizikan, matematicien, filozof, shkencëtar i famshëm evropian dhe Pal Gazulli (1405-1470), diplomat, dijetar i shquar, themelues i bibliotekës së Raguzës (Dubrovnikut) dhe disa bibliotekave në Padova të Italisë.

Punimet filluan me 20 gusht dhe përfunduan me 22 dhjetor, 2021. Financimi u bë nga dashamirës të ndryshëm të kulturës shqiptare.

Shkallët përfaqësojnë ngritjen në vite të shqiptarëve, ato librat sipas blloqeve të vendosur përfaqësojnë diturinë e tyre. Secili bllok në dimensione të ndryshme është një enciklopedi më vete, italiane, franceze, angleze etj., për të paraqitur nivelin e madh të njohjeve që kishin këto njerëz të famshëm e të lënë në harresë deri sot. Atje lart në maje është kryqi apo ideali i tyre "Për fè e Atdhe"...

Në mes librave janë disa pllaka të mëdha 60×50, skulptura e gravura të atyre që kanë fotografi ose emrat e atyre që nuk kanë foto. Pak para se të arrij majën e monumentit, ka dy shtylla dorike me kapitel dhe dy drita të mëdha që qëndrojnë ndezur gjithë natën për të ndriçuar veprën e tyre.

Kjo është ideja e këtij monumenti, e thënë shkurt, Gazullorët nga thellësia e shekujve deri në ditët tona.

A.D: *Dhe sëfundmi, një pyetje për* Varret e Rrmajit. *Shumë herë, copa të munguara nga mozaiku i historisë janë plotësuar pikërisht prej mbishkrimeve në gurët e varreve. Varret e Rrmajit i kanë mbijetuar një historie të veçantë, nga vendprehje e të vdekurve, në një vend ku vriteshin martirët; nga vend i shenjtë në një vend ku shenjtëria luftohej... A mund të thoni diçka më shumë për to, për histori në, kontekstin, stilin e ndërtimit... përmbledhurazi apo gjerësisht.*

N.U: Doja ta filloja këtë shënim për varret e Rrmajt duke iu referuar një artikulli të botuar në Gazetën Shqiptare (dt. 21 prill 2011) nga arkitekti e i njohur Artan Shkreli. Citoj: "*Nëse ka një dëshmi të artit ndërtimor, të ngritur në nivel qytetar, ai ndodhet padyshim në monumentet funerale të Varrezave të Rrmajit në Shkodër"... "Në pikëpamje urbanistike, për periudhën e ngjizjes së qytetit post-osman, ajo ka rëndësi të dorës së parë në formimin e idesë mbi formulimin e varrezës urbane në hapësirën shqiptare...".*

Duke parë rëndësinë historike dhe arkitekturore që kanë këto varreza të shek.XVI, Arqipeshkvi Gaspër Thaçi në vitin 1936 ndërmori punën për zgjerimin, meremetimin dhe risistemimin e varrezave si dhe rindërtimin e një Kishe-kapelë të re më funksionale nga ajo e vjetra e cila ishte në gjendje fizike të degraduar. Kjo Kishë-kapelë që ka formën e Akropolit të Athinës si dhe projekti i sistemimit të varrezave u realizuan nga nxënësi i Atë Gjergj Fishtës, inxhinieri Ludovik Zojzi. Puna e finalizuar u inaugurua në vitin 1937 nga vetë Kryeipeshkvi i Shkodrës, Imzot Gapser Thaçi.

Më parë dhe sot flitet për gjurmët tona identitare nga koha e lashtë dhe deri të rilindja jonë kombëtare. Flitet për varret e etërve dhe gjyshërve tanë të cilët me vetëflijim ringjallën kombin, historinë, gjuhën dhe kulturën evropiane. Flitet për vendet e shenjtëruara nga kujtimi i burrave e grave që bënë Shqipërinë dhe ruajtën genin tonë nga tjetërsimi.

Këto figura me shpirt gjenden pranë Hyjit, kurse me trup e hir prehen në Varret e Rrmajt.

Aty prehen familjet e Muzhanëve, Shirokajve, Sumajve, Marubëve, Jubanëve, Jakovëve, etj., persona të shquar që bënë emër në fusha të ndryshme në historinë e Shqipërisë: inxhinierët, Gjovalin Gjadri, Augustin Briot, (projektues i urës se Bunës, prefekturës së qytetit të Shkodrës), Ludovik Zojzi, Kol Idromeno etj.; piktorët: Pjetër Marubi, Simon Rrota etj.; muzikologët: Prenkë Jakova, Pjetër Gaci, Leonard Deda etj.; letrarët: Hilë Mosi, Kolë Mirdita, Frederik Rrepshja, Kolë Ashta etj.; mjekët: Dr. Frederik Shiroka, Terezina Suma e shumë e shumë figura të tjera. Në këto varre prehen eshtrat e klerikëve, krijues të kulturës shqiptare: Atë Giacomo Jungut, Atë Anton Xanonit, Atë Pashko Bardhit, Dom Ndoc Nikajt, Dom Ndre Zadejës, etj.. Po kjo varrezë mban misterin e eshtrave të Dom Ndre Mjedës, Atë Gjergj Fishtës dhe prelatëve të tjerë kishtarë që dhanë kontribut të paçmuar në pavarësinë e Shqipërisë si Imzot Karlo Pooten, Imzot Pashk Guerrini, Imzot Lazer Mjeda dhe më vonë Imzot Gasper Thaçi. Eshtrat e këtyre të fundit në vitin 1967 u tërhoqën nga katedralja e Shkodrës për në varret e Rrmajt dhe sikur u zhduken duke mos lënë asnjë gjurmë.

Pas përmbysjes se diktaturës dhe ardhjes se demokracisë ishte momenti i paharruar kur më 4 nëntor 1990, pikërisht në këto varre u celebrua mesha e parë nga Dom Simon Jubani në praninë e një mase të madhe populli ende të frikësuar. Ishte ky një triumf i Zotit dhe gjakut të atyre që dhanë jetën për një Shqipëri ndryshe.

Me qëllim ruajtjen e vlerave urbaniste dhe marrjes në kontroll të situatës shkatërruese të ndodhur gjatë kohës së demokracisë, kur edhe mund të jenë zhdukur eshtrat e shumë personaliteteve të shquara si të Atë Gjergj Fishtës, dom Ndre Mjedës e të tjerëve, kam ngritur në këmbë opinionin publik për këto veprime të pashembullta, më një shkrim të botuar në Gazetën Shqiptare dt. 15 prill 2011.

Duke qenë se viti 2015 ishte jubilar, 25 vjetori i meshës së parë të celebruar nga Dom Jubani, u pa nevoja nga famullitari i atëhershëm i Shkodrës Dom Artur Jaku dhe nga unë për kryerjen e disa punimeve të domosdoshme në Kishën-kapelë, murin ballor rrethues dhe marrjes nën kontroll të plotë të varreve. Punimet e kryera u përuruan në festen qendrore të mbajtur me 4 nëntor 2015 në Kishën-kapelë të varreve, në praninë e autoriteteve kishtare nga Vatikani e Shqipëria si dhe të autoriteteve shtetërore dhe vendore të vendit tonë.

Duke kujtuar gjithë këtë histori shqiptare, kuptohet shumë qartë se varret e Rrmajt janë për ne shqiptarët njëlloj sikurse janë varret e Parisit për francezët, të Romës për Italianët etj.

PROFILE MJEDOLOGËSH

Prof. dr. Alfred Çapaliku

"Mjeda njëri prej protagonistëve të zëshëm të kulturës në gjysmëm e parë të shekullit XX, kontribues i spikatur i shpërfaqjes së identitetit tonë kombëtar."
Ardian Marashi

Shkenca e mjedologjisë nis më 1917, në Shkodër, me recensionin e At Gjergj Fishtës te gazeta "Posta e Shqypnis" për vëllimin poetik "Juvenilia". Kritiku letrar vuri re gjuhën e pastër, shquajti stilin e lartë dhe gjeti figurat e gjalla plot njomësi: *"Autori para se me e botue veprën e vet, e ka përshkue kushedin sa herë nën limë të mëndjes e të teknikës. Prandaj kjo vepër ka me kenë domosdo e nevojshme me u perdorue si tekst ndër shkolla të Shqypnis." (1)*

Ashtu ndodhi. Autori u institucionalizua me përfshirjen e tij në revista, tekste mësimore, histori letrare, monografi. Më 1925, në Shkodër, studiuesi At Justin Rrota e trajtoi Dom Ndre Mjedën te një tekst për shkolla të mesme duke i vendosur vjershave të "Juvenilias" medaljonin përkatës: *"Ndër to vèm n' oroe nji ambelcim mjaft të rrall mèndimesh e fjale, por ma tepër se asgjà ky auktuer asht për t'u çëmue per ndertim klasik të vjerrëshës, hartue e lëmue me cenë të posaçme." (2)*

Më 1931, në Palermo, tek një monografi studimesh kulturore në italisht, albanologu Gaetano Petrotta ia spikati Mjedës shijen e gjuhës shprehëse te poemthi lirik "Vàji i bylbyllit": *"Ai përshkruan bukurinë e natyrës dhe përmallet me këngën e zogjve e me poezinë e tij të harmonishme tërheq shpirtin e lexuesit që të admirojë bashkë me të madhështinë e gjithësisë dhe të lëvdojë Krijuesin e gjithpushtetshëm." (3)*

Në harkun kohor 1941 - 1943, nga Firenze në Shkodër, studiuesi Kolë Ashta botoi artikuj kritikë për Mjedën te revistat "Numero unico degli studenti albanesi", "Shkëndija", "Kumbona e së Diellës", ku komentoi opusin letrar: *"Shprehjet e tija të bajnë për vedi, të japin ndjenjën e së bukurës, të duket si me pa nji pjesë të shpirtit t'onë ndër ato vargje qi spjegojnë ndjesit e shprehuna me besniki. Lexuesi në të gjen poezin dhe i prekë nji farë dashunimi." (4)*

Më 1941, në Tiranë, studiuesi Karl Gurakuqi te një tekst antologjik për shkolla të mesme, nën kujdesin e ministrit të arsimit Ernest Koliqi, shpalosi meritat e individualitetit poetik në publikimet më të fundit të Dom Ndre Mjedës: " *... auktori i vlertë i poemthave "Scodra" e "Lissus" ka dijtë të thuri mjeshtrisht fuqin dhe shkelqimin e hartit klasik me elementat historikë e gojëdhanorë mà të zgjedhun të Shqipnis ilirjane." (5)*

Më 1960, në Tiranë, studiuesi Vehbi Bala tek një histori letërsie, në kapitullin kushtuar shkrimtarit Ndre Mjeda (Shkodër **19. 11. 1886** - 01. 08. 1937), ia cilësoi shkrimtarit rolin eksponent në romantizmin shqiptar dhe ia përcaktoi atij vendin e merituar në panteonin e letrave shqipe: "*Mjeda është ndër ato auktorë që bën kapërximin midis letërsisë së Rilindjes dhe asaj të kohës së pamvarsisë. Mjeda mbetet një nga figurat më të mëdha të letërsisë shqipe." (6)*

Më 1980, në Tiranë, studiuesi Mark Gurakuqi tek një monografi për veprën poetike të Ndre Mjedës e portretizoi autorin rilindës duke renditur tiparet e shprehura në procesin të krijimit "sui generis", të karakterizuara nga limimi e lëmimi i vargut gjer në perfeksion: "*Mjeda si poet dallohet për fuqinë e sintezës, për një sens të madh mase, për zotësinë e tij të japë vetëm të domosdoshmen, për ekonomi të fjalëve dhe të shprehjeve. Këto janë tipare dalluese të artit të tij." (7)*

Më 1980, në Tiranë, studiuesi Rinush Idrizi tek një monografi biobibliografike për Ndre Mjedën ìa vlerësoi rilindësit të ndritur prurjen e tij poetike në formë e në përmbajtje dhe e klasifikoi autorin si një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë shqiptare, që nga tradita e gjer në modernitet: "*Vepra e tij përshkohet nga një patriotizëm i thellë, nga ide demokratike, ka një nivel shumë të lartë artistik e ngjyra shumë të forta epike." (8)*

Më 1997, në Tiranë - Pejë, albanologu Robert Elsie tek një histori e letërsisë shqiptare, botuar në anglisht dy vite më parë në Neë York, krahas spikatjes se origjinalitetit të autorit, zbuloi edhe disa pika takimi me poetët rilindës italianë: "*Poezia e Mjedës sidomos përmbledhja e tij "Juvenilia" shquhet ... dëshmon për një gjuhë të përpunuar nën ndikimin e klasikëve italianë të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe, përgjithësisht për një nivel të lartë përsosmërie metrike." (19)*

Më 2002, në Prishtinë, studiuesi Sabri Hamiti në një vepër të korpusit mbi letërsinë shqiptare, te kapitulli kushtuar figurës enciklopedike të Mjedës, mbasi ia analizoi në mënyrë të ngeshme krijimtarinë, duke u ndalur tek veçoritë e stilit, e glorifikoi Poetin kësisoj: "*Shumë ide të tij, vargje të tij, vjersha të tij, jo vetëm se i kujtojmë përmendësh, por i kemi bërë edhe pronë të dijes personale, na kanë hyrë në mënyrën e të menduarit. Pra lexuesi jo rrallë i përdor si vlera të vetat." (10)*

Më 2004, në Tiranë, studiuesi i përkushtuar Mentor Quku nisi serinë e dymbëdhjetë librave, që rroku tërësisht personalitetin e Dom Ndre Mjedës. Qysh në nisje të hulumtimit të imët, dokumentues, ai nënvizoi: "*Qe poet i një ndjeshmërie të lartë e të veçantë, i cili hapi një faqe të re lirizmi në letërsinë shqipe. Kjo mjaftoi që të zinte një vend nderi në Panteonin kombëtar shqiptar. Vizioni i figurës së tij paraqet interes për gjithë kohërat." (11)*

Më 2010, në Prishtinë, studiuesi Rexhep Qosja tek një histori e letërsisë shqipe, përmes nje procedimi analizues - sintetizues, e vendosi krijimtarinë poetike të Mjedës plot dinjitet midis traditës botërore dhe të asaj kombëtare: ""*Andrra e jetës" është një shembull i veprës poetike në të cilën me pak fjalë thuhet vërtetë shumë... është metaforë e jetës njerëzore : gjithsesi, metafora më kuptimplote dhe më e bukur në poezinë e derisotme shqipe." (12)*

Më 2020, në Prishtinë, studiuesi Injac Zamputti, koleg me Mjedën në Kolegjën Saverjane të Shkodrës, në një libër kujtimesh, dëshmoi për laboratorin krijues të Mjeshtrit: *"I jepte rëndësi të madhe frymëzimit. Përpunimet që u bëri krijimeve të veta kishin të vetmin qëllim që fjala të tingëllontë e ëmbël, e ashpër, e furishme, si ta lypte shprehja dhe momenti poetik që vargu të rridhte i butë, i thyer, madhështor si të ishte mendimi dhe figuracioni që duheshin skalitur." (13)*

Volumi i publikimeve të mjedologëve e ka tejkaluar me dhjetëra herë numrin e fletëve të librit të hollë "Juvenilia" dhe të kontributeve të tjera mjedjane, në fushat e përkthimit, gjuhës, didaktikës, letërsisë për fëmijë.

Qysh prej vitit 2014 del periodikisht në Shkodër përmbledhja studimore "Mjedologji" e drejtuar nga historiani Dr. Dom Nikë Ukgjini, me kumtesat shkencore mbajtur te Qendra Muzeore "Ndre Mjeda" Kukël në veprimtaritë e përvitshme "Ditët e Mjedës". Revista pasqyron rritjen e interesimit për poliedrizmin mjedjan.

Mendimet e studiuesve e të kritikëve bashkohen në pikën se Poeti Ndre Mjeda është model estetik i paanashkalueshëm. Mjedologët e shquar i ngritën autorit të "Juvenilias" një përmendore prej fjalësh, që rri natyrshëm pranë shtatores së tij prej bronzi punuar në formë kambane prej skulptorit të mirënjohur Sadik Spahija. Fjalët dhe bronzi jehojnë njëlloj. Gjuha shqipe shungullon!

Shkodër, 12. 11. 2022

REFERENCA:

1. Gjergj Fishta: "D. Ndrè Mjedja : *Juvenilja*". Gaz."Posta e Shqypnis". Shkodër, 1917. Nr. 20, f. 4.
2. Justin Rrota: Letratyra shqype. Shkodër, 1925, f. 178.
3. Gaetano Petrotta: Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare. Tiranë, 2008, f. 329.
4. Kolë Ashta: ""I tretuni i Ndre Mjedës". Rev."Shkëndija". Tiranë, 1943. Nr. 3, f. 27.
5. Karl Gurakuqi: Shkrimtarët shqiptarë II. Tiranë, 1941, f. 402.
6. Vehbi Bala: Historia e letërsisë shqipe II. Tiranë, 1960, f. 393, 428.
7. Mark Gurakuqi. Mbi veprën poetike të Mjedës. Tiranë, 1980, f. 216.
8. Rinush Idrizi: Ndre Mjedja. Tiranë, 1980,f. 201.
9. Robert Elsie: Histori e letërsisë shqiptare. Tiranë - Pejë, 1997, f. 261, 263.
10. Sabri Hamiti: Vepra letrare 7. Prishtinë, 2002, f. 387.
11. Mentor Çuku: Mjeda 1. Tiranë, 2004, f. 27.
12. Rexhep Qosja: Historia e letërsisë shqipe. Romantizmi 3. Prishtinë, 2010, f. 490.
13. Injac Zamputti: Kujtime. Njerëz - Fakte - Ngjarje. Prishtinë, 2020, f. 87.

- Zija Çela vjen me romanin e ri "Banka e Ankesave", fitues i Çmimit të madh në Panairin e Librit. Botuar nga Onufri -

NJË "BANKË" PLOT ME THESARE LETRARE

Nga Xheladin A. Çitaku

1

"Kur je duke lexuar një roman, ta harrosh irealitetin, ke harruar kushtin e ekzistencës së artit."

Ky parim duket sikur ka dalë nga romanet e Zija Çelës ose, së paku, u shkon atyre fort për shtat. Jo rastësisht studiuesi Ali Aliu, duke shkruar për individualitetin e këtij shkrimtari, si nga tiparet më të spikatura thekson asimilimin e aktuales, imagjinatën e fuqishme dhe lojën e magjike mes reales e ireales. Gjetjet në romanet e Çelës janë përherë të veçanta, gjithë peshë përmbajtësore dhe spikamë estetike.

Në kostelacione të tilla krijuese, letërsia gjakon të transponojë shtjella skenike sipas përmasave të fantazisë e përjetimit të autorit, të cilat mbarështrohen në strukturën kompozicionale, stilistike, ideore e tematike, duke sjellë (aq sa është e mundur) kohën dhe hapësirën e zhvillimit të rrjedhave. "Banka e Ankesave", fitues i Çmimit të madh në Panairin e Librit, është një përqasje artistike (si përmasë dhe si vëllim) i tërë jetës bashkëkohore, çka simbolizohet kryesisht në një skenë veprimi, pikërisht te "Korpusi", siç quhet territori i bankës, bashkë me operativitetin e personelit që është angazhuar në punë. Në këtë institucion absurd, në bazë të vendimit të Qeverisë, janë përqendruar të gjitha ankesat e qytetarëve, të gjitha me shkrim e shërbim postar, pa të drejtën që të ankohen në asnjë zyrë a institucion tjetër. Dhe meqë këto ankesa "gozhdohen" aty, në bankën ku depozitimet ekzistenciale e shpirtërore përpunohen, ndryshohen ose gëlltiten fare, megjithëse ky funksion manipilues njihet, për pushtetarët krijohet iluzioni se gjithçka shkon mirë, sepse përderisa nuk ka të pakënaqur, do të thotë se nënshtetsit janë të lumtur… Çfarë ironie, ironi e sarkazëm tronditëse!

Prandaj në korpus vepron një sistem i organizuar strukturalisht dhe organikisht, me drejtori e sektor drejtorish, duke i dhënë dorë autorit për të zbërthyer tematikën e ideuar, personazhet e karakteret, si dhe për të shpërfaqur momentumin e zhvillimit në kohë e metodologjinë e qasjes ndaj problematikave të jetës.

Në përshkrimin e ngjarjeve të këtij romani, deri dhe të kronikës fabulare, do dështonim gjithsesi, sepse e tillë është trajektorja e dinamikës së zhvillimit të tyre, qoftë e subjektit, qoftë e personazheve që përfaqësojnë karakteret e kohës e të rrethanave. Kush e njeh (pak a shumë) veprën e Zija Çelës, e ka të qartë se duhet eksploruar secila lëvizje, duhet zbërthyer secili kuptim shprehës, duhet skanuar secili karakter, për ta kuptuar mëtimin e shkrimtarit dhe për ta ravijëzuar atë si një tërësi. Në këtë kontekst, mendoj se bota krijuese e Zija Çelës ndjek një kurbë të veçantë, rrugëton nëpër një trase të shtruar enkas për autorin. Si e tillë, kjo botë krijuese rafinon derivatet e saj të pakrahasueshme, sepse lënda, teksti i veprës, është përplot me veçori që përcaktojnë origjinalitetin e krijimit. Ja përse romani "Banka e Ankesave" është "Banka e Ankesave", është telajo ku pikturon individualiteti i papërsëritshëm i Zija Çelës, opusi i tij i pa-paralelizuar dhe i pa-analogjizuar, edhe nëse për koincidencë tematike takohet jo formalisht me ndonjë botë tjetër krijuese, atë zonën enigmë që bashkon gjithë shkrimtarët e mëdhenj. Kjo është vlera e Zija Çelës, është mendja dhe shpirti i tij, të cilat ia dhuron lexuesit përmes një krijimtarie burimore të pandalshme, e pra edhe romanit të ri "Banka e Ankesave", që vjen plot me thesare letrare.

Ambientimi i temës në rendjen e shoqërisë shqiptare, në jetën e saj, në dritëhijet e vlerave të saj, përkufizimin dhe identitetin e saj, angazhon pikëpamjet dhe këndvështrimin artistik të shkrimtarit, për ta ngjizur skenën adapte dhe infrastrukturën letrare në përputhje me stadin aktual të zhvillimit të gjithanshëm, të aspekteve përbërëse, si dukuritë sociale, psikologjike, intelektuale e deri tek impulsimet shpirtrore, që vihen në shërbim. Fenomeni i centralizimit të pushtetit vjen gjithë vërtetësi artistike e forcë emocionale në vepër. Një fenomen autokratik që sot po haset rrezikshëm në Eurpë e jashtë kontinentit, çka i jep vlera universale romanit. Të gjitha në duart e Bankës, nën rregullat e Bankës, në vullnetin e sektorëve të Bankës e të shefave të Bankës. Pra, të gjitha brenda vorbullës së kontrolluar nga një hierarki vertikale, burokratike dhe e korruptuar, që udhëheq Bankën. Që në fillim të romanit, paralajmërohet se zoti Zamarini i përmbahet "konceptit" që ngërthen dimensionet lart-poshtë dhe mbështjellë, nga e djathta dhe nga e majta, vetë globin mbarë, të cilin sikur e ka ndrydhur për ta mbajtur në grusht me tërë formën e ekzistencës. (Fillimi i romanit.) Tekefundit, ai ka instiktin e mbeshtetjes së vazhdueshme, nëpërmjet ndjesisë se në përmasa globale ekziston edhe Banka Botërore e Ankesave.

Në bankën e Tiranës, Zamarini është diku nga kreu i piramidës (mëkëmbës i të parit, Drejtorit të përgjithshëm të padeklaruar. A thua vetë shefit të Qeverisë?!) dhe udhëheq me një aparat të përbër nga shefa e nëpunës, që i shërbejnë një kauze, asaj të njohjes, zbërthimit dhe dirigjimit të shpirtit njerëzor, të individit e shoqërisë, kontrollimit të çdo segmenti dhe survejimit të gjithanshëm.

2

"Romani ndërtohet me logjikën e arkitekturës danteske të Ferrit; shkatërrimi infernal i qenies njerëzore nga mekanizmat shtetërorë burokratikë e kontrollues, me gjithë pasojat e një procesi të tillë – mozohizimi i viktimave dhe si kundërgoditje, degradimi i vetë aparatit diabolik që survejon..." (Rudolf Marku)

Sektorët e Bankës së Ankesave janë përshkallëzuar në funksion të administrimit enigmatik, ose procedimit jotransparent të ankesave, si një labirinth, në daljen e të cilit nuk presin ankues të gjallë, si "shkatërrim infernal i qenies njerëzore nga mekanizmat shtetërorë...". Viron Merko, njëri nga personazhet kryesore, shëmbëllen shpirtin në ankthin e pritjes së pafundme, sepse ingranazhet burokratike të Bankës nuk lëvizin shpejt, përkundrazi, me dinamikën e moszënies së epilogut, zgjidhjes. Edhe ankesa testamentare i nënshtrohet zvarritjes në kohë.

Aparatin administrativ të Bankës, Zija Çela e ka strukturuar sipas modeleve standarde të strukturave të shoqërisë moderne, me po ato karakteristika bazë që i shquajnë, preokupimet, synimet, teknologjinë, orekset egoiste, degradimet dhe përfundimet. Veçse observon me tematikën në një konvencë të veçantë, ku nevojitet përqëndrimi i vëmendjes për ta perceptuar, si dimension narrativ dhe si reliev i përveçëm letrar, sepse transformimi artistik vendohet në shtrirje ndryshe, në përshkallëzim stilistik përtej konsolidimit të deritashëm.

Thënë troç, Zija Çela po i konfiguron vlerat e tij letrare në komponime të pakrahasueshme, cilësisht dhe afirmativisht, duke e shpërfaqur shoqërinë shqiptare me ngjyrat që ka, duke nxjerrë në sipërfaqe nënshtresat e mbuluara e të harruara, ato të dukshmit që bëhen të padukshëm në korrupsion, pjesën hipokrite të elitës intelektuale, duke fotografuar qiellin e vrenjtur, tokën djerrinë dhe gjallesat që lëvrijnë mes tyre; duke formësuar ëndërrat e vrara dhe shpresat e uzurpuara të shpirtrave të lirë. Ky është çmaskimi i realitetit përmes shëmbëllimit të tij, përmes transponimit në ndërtim prozaik. Prandaj pajtohem me Rudolf Markun kur shkruan: "Në librat e Zija Çelës ngjarjet mund të ndodhin Kurdoherë. Dhe kjo u jep romaneve të autorit një dimension të përtejshëm e të përjetshëm. Me krijimtarinë e tij, Zija Çela provon se letërsia e madhe i shpëton tiranisë së kohës. Kohës kalendarike. Por jo asaj ku rrinë së bashku veprat më të mira të letërsisë e të krijimtarisë shpirtërore, në atë zonë ku qëndron me dinjitet dhe krijimtaria e tij."

3

"Romani Banka e Ankesave, ashtu si shumica e romaneve të Zija Çelës, vjen si një alegori e fuqishme, ku shkrihen kontekste dhe referenca të vështira të realitetit jetësor..." (Mehmet Kraja)

Kodet e ligjërimit të Zija Çelës ngërthejnë një mënyrë të posaçme të rrëfimit, e cila nuk i përket së thjeshtës së thatë dhe nuk receptohet sipërfaqësisht, por kërkon thellim e përqendrim për ta zbërthyer, për t`i eksploruar këto "kontekste dhe referenca të vështira të realitetit jetësor".

Ky koncept krijues, pra, angazhon potencialin e botës komplekse që artikulon tekstin e mestekstin, kuptimin dhe nënkuptimin, vijëzimin konkret dhe abstragimin. Prandaj, kapaciteti krijues i Zija Çelës është ideatori dhe "ekzekutori" i kësaj prodhimtarie letrare-artistike, sistemimi dhe ekspozimi i saj tek opinioni lexues.

"Banka e Ankesave" është plasimi specifik i këtij kapaciteti, i cili po absorbohet etshëm dhe po shijohet, tashmë, nga pasioni për lexim dhe përvetësim të vlerave të vërteta letrare. Kjo vepër plotëson edhe më tej ciklin e larmishëm të romaneve të autorit, që pikërisht Mehmet Kraja e ka cilësuar si "saga metaforike më e madhe e letërsisë shqipe".

Prishtinë, dhjetor 2022

UDHA E DORËS: EPISODI I KATËRT

MES VIZIONESH DHE FIGURASH AMËSORE. FRAGMENTET E ORNELA VORPSIT.

Nga Dr. Fabio M. Rocchi

Ornela Vorpsi ka shkruar në gjuhën italiane pjesën e parë të krijimtarisë së vet: *Il paese dove non si muore mai* e *Bevete cacao van Houten* në vitin 2005 (Einaudi 2010), *Vetri rosa* në vitin 2006 (Nottetempo), *La mano che non mordi* në vitin 2007 dhe *Fuorimondo* në vitin 2012 (Einaudi).

Librat e parë dallohen për një zgjedhje shprehëse – e deklaruar disa herë nga vetë autorja si e pashmangshme – që ka privilegjuar gjuhën italiane për t'i dhënë zë botës së brendshme. Vihet re, në periudhën pas vitit 2012, kapërcimi i një faze të mëtejshme ku takohet edhe prania e gjuhës franceze. Prej këtij momenti e në vazhdim, Vorpsi ka vendosur të qëndrojë në një situatë dygjuhësie krijuese, me kalime të vazhdueshme nga frëngjishtja në italisht, në vijim të periudhës së jetesës në qytetin e dytë adoptues pas Milanos, Parisit. Në këtë klimë influencash të reja gjuhësore më shumë se kulturore duhet pozicionuar *Tu convoiteras* (Gallimard, 2014, i përkthyer më pas në gjuhën italiane nën titullin *Viaggio Intorno alla Madre*, Nottetempo, 2015).

Bëhet fjalë për një *patchwork* identitar që i ka dhuruar Vorpsit statusin e privilegjuar prej apolide: «La mia condizione è proprio essere tra le lingue». [«*Gjendja ime është pikërisht të qëndruarit mes gjuhëve*».] Të qëndruarit mes gjuhëve është privilegji i kujt nuk i përket më një kombi: «Ovunque io sia, in Albania in Italia o in Francia, non mi sento più a casa da nessuna parte». [«*Kudo të ndodhem, në Shqipëri, Itali apo Francë, nuk ndihem më në shtëpi askund*».]

Me publikimin e fundit të Vorpsit, *L'été d'Olta*, botuar në gjuhën frënge nga Gallimard në majin e vitit 2018 dhe akoma i papërkthyer në italisht, më duket se është përfunduar një proces narrativ me një fizionomi të përcaktuar. Është maturuar në këtë mënyrë momenti më i përshtatshëm për një analizë gjithëpërfshirëse të veprës së autores.

Bëhet fjalë për një botë të populluar nga evokime të mirëfillta ku afirmohen disa konstante të herëpashershme. Koherenca e rrëfimit të Vorpsit qëndron, në pamje të parë, në një ripërpunim të vazhdueshëm të një romani familjar shumë specifik: një vajzë e re që vëzhgon dhe percepton botën duke u përpjekur t'a interpretojë atë; një baba i larguar dhe fajtor, i munguar nga një moment i caktuar e në vazhdim; dhe një nënë e bukur, hieratike, e mbyllur dhe e palumtur, herë-herë plot urrejtje, e pajisur me një forcë që është në të njëjtën kohë e aftë të rrënjosë dashurinë por edhe të paralizojë. Brenda kësaj situate qëndrore, e cila përsëritet me variacione të pakta ndërkohë që rrëfimi merr jetë, perspektiva e vajzës – shpeshherë e ftohtë dhe e shkëputur – përpiqet të marrë hapësirë dhe t'i japë një kuptim ndodhive. Në këtë mënyrë, merr jetë një sistem paralel reflektimesh që fut një fat individual në panoramën e gjerë të dialektikës Lindje-Perëndim, të përfaqësuar në periudhën pas shembjes së Murit të Berlinit dhe rrënimit të ideologjive të socializmit historik. Një dialektikë në të cilën këndvështrimi i narratorit evoluon dhe arrin të zhvillojë me kalimin e kohës një antiretorikë që çmitizon premtimet dhe ritet e Perëndimit falë një këndvështrimi gjithnjë e më të ndërgjegjshëm.

Ekuivalenti formal i këtij universi narrativ është padyshim fragmenti, i propozuar në një progresion në të cilin tregimi i historisë dhe preferenca për fabulën i lënë vendin, nëpërmjet anullimit të dimensionit hapësirë-kohë, modaliteteve tipike të vizionit. Një vizion zbulues i dinamikës psikologjike të një spektatori-narrator, i cili, duke përkthyer botën e brendshme në figura, arrin në të njëjtën kohë të hulumtojë në thellësi dhe të rrëfejë atë çka sheh. Rezultati është një botë subjektive shumë e dallueshme, në të cilin një ide e veçantë e së vërtetës shprehet me imazhe të gjalla dhe të plota. Njësoj si masat e ngjyrave të pikturave që vetë Vorpsi, gjithashtu piktore dhe fotografe, krijon. Në këto piktura, si në librat e saj, subjektet gjenden të zhytur në sfonde plot tension, të përvijuara përmes vëllimeve antirealiste. Pavarësisht kësaj, ata janë të marrë nga realiteti; i referohen vazhdimisht atij madje edhe kur e mohojnë.

Estetika e fragmentit dhe rëndësia e *Bevete cacao van Houten*.

Vorpsi i sjell lexuesit konkretësinë e botës së jashtme përmes një proze jo të vazhdueshme dhe të përbërë nga momente. Stili i saj qëllimisht thur lidhje shumë të dobëta me realitetin, në mënyrë që disa zbulime të mbinatyrshme të kenë mundësinë të manifestohen. Nuk i përket mënyrës së saj të të shkruarit gjatësia e një proze sistematike, në të cilën arkitektura romaneske – ajo në të cilën shquhet për shembull Anilda Ibrahimi – ndërtohet kapitull pas kapitulli me një qëllim fabulistik shumë specifik. Madje, edhe për prozën e saj më të gjerë, nuk mendoj se mund të thuhet se Vorpsi ka shkruar ndonjëherë një roman të vërtetë tradicional, përkundrazi, më duket se i përshtatet në mënyrë të jashtëzakonshme zhanri i tregimit, i nënkuptuar më shumë si *short story* sesa si novelë me tezë.

Në një moment ku tregu i botimeve ishte – siç vazhdon të jetë – i fiksuar pas romanit, duke i dhënë më pak rëndësi formës së shkurtër, Vorpsi vendos të fokusohet në njësi kuptimore shumë më të shkëputura krahasuar me qendërzimin e një strukture, për të portretizuar disa personazhe dhe dukuri që mund të kishin jo vetëm një ndikim në ndërgjegjen e lexuesit, por edhe një rendiment stilistik shumë të afërt në intensitet me paraqitjen piktoreske. Mbi të gjitha me përmbledhjen *Bevete cacao van Houten* shkruar nga Ornela Vorpsi në 2005 dhe publikuar vitin e ardhshëm me botuesin Einaudi në Itali, ndiqet kjo linjë shprehëse, duke arritur rezultate cilësore shumë interesante si nga pikëpamja formale, ashtu edhe nga ajo ndërkulturore.

Shkrimtarja, e cila ndërkohë kishte braktisur Tiranën për t'u shpërngulur në Milano, kishte përshkruar në ato mikro histori, nën këndvështrime të ndryshme, momentin e shpërnguljes së popullit shqiptar në Itali dhe këtë e kishte realizuar duke zgjedhur shpesh brezin e të rinjve, të cilët ndërkohë ishin ambientuar në shoqërinë italiane dhe zbatonin zakonet e saj. Në fakt, protagonistët e atyre historive janë shumë shpesh të rinj, të cilët në një moment të caktuar dalin nga zakonet e përditshmërisë së tyre për të përqafuar një kulturë të re, padyshim të kapitalizmit të vonë por njëkohësisht të gjallëruar nga një frymë lirie; ajo frymë që kishte munguar në atdhe deri në vitin 1991 për arsye historike. Kemi të bëjmë me fate që rrëfejnë një mutacion. Nga ashpërsia dhe lartësimi i subjektit kolektiv, procesi i afirmimit të këtij brezi të ri kalon nëpër kultin e individualizmit.

Gjejmë djelmosha që vendosin të shkojnë në palestër për të përmirësuar pamjen fizike, vajzat figurante që punojnë si kubiste në disko për të fituar pak para, subjekte që i nënshtrohen magjepsjes së modës dhe produkteve të shitjes me pakicë në shkallë të gjerë aq shumë sa vendosin të ndryshojnë kirurgjikisht pamjen e tyre të jashtme. Ama, në të njëjtën kohë, vetëdija e të paturit një origjinë të ndryshme nga ajo ku janë integruar, i lejon të reflektojnë dhe gjithashtu të distancohen nga disa situata negative ose shumë të ekzagjeruara.

Në këtë migrim fatesh dhe mentalitetesh Vorpsi ka arritur në këtë mënyrë të përshkruajë një fazë të veçantë edhe për sa i përket tranzicionit të mendimit. Traditat nuk mohoheshin rrënjësisht, por një mënyrë jetese e paprecedentë – e ushqyer nga rite thellësisht perëndimore, e karakterizuar nga përhapja, për shembull, e mesazhit reklamues – po gjente vend, duke u konsideruar si një model i ri jetese. Ky është një nga aspektet më të rëndësishme sociologjike të valës së parë të migrimit në Itali dhe ky koleksion tregimesh kap më së miri frymën e tij duke përshkruar përmes imazheve efektive disa prej momenteve më vendimtare.

Akti i të parit te Vorpsi.

Personazhet protagoniste të Vorpsit nuk shikojnë. Ata vëzhgojnë. Lënë t'u rrjedhë para syve e zakonshmja dhe dinë, edhe në mënyrë të pavetëdijshme, të vënë re të jashtëzakonshmen, në një moment ku vetëdija i godet dhe i detyron të dëgjojnë logjikat e brendshme. Tamar është protagonistja fëmijë e *Fuorimondo*. Ajo luan rolin e rrëfimtarit dhe dëshmitares së fakteve që ajo vetë vendos të tregojë. Jemi në prani të një vajze që bie në kontakt me vdekjen dhe që përfaqëson një Kasandër moderne, e aftë të parashikojë fatkeqësitë dhe të shtrihet drejt botës së përtejme. Në një skenë e gjejmë të ulur në divan përpara një televizori të llojit me tub me rreze katodë. Pranë saj gjenden teze Lali dhe një djalë shumë i pashëm, Dolfi. Tezja, ende e re, provon një qasje erotike ndaj djalit, duke i shtrirë duart drejt bigës së xhinseve të tij. Por konteksti i realitetit, falë natyrës së prirur ndaj vizionit të Tamarës, shndërrohet menjëherë në diçka tjetër. Pa asnjë detaj që të përgatisë lexuesin për tranzicionin, përballemi papritur me një skenë groteske, joreale, që anon nga onirikja:

«Sullo schermo sfilavano ininterrotte le immagini, fuori si sentivano i lamenti di Nikolin, quando all'improvviso il mio sguardo si è posato sui riquadri a specchio della porta del salone, e là ho sentito la serpe della mano di Lali che mi afferrava la gola cercando di soffocarmi, mentre nello specchio sfiorava il sesso di Dolfi».

[«*Në ekran shfaqeshin pa ndërprerje figurat, jashtë dëgjoheshin rënkimet e Nikolinit, kur papritmas vështrimi im ra mbi panelet me pasqyrë të derës së sallonit dhe aty ndjeva gjarprin e dorës së Lalit që më kapte nga fyti duke më mbytur ndërkohë që në pasqyrë reflektohej seksi i Dolfit*».]

Cfarë po ndodh në të vërtetë? Cilat

janë ngjarjet që duhen konsideruar si reale dhe cilat si ripërpunime të përsonazhit që ndalon së shikuari dhe fillon të vëzhgojë? Kjo mënyrë të shkruari dhuron vazhdimisht një udhëtim në botën e brendshme dhe në kujtimet e personazhit, duke zeruar lidhjet mes skenave që ekzistojnë në fabulën realiste. Lexuesi nuk mund të shpërqëndrohet asnjë moment nëse vërtet dëshiron të kuptojë. Prej tij kërkohet një pjesëmarrje emotive dhe një prezencë mendore shumë intensive. Teksti ama e ndihmon nga brenda nëpërmjet një stili që nuk bëhet kurrë monoton dhe një gjuhe të ndryshme, të shpikur. Shënjuesi bëhet në disa pjesë i ri, duke i dhënë jetë kombinimeve origjinale, të papritura për lexuesin, dhe që shfaqen në faqë si zbulime. Gjendja e një gjuhe të importuar, të mësuar pas moshës së formimit, është vetëm një pikënisje. Në disa sintagma, që i afrohen logjikës së vargut poetik, krijimtaria leksikore zgjeron konceptet, duke u mbështetur te parafjalët, në anakoluti dhe veçanërisht në sinestezi. Ja disa shembuj të një mënyre të shkruari që në disa kalime tingëllon gati eksperimentale dhe që në mënyrë të vetëdijshme kërkon të sforcojë normalitetin e një gjuhe herë herë tepër të sheshtë e tepër të vërtetë për t'u bërë mbartëse kuptimesh: «Carne desiderio»; «L'edera l'assale, come le vene in una mano in piena estate»; «In fondo a questo lago c'è dell'altro»; «Volo verso la voce che m'invita»; «Occhi stupore»; «Bellezza succulenta»; «Gambe odor sesso»; «Folto bellicoso»; «Occhi buchi neri»; «A noi ancora ignoto era l'uomo»; «Occhi mangiarono occhi»; «Ses yeux vert miracle». Lista, ndonëse e pjesshme, pasurohet nga dukuritë që kanë të bëjnë me idiomat popullore të gjuhës shqipe që Vorpsi është përpjekur t'i kthejë në italisht, duke ndjekur gjithmonë këto rregulla të ndërtimit të sentencës, duke përdorur gjithnjë mënyrat e poezisë. «Campa campa e non crepa l'albanese» [«*Rron, or rron dhe nuk vdes Shqiptari*»]; «Vivi che ti odio, e muori che ti piango» [«*Jeto që të të urrej dhe vdis që të të qaj*»]; «Quando la pietra è al proprio posto pesa» [«*Guri i rëndë në vend të vet*»].

Siç shihet, magnetizmi midis fjalëve që u referohen sferave të ndryshme shqisore, si dhe renditja krijuese e termave që nuk ndjek rregullat më të zakonshme e bazike të gjuhës sonë, lënë vend për interferenca që krijojnë imazhe. Akti i vizionit përkthehet në përplasje të zbërthyera midis fjalëve, krejtësisht funksionale në përvijimin e një tipologjie karakteri që i kundërvë ankthin e vet perceptues leximit të kufizuar të realitetit. Prandaj, nëse protagonistët dëshmitarë të Vorpsit shohin përtej, në një gjendje konfuzioni dhe me përthyerje të ngjashme me ato të shkaktuara nga mjegullimi i xhamit, sytë e tyre mund të përkufizohen vetëm si *occhi stupore*, duke përdorur një nga sintagmat subversive në të cilën investimi simbolik mbi aktin e shikimit theksohet fort edhe nga origjinaliteti i fjalëve.

Si një shkëmb qëndron nëna.

Në *Storia di una pensione*, tregimi i dytë i përmbledhjes *Bevete cacao van Houten*, gjejmë një alegori tepër të arrirë të figurës së artistit. Bëhet fjalë për Petraqin, piktorin e çuditshëm që jeton i izoluar dhe nuk arrin të ndërveprojë me komunitetin e vet. I tallur, i gjuajtur me gurë, i plaçkitur pikërisht sepse nuk kuptohet nga të gjithë, Petraq e ka trasformuar shtëpinë e vet në punishte pikture. Dhe atje, në një ajër të pashëndetshëm, të ndotur nga tymi i vajit të lirit, ai mbyllet për të krijuar pikturat e tij me një temë të vetme:

«I quadri di Petraq erano in bianco e nero. L'unico colore che aggiungeva a quei contrasti erano piccolissime quantità di rosso. Il tema era ricorrente, LEI, grande quanto la tela. Talmente grande che spesso la tela non riusciva a contenerla e quindi la testa rimaneva tagliata fuori dai margini, a

volte restava fuori un braccio o un dito».

[«*Pikturat e Petraqit ishin bardhë e zi. E vetmja ngjyrë që i shtonte atij kontrasti ishte e kuqja në sasi shumë të vogla. Tema përsëritej, AJO, e madhe sa e gjithë kanavaca. Aq e madhe, sa shpeshherë telajo nuk arrinte ta përfshinte të gjithën prandaj koka ngelej jashtë kornizës; ndonjëherë ngelej jashtë një krah ose një gisht*».]

Kjo AJO, kjo prezencë mbytëse dhe e tejmadhe, është nëna në veprat e Vorpsit. Një entitet nga i cili merr jetë gjithçka, që imponohet si model i detyrueshëm dhe që njëkohësisht pushton hapësirat dhe u merr lirinë vajzave. Të voglat, nën ndikimin e saj, përpiqen të fillojnë eksplorimin e botës përreth, duke luftuar megjithatë jo pak për t'u emancipuar për shkak të prezencës së saj shtypëse. Imazhi pozitiv që Vorpsi nxjerr nga filozofia e hinduizmit për të përshkruar se cila është figura femërore nga e cila buron gjithçka është mahnitës. Në këtë këndvështrim, nëna vendoset në qendër të botës, një strumbullar i vërtetë rreth të cilit sillet gjithë rrethi i asaj çka njihet:

«Dio Ganesh, mostrami quanto è grande il mondo! Katarina vede dio Ganesh che si alza, l'elefante cammina adagio, gira intorno a sua madre. Tornato al punto di partenza, chiuso il cerchio, il dio dell'innocenza dice: Katarina, ecco quanto è grande il mondo».

[«*Zoti Ganesh, më trego sa e madhe është bota! Katarina sheh zotin Ganesh që ngrihet, elefanti ecën ngadalë dhe bën një xhiro rreth nënës së tij. Kur kthehet në pikën e fillimit, pasi ka përfunduar rrethin, zoti i pafajësisë thotë: Katarina, ja sa e madhe është bota*».]

Brenda atij rrethi qëndron jeta. Në romanin familjar që përmenda në fillim si situatë që Vorpsi zgjedh për të vënë në skenë historitë e saj, nëna bie në sy si një pikë referimi e gjithëpushtetshme. Jep stabilitet, strehë, mat hapësirën dhe e bën të përshkueshme. Por në të njëjtën kohë kanoset si një gur, rëndon, bllokon rrugët e shpëtimit: «Quando la pietra è al proprio posto pesa». ["*Guri i rëndë në vend të vet*"]. Ndërkohë që babai është figura e mungesës dhe e fajit, figura e nënës mishëron karakteristika ambivalente. Është shumë e dashur, për pak çaste mirëpret të bijën në një përqafim që shkrin dy trupat, por njëkohësisht krijon distoni, shtyn, qorton, shqaf xhelozi për shkak të një bukurie natyrore të gjykuar të paarritshme. Një marrëdhënie e luajtur tërësisht midis tërheqjes dhe zmbrapsjes përsëritet për Esmè, nënën e Tamarit në *Fuorimondo*, për Natashën, nënën e Katarinës në *Viaggio intorno alla Madre* dhe për Diellën në librin debutues *Il paese dove non si muore mai*.

Natyra problematike e raportit femëror me një nënë kastruese, nëse duam ta quajmë kështu, përsëritet, siç e pamë, në disa vepra duke u shndërruar në një konstante dhe kthehet, për shembull, te Veronika e *L'été d'Olta* në një model plotësisht të përvijuar. Por ekzistojnë edhe variante që shmangen nga kjo lloj situate e përsëritur. Do të doja të analizoja dy figura nëne në veçanti, të cilat më duken jashtëzakonisht domethënëse dhe që devijojnë nga kjo linjë. Moma. Dhe Lumturia.

Moma është ur-nëna e një Shqipërie primordiale dhe shumëvjeçare, të cilën disa nga historitë e *Bevete cacao van Houten* dhe fragmentet e *Il paese dove non si muore mai*, sidomos në pjesët e para të tyre, e përfaqësojnë fuqishëm, përmes imazheve të paharrueshme. Plaka Moma mirëpret në strehën e vet çupëlina dhe të panjohur, u jep atyre biskota dhe lekë në kartmonedha. Kalimi i pragut të shtëpisë së saj, që në fakt është një dhomë e vetme që kryen funksionet e të gjitha hapësirave, është e barabartë me hyrjen në një vend të sigurt. Një vend ku mund të rrëfehen sekretet. Vajzat që mblidhen atje nuk mund të betohen se Moma nuk kupton, por janë të sigurta që Moma nuk do të tregojë. Plaka, tashmë shumë e shkuar në moshë, duket se mezi pret fundin e saj nga një ditë në tjetrën, por ai nuk vendos të vijë. «Moma vuole la morte, la morte non vuole Moma». [«*Moma do vdekjen, vdekja nuk e do Momën*»]. Në këtë portret arkaik vërtet të suksesshëm, në këtë fytyrë të rrudhosur të mbështjellë me shallin e bardhë tradicional, fshihet këmbëngulja e jetës. Kërkesa e vetme e plakës është që mos t'i shkruajnë moshën në gurin e varrit. Dhe kur i vjen koha, kjo kërkesë i plotësohet. Kjo kokëfortësi për të qëndruar e lidhur me botën mishëron gati me nota mrekullibërëse instinktin jetësor. Dhe nuk mund të ishte veçse figura e një nënë, madje, e nënës së gjithë nënave, ajo që do të mund të pohonte një parim kaq thelbësor.

Lumturia – emër që i jep titullin një tjetër tregimi gjithmonë nga përmbledhja *Bevete cacao van Houten* – është ndryshe. Rrit të birin duke e ushqyer me Francë, një vend që ka idealizuar pa e njohur kurrë. E quan Lucien, si një nga personazhet e një romani pak të njohur të Stendhal. Rezistenca që Lumturia vendos të kryejë nëpërmjet një krijese të ndryshme nga të tjerat që nga aspekti fizik – «Come a incarnare il sogno della madre, invece che la robustezza dei bambini di queste parti, Lucien ebbe occhi azzurri e corporatura minuta». [«*Si për të mishëruar ëndrrën e së ëmës, në vend të forcës së fëmijëve të këtyre viseve, Lucieni kishte sy blu dhe një trup të vogël*»]. – i drejtohet mëmëdheut Shqipëri, në momentet e përmbysjes së regjimit të Ramiz Alisë. Dhe pikërisht në ato ditë revolte dhe kaosi, Lucieni niset drejt Parisit, për t'u çliruar nga një burg tokësor që nuk ofron asgjë dhe që i mbyt ambiciet letrare. Pothuajse një fabul nga ato të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Por fatkeqësisht, për të riun nuk fillon asnjë roman formimi; ai nuk është veçse një shkrimtar mediokër, i cili kërkon të imitojë Dostojevskin në epokën e Alain Robbe-Grillet pa arritur të ndërgjegjësohet për vonesën e vet kulturore.

Atëherë rrëfimi kthehet të nëna, e cila ka shkuar të vizitojë të birin në botën perëndimore ku ka ngelur e çuditur nga çdo gjë, madje edhe nga peshku pa hala dhe i ngrirë. Në këtë produkt ikonë të shpërndarjes në shkallë të gjerë qëndron pafajësia e vështrimit të Lumturisë. Por, në vendosmërinë e veprimeve që ndërmerr qëndron moderniteti i saj. Gruaja largohet për herë të dytë nga Shqipëria sepse ndjen që është afër vdekjes. Dëshira e saj e fundit është të mbyllë sytë pranë të birit, atij biri që kishte programuar për emancipimin. Por viza e saj rezulton false; bllokohet në Vjenë, ku fluturimi bën ndalesën e parë. Në aeroport e këshillojnë të kthehet në shtëpi. Refuzon. Nuk do të mbërrijë kurrë në aeroportin Charles de Gaulle. Do të ndërrojë jetë atje, e pezulluar mes dy botëve, në një sallë pritjeje, pa para, pa ushqim, pa kartë telefoni. Në kokëfortësinë e kësaj figure të jashtëzakonshme nëne përmblidhet fati i një populli të dalë nga binarët e së zakonshmes për t'u vënë në kërkim të një jete të re gjatë vitit 1991. Instinktiviteti i Lumturisë përkon me madhështinë e saj shpirtërore, kryesisht simbolike. Nëna ndjen ardhjen e një fati të ri dhe orientohet në drejtim të tij. Pak rëndësi kanë rezultatet e ngjarjes, zhgënjyese (i biri nuk ka talent dhe nuk ia del) dhe tragjike (Lumturi i përfundon ditët e saj në mënyrë të mjerueshme, me një vdekje që fatkeqësisht ka diçka humoristike). Nëna bëhet simbol dhe kokëfortësia e saj pasqyron vlerën e një brezi që pikërisht në ato momente po përjetonte një rilindje të pabesueshme.

Përktheu nga italishtja Kriselda Beqaj

Veprat e Ornela Vorpsit

Bevete cacao van Houten, Einaudi, Torino 2010$_2$ (Actes Sud 2005).

Il paese dove non si muore mai, Minimun fax, Roma 2018$_2$ (Einaudi 2005). Kjo vepër është përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 2019 nën titullin *Vendi ku nuk vdiset kurrë*, Botime Dudaj, Tirana.

Vetri rosa, Nottetempo, Roma 2006.

La mano che non mordi, Einaudi, Torino 2007.

Fuorimondo, Einaudi, Torino 2012.

Viaggio intorno alla madre, Nottetempo, Roma 2015$_2$ (Gallimard 2014).

L'été d'Olta, Gallimard, Parigi 2018.

Bibliografia Kritike

BENEDETTI Carla, *A Gamba Tesa: a proposito di Ornela Vorpsi*, in «L'Espresso», n.3, 2006, p. 123.

BOND Emma, *"Verde di migrazione". L'estetica perturbante dello straniamento ne "La mano che non mordi" di Ornela Vorpsi*, in «Italies», n.14, 2010, pp. 411-425.

BOND Emma, *Il corpo come racconto: identità, storia e narrazione nell'Educazione siberiana di Nicolai Lilin e Bevete cacao van Houten! di Ornela Vorpsi*, in *Letteratura italofona transculturale*, a cura di KLEINHANS Martha e SCHWADERER Richard, Königshausen & Neumann, Würzburg 2013, pp. 309-322.

BOND Emma, BURNS Jennifer e MAUCERI Maria Cristina, *Intervista inedita a Ornela Vorpsi*, in *Il confine liquido*, a cura di BOND Emma e COMBERIATI Daniele, Besa Editrice, Nardò Lecce 2013, pp. 203-220.

COMBERIATI Daniele, *La produzione italofona dell'Europa orientale attraverso l'opera di Ornela Vorpsi* in Id., *Scrivere nella lingua dell'altro. La letteratura degli immigrati in Italia (1989-2007)*, Peter Lang, Bruxelles 2010, pp. 215-254.

CORTELLESSA Andrea, *La terra della prosa. Narratori italiani degli Anni Zero (1999-2014)*, L'Orma Editore, Roma 2014, pp. 519 e segg.

FEDERICI Anna, *Autopsia dell'animo : la migrazione nei romanzi di Elvira Dones, Ornela Vorpsi e Anilda Ibrahimi*, in «Linea@editoriale» n. 3, 2011, pp. 79-94.

JACQUET Marie Thérèse, *Ornela Vorpsi: viaggiare in punta d'inchiostro* in Av. Vv., *Letteratura adriatica. Le donne e la scrittura di viaggio*, Atti del II Convegno Internazionale, a cura di CARRIERO Eleonora e SCIANATICO Giovanna, Edizioni del CISVA, 2011, pp. 307-320.

KARP Karol, *Tra viaggio, cultura e identità. La mano che non mordi di Ornela Vorpsi*, in «Romanica Cracoviensia», n. 4, 2015, pp. 270-278.

KLEINHANS Martha, *Cerchio e freccia: figure ambivalenti del desiderio nella scrittura transnazionale di Ornela Vorpsi*, in «900 Transnazionale», n. 1, Marzo 2017, pp. 94-109.

LIBERALE Paola, *Nell'orecchio il fragore delle pareti che crollano. Come la scrittura femminile ricompone il mosaico*, in Atti XIX Congresso ADI, Roma, 9-12 settembre 2015, pp. 2-6.

MAISTRELLO Mary, *Intervista a Ornela Vorpsi: Io, l'Albania e la bellezza che disturba*, in «Cafebabel», 18 gennaio 2008.

MAUCERI Maria Cristina, *L'Albania è una ferita che brucia ancora. Intervista a Ornela Vorpsi*, in «Kumà», n.11, aprile 2006.

MESCHINI Michela, *Il controcanto delle scrittrici migranti: Ornela Vorpsi e le radici leggere della bellezza*, in Aa. Vv., *Tra innovazione e tradizione, Un itinerario possibile: Esperienze e proposte in ambito linguistico-letterario e storico-culturale per la didattica dell'italiano oltre frontiera*, a cura di CALDOGNETTO Maria Luisa e CAMPANALE Laura, Edizioni Convivium, Luxembourg 2014, pp. 299-314.

PERRONE Domenica, *Il lungo viaggio di Gabriella Ghermandi, Cristina Ali Farah, Igiaba Scego e Ornela Vorpsi*, in Av. Vv., *Leggere la lontananza. Immagini dell'altro nella letteratura di viaggio della contemporaneità*, a cura di CAMILLOTTI Silvia, CROTTI Ilaria e RICORDA Ricciarda, Edizioni Ca' Foscari, Venezia 2015, pp. 71-82.

PINZI Anita, *Corpi di donna in "Il paese dove non si muore mai" di Ornela Vorpsi*, in *Il confine liquido*, a cura di BOND Emma e COMBERIATI Daniele, Besa Editrice, Nardò Lecce 2013, pp. 167-184.

POLIZZI Goffredo, «Nei paesi del sud le stelle sembrano più vicine»: Culture, Sexuality and Self-Translation in Ornela Vorpsi›s *"Il paese dove non si muore mai"*, in «Scritture migranti {rivista di scambi interculturali}», n.12, 2018, pp. 167-190.

TADDEO Raffaele, *Letteratura nascente*, Raccolto Edizioni, Milano 2019, pp. 369-370.

VÁCLAV Marek, *Tra l'Occidente e i Balcani. L'opera narrativa di Ornela Vorpsi*, in «Studia Litteraria Universitatis Iagellonicae Cracoviensis», n. 3, 2014, pp. 191-200.

Shënime për librin "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë"

YLLI ÇABIRI MES SAMIUT E KONICËS

Nga Ilir Mborja





Kur më ra në dorë libri i Doktorit të Shkencave Ylli Çabiri "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë" tregova interes edhe për faktin, se me autorin e librit ruaj kujtimin e miqësisë të hershme. Ndërsa vetë Yllin e kam takuar për së pari në vitin 1982 kur ai sapo ishte kthyer nga studimet në Francë. Po e tregoj atë, jo vetëm si një kujtim që më mbeti në mendje atëherë, por për të dalë në përfundimin se suksesi i librit të tij sot ka qenë i paracaktuar. Mbaj mend nga ajo vizitë, që në një moment, biseda rrodhi tek frëngjishtja e, me shumë modesti, midis të tjerash, Ylli më tregoi: "Kur zbrita për së pari në aeroportin e Parisit e ndesha me francezët e parë që flitnin shumë shpejt, megjithëse kisha kryer kurse shumë intensive me tre "Monge"-të etj., mu duk se ajo që mendoja se dija frëngjisht, nuk kishte qenë shumë e vërtetë... Por "Pardon!" e "S'il vous plait!" i kuptoja. Vetëm këto ishin fjalët që dëgjova disa herë brenda pak minutave në dendësinë e njerëzve që lëviznin me nxitim. "Më fal!" dhe "Ju lutem!" ishin fjalët pa të cilat s'mund të bëje dot një hap në korridoret e aeroportit të Parisit."

Pse e tregova këtë dhe ku desha të dal, do t'jua them në fund. Tani po hidhem e po them diçka konkretisht për librin.

***

Jo vetëm nga titulli, por ndoshta edhe nga misioni, libri "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë" e Ylli Çabirit të sjell ndërmend veprën "Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet" e ideologut të Rilindjes sonë Kombëtare, Samiut të madh... Por, pasi lexon gjithë librin dhe e mbyll faqen e fundit të tij, merr vesh se, veç dashurisë dhe përgjegjësisë atdhetare të përbashkët, ky libër voluminoz është diçka krejt tjetër nga manifesti romantik i shekullit të kaluar që na la Sami Frashëri. Pra, mund të themi me plot gojën, se, në botën e botimeve aktuale shqiptare, deri më sot, "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë", është libër i parë në llojin e vet. Përvoja prej 27 vjetësh në institucionet vendase dhe ato ndërkombëtare pasqyrohet në 500 faqet e këtij libri në stilin e një ekspertize të mirëfilltë akademike. Me konstatimet që shpesh herë janë diagnostikime shumë të dhimbshme, autori duke dëshmuar kapacitetin e tij prej hulumtuesi me intuitë, i kushton një vëmendje të posaçme fenomeneve dhe nuancave të tyre, që shpesh, pleksen e ngatërrohen me njëra-tjetrën. Pastaj, na servir edhe recetat teknokrate për zgjidhjen e tyre. Ylli Çabiri, si një mjek i aftë i cili ia di mirë radhën punëve, që "Shqipëria jonë të mundë të shërohet" nuk e fsheh aspak diagnozën e pacientit shtet. Përkundrazi, diagnoztikimi është puna e parë dhe, çdo recetë pastaj, doktor Ylli Çabiri, na e servir vetëm pas një skanimi e check-up-i të hollësishëm. Pra, të gjitha këto plagë të shtetit dhe "demokracisë" sonë alla shqiptarçe, në libër jepen e numërohen një për një me një guxim e mençuri që të kujtojnë shqisat e mprehta të Faik Konicës për të diagnostikuar plagët e shoqërisë, por aspak stilin idhnak të tij që nuk ofronte kurrë zgjidhje...

Në këtë libër, në kapitujt e renditur me korrektesë prej shkencëtari, krahas çdo problematike që trajtohet, jepen edhe rekomandimet përkatëse. Këto e bëjnë këtë libër një botim të rrallë për nga misioni, forma, përmbajtja dhe mesazhet shpresëdhënëse që jep...

Autori në parathënie nënvizon se ""Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë" është një libër teknико-apolitik që trajton problemet kapilare të sistemit shtetëror, shoqëror dhe politik të Shqipërisë". Kur lexon librin, mendoj se kjo fjali është pjesërisht e saktë. Përcaktimi si një libër "apolitik", druaj se nuk është gjetja e duhur. Autori, me sa duket, nga dëshira për të shmangur sa më shumë prononcimet e drejtpërdrejta për politikanët zullumqarë, është kujdesur që të merret vetëm me zullumet e politikës dhe autorët e tyre të mos i ketë objekt stigmatizimi. Ylli Çabiri distancohet dukshëm nga veset e partiakëve të mbrapshtë, por në asnjë rresht të librit (dhe kjo mendoj se është vlerë) nuk shpreh fije urrejtjeje për askënd nga politikanët, siç bënte Faik Konica kur e shtrydhte gjithë tëmthin në polemikat e tij. Parë në këtë këndvështrim, mëdyshem, se, vërejtja apo sugjerimi im për të mos e përcaktuar si "apolitik" librin, edhe mund të mos jetë me vend. Autori ynë, i pa interesuar për të vënë gishtin tek emrat e partive dhe udhëheqësve të tyre në rastet negative, merret vetëm me zullumin dhe aspak me zullumqarët. Në asnjë rast, në asnjë rresht të librit, nuk polemizon me ta. Këtu ndahet plotësisht autori ynë me Faik Konicën që me pendën e tij i masakronte kundërshtarët e vet.

***

Siç kanë vërejtur me të drejtë edhe analistë të tjerë, më shumë se kaq, ky botim është një manual për ndërtimin e shtetit modern dhe reformave të munguara në Shqipëri. Ylli Çabiri në këtë libër, nuk mjaftohet vetëm së treguari plagët e shtetit dhe demokracisë shqiptare. Në një mënyrë mjaft elegante krahas çdo problematike që trajtohet në kapituj, jepen edhe ilustrime nga përjetimet vetiake të tij. Kjo mënyrë e shkruari, me një stil ku në shumë raste ndjehet një sens i hollë humori, e bëjnë veç të tjerash një libër që lexohet me endje nga çdo njeri. Ylli tregon se në vitet '80, kur ishte i ftuar në një mbledhje nga Organizata Bazë e Partisë së Institutit të Studimeve e Projektimeve Metalurgjike që përbëhej prej 8 vetash (nga 3 inxhinierë, 3 tushistë, 1 pastruese dhe 1 bibliotekare,.. dmth "kompetentët" ishin në shumicë) dhe diskutohej për një çështje vetëm teknike (por shumë të rëndësishme) qëndroi aty deri në momentin kur sekretari, shoku i tij tha fjalët: "Të ftuarit të na falin!"... Dhe këtë e thoshte në shumës vetëm për jo-komunistin, drejtorin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve Siderurgjike... Por, e qeshura që të shkaktohet nga situata komike që krijonin paradokse të tilla në të kaluarën, të kthehet në një buzëqeshje të hidhur kur vëren paralelet me shpërfilljen e kritereve për vlerësimin profesional në qeverisjet e sotme. Pikërisht për këtë stil të shkruari, librin e teknicienit Ylli Çabiri nuk mund ta lëshosh nga dora deri në përfundim.

Në librin voluminoz, autori ka gjithmonë parasysh faktorin KOHË. Shpërfillja e saj, nuk ndjehet vetëm tek kapitulli "Ndalimi i kohës" apo "Duke pritur trenin" që autori e nis kështu: "Kjo nuk është një shaka fëmijësh me tren. As thjesht një metaforë me tren. Është një nga çështjet më serioze të këtij libri.". As kur e thotë copë si në rastin e Çadrës së famshme të 18 shkurtit 2017: "Ndryshe treni po na ikën edhe këtë radhë dhe askush nuk e di se kur mund të kalojë përsëri! Nëse do të kalojë! Nëse ka ndërmend të kalojë përsëri!"... Diku tjetër autori jep konstatimin mëse të vërtetë të Konicës për ne: "...shqiptarët kur i lë treni, asnjëherë nuk thonë që u vonuam, por thonë na iku.".

Koha, alarmi për humbjen e saj, ndjehet pothuaj në gjithë faqet e librit. Koha, sjelljet e pushtetarëve ndaj kësaj vlere të paçmuar, që jo vetëm e kanë shpërfillur dhe përçmuar, por edhe masakruar, ndjehet si një tension konstant në nëntekstin e faqeve të librit... "Në kërkim të kohës së humbur" titullohej pamfleti i Marsel Prustit dhe po të mos e kish huajtur më '90-n Ylli Popa për pamfletin e tij, do t'ia kisha rekomanduar si nën titull autorit tonë po të më pyeste... Për të kapur kohën e humbur, që, aq shumë, me një padurim pothuajse ekstrem e presim të gjithë.

Në gjithë rreshtat e librit ndjehet jo vetëm pesha e mendimeve të një profesori me përvojë të gjatë në institucionet ndërkombëtare, por edhe shqetësimi i një intelektuali atdhetar që ka parë nga afër gabimet fatale të shoqërisë dhe politikës në dëm të shtetit. Troç e thotë Ylli Çabiri. Edhe politikanëve, edhe neve: "Sot, pas më shumë se dy dhjetëvjeçarësh tranzicion është kuptuar qartë se problemi themelor i Shqipërisë nuk ka qenë krimi i organizuar, por shteti i çorganizuar.". Pastaj konkludon: "Krimi, trafiku, varfëria, papunësia, droga, mungesa e drejtësisë janë para së gjithash pasoja të Qeverisjes së çorganizuar. Problemi nuk është thjesht të përmirësojmë Qeverisjen. Reformimi thelbësor dhe sa më i shpejtë i Qeverisjes duhet të jetë Mbireforma! Pa reformuar Qeverisjen, nuk mund të realizohet asgjë dhe ky është një parakusht i domosdoshëm për çdo Reformë e ndryshim tjetër që sipërmerret"...

Pastaj, të 125 rekomandimet e Ylli Çabirit në këtë libër, janë servirur me modestinë e një akademiku të urtë elbasanas.

Papërgjegjësia si parim qeverisës, mungesa e profesionalizmit, deri dikur edhe e justifikuar, "sëmundjet" e një lirie të keqkuptuar e të keqpërdorur, etja për pushtet e pushtetarëve, korrupsioni, etj., kanë shkretuar shtetin, pyjet, ambientin, natyrën, shkollën, shëndetësinë, familjen, rininë, shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Efektet e këtyre qeverisjeve kanë ndikuar, ku më pak e ku më shumë, në jetën e çdo individi. Ndërsa, procesi i sforcuar i reformave në Shqipëri, rezistenca për t'i stopuar, edhe pse më së shumti i takon së kaluarës, vazhdon të shfaqet edhe sot në forma të tjera perverse, si pasojë e jetës në një shoqëri të infektuar keq me urrejtje institucionale dhe me luftën e re të klasave...

Diçka tjetër që më ka lënë përshtypje në këtë libër është edhe forma se si autori i qaset objektit për të realizuar objektivin. Po e them më thjesht. Objektivi është: Shqipëria të bëhet. Për të arritur këtë objektiv, autori nuk mjaftohet vetëm me metodën e ekspertizës akademike. Objektivi i tij nuk anashkalon, por kur vjen rasti, vëzhgon e fotografon edhe përjetimin e njeriut më të thjeshtë. Kështu p.sh., për të verifikuar të vërtetën me sllavët, Ylli Çabiri, nuk mjaftohet me deklaratat e planet rezervë të elitave politike të Rajonit. As me deklarimet e zotit Juncker dhe raportet e tij me politikën e re të ndryshueshme për rajonin e Ballkanit me ardhjen e Trump-it në Shtëpinë e Bardhë... Në libër, në faqen 212, autori sjell opinionin e një pastruesi hoteli në Malin e Zi dhe aty marrim vesh se, ata që votojnë në referendume, janë shumë larg atyre që deklarojnë elitat e sipërpërmendura. Po jua sjell këtë paragraf: "E dini ç'më tha njëherë pastruesi i hotelit? Ne nuk duam të jemi në Perëndim! – Po ju sapo e bëtë hapin e parë, bëtë një Referendum për t'u anëtarësuar në NATO dhe u shprehët në favor të Perëndimit – ia ktheva unë. – E bëmë, keni të drejtë, por aspak për po-në. Këtu është bërë traditë që ne votojmë dhe politikanët numërojnë."

Gjithashtu, duke lexuar faqet e këtij libri, kupton se kanë qenë iluzive shumë prej pritshmërive e perceptimeve tona për ndihmën e ndërkombëtarëve, për "shenjtërinë" e tyre, apo për "imunitetin" që besonim se ata kishin ndaj sjelljeve hipokrite, etj...

***

Shkurt, në këtë libër merr vesh se cili është çelësi i duhur që Shqipëria jonë të hapë derën e Evropës dhe cili nuk është çelësi korrekt që duhet të përdoret për të çelur portat e investimeve të huaja, prokurimeve publike, kontratave që quhen partneritet – publik - privat (p.p.p.). Lexoni këtë libër dhe do të kuptoni se ç'ndodh ndonjëherë me to po të përdorësh çelësin e gabuar. Përvoja e hidhur e vendeve të tjera si e Zelandës së Re apo Indisë, me këto lloj kontratash me p.p.p., s'ka pse injorohet... Ndërsa mua, duke dëgjuar zhurmën me sulme e kundërsulme që bëhet këto ditë në Shqipëri pikërisht për këto kontrata dhe shpjegimet e ilustruara të Ylli Çabirit si, edhe kur përmend Çadrën e 18 qershorit 2017 në këtë libër, m'u kujtua ajo që më ka treguar një frankofon tjetër i dëgjuar, përkthyesi i Balzakut, Enver Fico. Çelësin që në mënyrë jokorrekte hap çdo derë dhe të cilin ne shqiptarët e quajmë "kopil", në frëngjisht dikur i thonin "monsieur", d.m.th. zotëri. Për mendimin tim kjo metaforë gjuhësore shpjegon psikologjinë e popujve të diktuar nga historia në shekuj. Po të shikosh në fjalorin tonë, përveç kuptimit të parë për një fëmijë ilegal e pa atësi dhe çelësit që në mënyrë jokorrekte hap çdo derë, ai, fjalori ynë pra, shpjegon edhe për një "njeri të zgjuar e të shkathët që zgjidh çdo nyje e pengesë, etj...". Pra, po ta analizojmë këtë fjalë me një metodë fillestare sociolinguistike, del që ne shqiptarët, ndryshe nga francezët, historikisht ia kemi hapur derën kanat më kanat bastardëve dhe shpesh herë s'e kemi pasur për turp të lemë pas saj zotërinë. Pikërisht prej këtij mentaliteti të shëmtuar, më 25 prill të 2017-s, kur bujtën në Tiranë "zotërinjtë" e Brukselit David McAillister

dhe Knut Fleckenstein, në përpjekjet e tyre për të mbyllur Çadrën e opozitës, dështuan. Mbetej të provohej një çelës tjetër. Amerikan.

Çelësin në fjalë, amerikanët e quajnë "master" - (mjeshtër). Pra, "master key" që do të thotë "çelës mjeshtër", u provua pas dështimit të "zotërinjve" të Brukselit e funksionoi. Domethënë, vetëm lëvizjet e kombinuara të dhëmbëve të një "mjeshtëri" amerikan, siç ishte Zëvendës/ndihmës Sekretari i Shtetit amerikan Hoyt Brian Yee i nxorri nga Çadra dhe i futi atje ku duhet deputetët tanë... Por në librin "Shqipëria mund të bëhet/..." marrim vesh se "amerikançja" që shpërfill dukshëm modestinë, ndonjëherë, edhe në Evropë, funksionon më mirë se gjuha e Brukselit. E kam fjalën për rastin që tregon Ylli Çabiri, kur aplikoi për të fituar një projekt evropian dhe përdori "amerikançen" që i rekomandoi i biri. Pyetjes së intervistuesit se, pse mendonte se duhet ta fitonte pikërisht ai ndërmjet shumë konkurrenteve atë projekt, garisti Ylli Çabiri iu përgjigj ashtu siç i rekomandoi i biri me notropi amerikane: "Se mendoj që jam më i miri"... Dhe e fitoi garën. Pra, "amerikançja" funksionoi për mrekulli, megjithëse "i lëndoi" pak zotërinjë e Evropës me shfaqjen e mungesës së modestisë nga ana e tij...

***

Besoj se tani në përfundim erdhi radha t'ju them se ku doja të dilja me atë që ju tregova qysh në fillim për dy fjalët "Pardon!" e "S'il vous plait!" që atëherë mysafiri im Ylli Çabiri më tregoi se ishin të vetmet që dëgjoi e kuptoi kur shkeli përsëpari Parisin. Pra, "Më fal!" fjala që më pak se kushdo e kemi pasur gjithnjë të vështirë ta përdorim ne shqiptarët si, edhe bindja ime kur i dëgjova, se pa to mund të kaloja 10 jetë e s'do të më hynin asnjëherë në punë, më çuditën shumë atëherë. Sot, pas gati 40 vjetësh, Ylli Çabiri përsëri na çudit me një libër që mund të kishte si titull a nën titull edhe fjalën magjike "Më fal!", fjalën përulëse të munguar në fjalorin tonë si shoqëri e rrjedhimisht, edhe në mentalitetin arrogant të pushtetarëve që kemi pjellë. Tek "Parimi i dhjetë: PËRULËSIA", autori nënvizon që "Qeverisja e mirë kërkon përulësi të përhershme". Megjithëse kanë pasur jo pak raste, asnjëherë nuk i kemi dëgjuar të thonë "më fal!" politikanët tanë, ndërsa, "ju lutem!", e dëgjojmë të na e thonë me përgjërim vetëm kur na kërkojnë votën.

Në fund të librit, para se të jepen përmbledhtazi të 125 Rekomandimet e çmuara, Ylli Çabiri, nuk harron të japë edhe një ofertë prej fisniku: "Kushdo që gjen diçka racionale në Rekomandimet që jepen, është i lirë t'i përdorë si të dojë, madje edhe duke i servirur si të tijat, si origjinale. Mua dhe çdo shqiptari të shqetësuar për të ardhmen, na mjafton që ato të realizohen, të ndodhin, të fitojnë." Me këtë sjellje prej bujari, Ylli Çabiri bashkohet me ëmbëlsinë karakteriale të Sami Frashërit e me optimizmin e ndrojtur të tij, ashtu siç, me Faik Konicën, e bashkon vetëm shqisa e mprehtë për të përcaktuar saktë diagnozën e sëmundjeve shqiptare.

Për të gjitha këto pra, kur mbyll faqen e fundit të librit "Shqipëria mund të bëhet me qeverisje të vërtetë", merr shpresë e besim në atë që konkludon autori në fjalinë e fundit të parathënies: "Besimplotë ju them se: Është e mundur që Vendi ynë të qeveriset drejt dhe siç duhet. Është plotësisht e mundur që Shqipëria të bëhet!"

Ndërsa ne na mbetet t›i përgjigjemi me plot gojën: Faleminderit Ylli Çabiri që këtë shpresë na e ndriçon me një libër të vërtetë. Libër në kuptimin e parë të këtij nocioni të dëmtuar rëndë nga inflacioni, si pasojë e abuzivizmit që ndeshim shpesh për shkak të "sëmundjes së lirisë", që ka prekur edhe politikën e botimeve tona, por jo Shtëpinë Botuese dinjitoze "Onufri". Me libër prej vërteti, iu drejtohet të gjithë atyre që duan që Shqipëria jonë të bëhet...

Athinë, 7 tetor 2018.

Zhgënjimi si pika e takimit dhe pika e ndarjes mes "Iluzione të humbura" dhe "Komediania"

Nga Noeh Pantalija



Seria KM e shtëpisë botuese "Albas" ka pasuruar bibliotekën shqipe me përkthime e ripërkthime të disa kryeveprave botërore. Mes tyre është edhe libri "Komediania" i shkrimtarit polak Władysław Stanisław Reymont ardhur në shqip nga Edlira Lloha. Për krijimtarinë e tij, Reymont mori çmimin "Nobel" më 1924, kohë kur, sipas arkivave të vetë "Nobel"-it ishin në konkurim edhe Thomas Mann, Grazia Deleda, Bernard Show, Thomas Hardy etj.. (shih. Granit Zela, "Arkivat e Nobelit", portali *Peizazhe të fjalës*, dhjetor, 2022). Motivacioni i dhënë nga juria ishte *për epizmin e jashtëzakonshëm kombëtar*. Sipas kritikëve, i përket rrymës së natyralsitëve, aq e përhapur si *risi* në fundin e shekullit XIX dhe fillim e të XX.

Në leximin e parë të tekstit, shohim jetën e thjeshtë të Jankës që e nxitur nga dy shkaqe, mosbindja ndaj të atit dhe ëndrra për të qenë artiste, merr përsipër të ndjek udhën, sipas saj *të duhur* për në botën orinike të aktrimit. Pritshmëritë e saj janë të mëdha, ideali i ndriçon fort dhe është e bindur se pasioni, talenti dhe vullneti do të mjaftojnë për t'i krijuar mundësinë që të krijojë vendin e saj në hapësirën ku po kërkonte të përkiste.

Kjo menjëherë më kujtoi Lusienin e Balzakut te "Iluzione të humbura". Nuk mund të thuhet nëse Reymonti komunikoi dot me këtë tekst, pasi sipas rekordeve në *Bibliotekën Kombëtare t*ë *Polonis*ë, shohim se për herë të parë ky libër u botua në vitin 1919 nën përkthimin e Tadeusz Boy-Żeleński. Ndonëse mjek në profesion, Żeleński shkroi disa vepra, por kontributi më i shquar e tiji mbeti përkthimi i mbi 100 klasikëve frëng në polonisht. Ndërsa "Komediania" u botua më 1896. Gjithsesi, komunikimi ose jo i këtyre dy veprave nuk është objekt i shkrimit tonë.

Për ne është e rëndësishme të identifikojmë pikat ku takohen Janka me Lusienin, jo për të dëshmuar *komunikimin e autorëve,* por *plazmimin e konteksteve* në një botë që përherë *ka pasur problematika të njëjta dhe për to, ka ofruar zgjidhje të ndryshme*.

Sipas shkrimeve të kohës, thuhet se Reymonti u nxit për shkrimin e "Komediania" nga eksperienca e vet në teatër. Prandaj edhe personazhi kryesor është një aktore në tentativë. Te Balzaku, Lusieni është një shkrimtar në tentativë.

Si Janka, si Lusieni ëndërrojnë përtej kufijve brenda të cilëve gjenden të mbyllur, *they dreamed big* do të thuhej sot kur globalizmi e ka kthyer në *fakt* ekzistencën e problematikave të njejta, por me një tjetër synim, të unifikojë edhe zgjidhjet. Atëherë nuk do të kishim më letërsi, por gazetari e ndoshta për t'i shpëtuar kësaj trysnie u nxit krijimi i *post-industrializmit; post-modernizmit; post-post-post...*(kushedi se kujt) dhe tani që letërsia po thuret sërish mbi baza realiste që krijojnë të ashtuquajtrin *neorealizëm*, synimi i globalizmit mund të jetë ose më pranë plotësimit se kurr, ose drejt zhbërjes së pashmangshme. Kjo mbetet për t'u parë, dhe kjo duhet parë nëpërmjet një optike për ndërtimin e të cilës është edhe ky shkrim.

Kuturisja për krahasimin e dy personazheve më sjell ndër mend librin *Sinagoga e ikonathyesve* të J. Rodolfo Wilcock, ardhur në shqip nga *Pika pa sipërfaqe* nën përkthimin e Arben Dedjas. Është një katalog personazhesh me jetë aq pranë reales, saqë kur kupton nga fundi se në fakt kemi të bëjmë me gjëra krejt të çuditshme e të pangjashme, befasohesh e ngelesh si guak, me lezetinë e të ndjerit i mashtruar nga një gënjeshtër aq e bukur. Ndodh kjo pasi kur fillova leximin e "Komediania" dhe vura re këto që thashë më lart dhe mandej u hasa me zhgënjimin e Jankës, isha i sigurt që në leximin e radhës të "Iluzione të humbura" ngjashmëritë do të rridhnin me po të njëjtin likuiditet. Nuk ndodhi kështu!

Po, të dy personazhet zhgënjehen nga bota ku donin aq shumë të ishin e vrenda së cilës më në fund u gjendën, por shkallët e zhgënjimit dhe përfundimi i tij janë ndryshe:

Lusieni, për një farë kohe u ndje i vlerësuar, madje më tepër sesa kishte ëndërruar ndonjëherë. Krijoi emër të shquar mes njerëzve të rëndësishëm, u ndje i vlerësuar dhe mendoi se po jetonte në atë çka përherë kishte dashur. Por kur arriti në majë, i fryrë prej atyre që donin ta shihnin në fund, ju bind pa dashur dhe pa ja kërkuar njeri dëshirës së tyre dhe menjëherë rrëshqiti poshtë. Sikundër thuhet ndër ne, *U ngjitsh' e mos arrifsh' majën* sepse kur je aty, domosdoshmërisht fillon zbritja. Thënë nëpërmjet vetë titullit të librit, Lusienit iu lejua të krijonte iluzione e mandej t'i humbiste ato, krijim që me patjetër kaloi mes disa peripecive.

Janka, nga ana tjetër sapo gjendet në botën konkrete të artit, zhgënjehet. Tek na jep përsiatjet e saj, narratori na thotë se ajo *ëndërronte dikur për këtë botë dhe për këta njerëz, në mesin e të cilëve, tani po hidhte hapat. Prapë e ndiente se diçka i mungonte, se ajo që kishte krijuar në fantazinë e vet ishte njëqindfish më e madhe dhe e fuqishme dhe se do të duhej t'i jepte më shumë kënaqësi.* Pra zhgënjimi është i njëkohshëm me arritjen, ndaj ajo nuk shijon dot asgjë prej asaj *arritjeje*. Menjëherë i thuhet se duhet dhënë rryshfet, se duhen siguruar para në mënyra nga më të ndryshmet – arti nuk mjafton kurrë – se duhet t'i serviloset drejtorit që kështu gjithë të tjerët t'i serviloseshin asaj etj.. Dhe sëfundmi, gënjehet: Roli i premtuar për të *nuk i jepet*. Ky është *kryezhgënjimi* i saj drejt të cilit arrin duke kapërcyer shkallë-shkallë zhgënjime të tjera.

Këtu ndryshon *zhgënjimi polak* nga *zhgënjimi francez*. Ai polak vjen natyrshëm, ngadalë, me ulje-ngritje por përherë pas tyre duket prania e tij. Ndërsa ai francez vjen si kontraput i papritur *për personazhin*, lexuesi e ndjen herëpashere afrimin e tij dhe me ankth pret nëse do të dalë apo jo e po ndodhi, do ta dijë qysh më herët kur dhe si.

Si përfundim, të dy mbeten të papunë, të pashpresë dhe të patëardhme. Si Lusieni, ashtu edhe Janka janë në të njëjtën pikë sërish! Po tani, çfarë do të bëjnë?

Kur shpenzoi gjithçka pati, u bë zi e madhe buke në atë vend e djali filloi ta provojë skamjen. Atëherë shkoi e u lidh rrogëtar te një njeri i atij vendi. Ky e dërgoi në toka të veta t'i ruajë thitë. E dëshironte ta mbushte së paku ndonjë herë barkun me kokrra çiçibunesh që hanin thitë, por askush nuk ia jepte.

Atëherë i erdhën mendtë e thoshte: "Sa mëditësve tim atë u tepron buka, kurse unë këtu po vdes urie! Do të çohem e do të shkoj tek im atë e do t'i them: O atë, rashë në mëkat kundër Qiellit e ndaj teje! Nuk jam më i denjë të quhem yt bir; më prano si një ndër rrugëtarët e tu."

U çua dhe e mori rrugën të kthehet tek i ati.

(Ungjilli sipas Lukës, 15, 14-20)

Kthimi i Lusienit përsëri te prindërit në rrethina më kujton pikërisht këtë pasazh biblik tepër të njohur. Ai e di se nuk ka ku të shkojë tjetër pasi askund nuk do ta pranojnë përveçse aty. Dhe atë bën, shkon për të rilidhur fillin e jetës së tanishme me atë të atëhershme, mbetur akoma aty. Janka jo! E zhgënjyer, e mërzitur, e vetmuar dhe me siguri në gjendje paqëndrueshmërie mendore, ndërmerr vetvrasjen. Por nuk ka kuptim ta them a ja del dot, apo jo?

Duket sikur francezi Lusien është njohës më i mirë i sjelljeve të krishtera sesa polakja Janka, paçka se dihet cili komb ka besuar e beson më shumë. Pse ndodh kjo, apo ngaqë *edhe djalli e citon Biblën për interesat e veta*? Jo, s'mendoj të jetë kjo!

Zgjidhja biblike në rastin e djalit plëngprishës është më pranë *zgjidhjes logjike* të dikujt në gjendjen e këtij djali, gjendjen e Lusienit apo atë të Jankës. Prandaj (ndoshta) edhe realizohet nga Lusieni. Ndërsa hiper-ndjeshmëria e Jankës, mbrujtur prej rrethanave të rritjes së saj dhe mbi të gjitha, prej rrethanave ku gjendej Polonia e asaj kohe (nën pushtimin e Perandorisë Ruse) sigurisht që do ta shpeinte atë në një zgjedhje të atillë.

Për veprat që bëhen klasike e kështu kthehen në kryevepra, nuk mund të diskutohet një zgjidhje *deus ex machina*. Është interesante sesi kur duket se dy zgjidhjet e vetme janë dy zgjidhjet e zgjedhura nga Balzac dhe Reymont, sërish asnjëra prej tyre nuk është e atillë. Ngaqë fabula është ndërtuar në mënyrë aq të përkryer dhe subjekti e zgjeron atë pikërisht aty ku duhet, ashtu si duhet, pa tejkaluar asgjë dhe pa u tkurrur para asgjëje.

Leximi i "Komediania" është një përjetim krejt i ndryshëm nga leximi i "Iluzionet e humbura", por ndonjë çelës i përftuar gjatë leximit të këtij të dytit mund të na ndihmojë për të lëvizur më kollaj disa koltrina që padashur rrinë të mbledhura dhe pengojnë dritën e të parit.

NJË VEPËR FABULARE E FERIT LAMAJT KUSHTUAR KADARESË

Nga Astrit Bishqemi

Kohët e fundit krijuesi i begatë Ferit Lamaj publikoi dy vëllime të reja me fabula: *Deveja pranë kullës Eifel* dhe tjetri, i cili edhe u përurua në Shtëpinë Studio Kadare, *Satira dhe sarkazmi kadarean*. Dua të përqëndrohemi me dy fjalë vetëm në disa anë të përgjithshme të librit kushtuar Kadaresë.

Siç të sinjalizon qysh në titull, vëllimi ka humor, satirë e sarkazëm. Janë hulumtuar episode nga **vepra** dhe **jeta** e Kadaresë. Një punë e lodhshme këmbëngulëse, duke kaluar nëpër duar tërë veprën kolosale të shkrimtarit tonë të shquar, madje edhe nja dy libra të bashkëshortes së tij, zonjës Helena. Materiali prozë faktik i përzgjedhur (autori na jep shembuj fragmentesh në parathënien e vet që shoqëron vëllimin) përbën mineralin bazë, i cili është pasuruar, kristalizuar e kornizuar në laboratorin e fabulistit. Kësisoj, mençuria kadareane është transplantuar dhe tretur, aliazhuar me artin e mprehtë feritian duke na dhënë disa krijime të bukura me vlera estetike e morale.

Kuptohet që nga vepra e çiftit Kadare Feriti ka qëmtuar e ka përzgjedhur fragmentet që i interesojnë, ato që përmbajnë humor, satirë e sarkazëm. Mandej me këto fragmente ka krijuar fabula, duke i ngritur më tej artistikisht ato episode. Ja, fjalabie, një fragment i tillë nga romani "Hija", të cilin na e kujton vetë ai në parathënien shoqëruese:

"*Për të parë filma erotikë të stacioneve private italiane, njerëzit thyenin këmbët e duart duke u kacavjerrë nëpër pullaze për të vënë gjithfarë antenash që u ngjanin tiganëve, oturakëve, fuzhnjës së peshkimit ose kurorës me gjemba të Krishtit. Të tjera ngjasonim me pirunë, shishqebapë, vegla të abortit e dreqi e dinte çfarë. Thoshin se u qepeshin pullazeve pleqtë me kyçet e mbërthyera nga reumatizmi, të damllosurit, madje edhe veteranët e dyzetenjëshit, ata që kishin themeluar partinë.*"

Ja edhe fabula përgjegjëse :

Antenat socialiste
(Filmat e stacioneve italiane)

Hardallosej njerëzia,
rinia e pleqëria,
për të parë, more mik,
ata filma erotikë
te stacionet italiane:
pa opinga e çitjane,
po me breçka, botë jallane!

Kacangjitje ndër pullaze
për të vënë antenat taze,
lloj-lloj formash, ore xhan:
antenë-tas, antenë-tigan,
antenë të gjatë sa bishti,
antenë me gjemba Krishti.

Fqinji lart kish për merak
një antenë-oturak;
fqinji poshtë, jo s`qe trap,
paska "skuqur" ...shishqebap;
fqinji majtas, dreq o punë,
kishte dy, "lugë e pirun".

Mbi pullaze, mbi tarracë,
kacavirrej kuç e maç;
do të hasje për midis
themelues të Partisë,
shallkuqmbajtës të rinisë...

Kryetar` i Frontit vetë,
bacë Tekiu tash dy vjet,
që banorëve u çërret,
e fsheh antenën, medet,
tip avjoni me dy fletë,
rrafsh me tarracën e vet...

Siç shihet, pasazhi që përshkruan Kadareja është bërë edhe më konkret, duke futur edhe disa personazhe, si: fqinji lart, fqinji poshtë, madje kulmi, kryetarin e Frontit, bacë Tekiun, që nga një anë u çërret banorëve e nga ana tjetër, fshehtas, ngre antenën e vet "speciale"...

Në librin fabulistik satirizohet koha e Diktaturës, jeta në atë regjim, administrata me njerëzit e saj, paaftësia e imoraliteti i tyre, dredhitë e dhelpëritë e njerëzve të thjeshtë dhe të kuadrove të partisë, të sekretarëve e të kryetarëve të Frontit Demokratik, dyzimi dhe dyfytyrësia e tyre. Edhe koha demokratike që jetojmë vihet në tehun e satirës.

Na parakalon kësisoj Shqipëria hallemadhe: më 1913 me problemin e kufinjve, më `20-n me Haxhi Qamilin, më `63-shin me prishjen e kishave e të xhamive, më `68-n me lëvizjen "T`i dhurojmë Partisë gjithë paret e kursyera", më `80-n me kafe elbin, më `90-n me Ramiz Alinë që s`i la pikë qumështi fshatarit, më `97-n me marsin e vetëvrasjes etj. U del boja udhëheqësit Hoxha me thesin e veprave e me parullën e tij "gju më gju me popullin", byroistëve me vizitat e tyre familiare me kuç e me maç jashtë shtetit, sekretarëve të parë të rretheve, kryetarëve të Frontit Demokratik, burgjeve shtetërore, ku, me gjuhën e fabulës, "*futet delja engjëll,/ del ujku viktimë!*", veteranëve ish-partizanë që rrahin gjoksin, etj.

Na parakalon Gjirokastra si qytet me bejtexhiun Vehip Qorri, gabelin Dan Veremi, polic Leninin etj. Po edhe qytete të tjerë, si: Tirana, Moska, Parisi, Stambolli, Beogradi, Pekini. Njerëz e krijues, si: Lasgush Poradeci, Drago Siliqi, Dritëroi, Sadik Bejko, Ilinden Spase, Kujtim Dashi, Gaqo Veshi, Çerçiz Loloçi... Po dhe persona të tjerë të njohur, si: botuesi Bujar Hudhri, diplomati Javer Malo, piktori Maks Velo, studiuesja Alda Bardhyli etj.

Veçanërisht kemi të dhëna me humor për jetën e Kadaresë, për personalitetin e tij, herë fëmijë, çunak në bankat e shkollës, i ri gjimnazist, student në shkollën e lartë; marëdhëniet e tij me përndjekësit nga Sigurimi i shtetit, me të afërm e fatrefis (nëna, motra, vajza, bashkëshortja, ungji i tij etj.) Sidomos na gazmon Kadareja me dhuntinë e tij si mjeshtër i fjalës në marëdhënie me të tjerët, që herë *fjalëqëndis* me shokë, herë *fjalëqibër*, herë *fjalërrufe*, herë *kunjëtar*, herë *llafçakmak* etj. Kadareja gjeni dhe Kadareja tokësor. Kadareja që me Nënë Terezën janë simbole të Shqipërisë e të shqiptarëve në botë.

Sidomos çikli "Humor mençuror miqësor", i cili pason në pjesën e dytë të librit, na njeh me shumë batuta të shkathta që shpërfaqin mendjen e mprehtë të Kadaresë në kontakt me njerëzit e tjerë në jetën e përditshme. Pra, është një këndvështrim tjetër, një kamerë e vendosur në jetën e tij private, që hedh dritë mbi karakterin dhe personalitetin e shkrimtarit.

Po për fabulat si krijime artistike, ç`mund të themi?

Së pari, e vlerësojmë këtë përmbledhje si **vepër unike** në llojin e vet letrar, një gjetje si zhanër. Për një personalitet mund të shkruhet një monografi, madje ndoshta edhe një studim për fjalorin e tij të gjerë, nëse është shkrimtar etj. Një i afërt i atij njeriu mund të botojë edhe një ditar. I kësaj natyre pothuajse është vepra e suksesshme *Kohë e pamjaftueshme* e bashkëshortes Helena për të madhin Kadare. Ndërsa veprën e Ferit Lamajt *Satira dhe sarkazmi kadarean* do ta konsideronim si një... "*Kohë e pamjaftueshme*" poetike.

Personazhet në këto krijime fabulistike janë përgjithësisht njerëz, madje më së shumti të identifikuar, por në të rrallë edhe kafshë, si në rastin e krijimit "Dy filatelistet", ku me humor, si te fëmijët, kemi dy dhelpra që bëjnë tregti pullash (dhe pulash)...

Për të shtuar humorin e sarkazmën fabulisti përdor mënyra e mjete të ndryshme artistike. Ja, te "Minoritari" parapëlqen vetën e parë, gjuhën e tij zhgrapa-zhgrupa dhe, kulmi, një gjetje e bukur me parullën "*Parti, Enver, jemi gati kurdoherë*", e cila nga minoritari shqiptohet "*Parti E dhjer*", Parti e dhjerë medemek!

Në përgjithësi fabulat e Ferit Lamajt kanë një humor me vel popullor. Këtë cilësi ua jep fakti se autori tregohet ca dorëlëshuar në fjalorin e tij poetik të ngjyrosur, duke aktivizuar fjalë të gjuhës së gjallë e të thjeshtë, të rëndomtë, ku të bien në sy edhe një mori barbarizma (turqizma më së shumti) apo shprehje popullore.

Ja disa fjalë të tilla të hulumtuara në këtë vëllim: *açik, ashiqare, kokëqyp, kokëkarroqe, gaxhitë, rrumbull, zabërhan, myteber, bash, gurgule, bilmez, jezit, lakut, rropulli, cicmic, i tromaksur, helbete, kaqol, thashethuqe, ngalas, qeder, eksiq, evlat, malukat, meazallah, rrospihane, gilivili, torovell, kodosh, broçkullit, firaun, dobiç, mollois, kokoleps, behet, more jahu, fjalëqibër, dërdëllit, qitap, zorzop, halabatak, rrumpallhane, begenis, zavalli, rrapa-shtrapa, zuskë, birbo, king, pallavesh, pispiruq, hardallosej, çërret, botë jallane, rrumaduc...*

Ja edhe disa shprehje popullore:

Ma bëre mendjen çorbë; e zë lepurin me qerre; soj e sorollop, i humbtë vula, bërë lesh e li, me kuç e me maç; është legen, s`iu prish giza, dridhe Like, një bythë vend, shtet veresie, na marrtë shurra, burrë sheleg, di se nga lidhet gomari, t`i vemë llafit qylaf...

Me mjeshtëri autori përdor folenë e fjalëve:

Për kokë Pashanë/ në këmbë krejt dovleti; ngjatjeton me dorë; ngaqë ngriti kokë / iu pre kokëqypi;

Këtë ngjarje ta varros,/ ta gropos;

Pra, i vdekuri te varri / të mbërthehet për së gjalli!

Madje edhe homoniminë e tyre:

Sy-çifte (çifja armë - AB) gjuajnë çifte (çifte të rinjsh, njerëz - AB);

Kadareja gjegjen nderi:/ - Ftesa është për "Legjon Nderi"

S`kishte shkelur kurrë më parë):/ - Shoku Sekretar i Parë;

Ai fët i hipi gazit/ ne të dyja ia plasëm gazit...

Nuk po zgjatemi të analizojmë cilësi të tjera të vyera artistike të fabulës feritiane, si: veshjen e tyre poetike me humor, braktisjen e moralizimeve; dendësimin, peshën e madhe specifike të ligjërimit; fundin e tyre ku të pret një finale e qëlluar, një gong, një befasi; globalizmin që i karakterizon; vargun e tyre klasik, me metër (përgjithësisht 8-rrokësh, por edhe 6-rrokësh ose të kombinuar), rimat e freskëta, që iu largohen atyre foljore e mbiemërore; pasurimit të fjalorit duke krijuar fjalë të reja me ndihmën e kompozitave etj. etj. Për të gjitha këto jemi shprehur gjerë e gjatë kohë më parë, madje qoftë edhe në parathënien që shoqëron përmbledhjen *Deveja pranë kullës Eifel,* që përmendëm në fillim. Janë cilësi që i karakterizojnë edhe krijimet e këtij vëllimi. Ndoshta në vështrim të parë mund të vërejmë se në këtë libër fabulat sikur zënë një sipërfaqe poetike më të madhe se zakonisht. Por, megjithë këtë shtrirje, ato përsëri e ruajnë konçizitetin, lakonizmin që kemi vënë në dukje. Se konçiziteti i një krijimi letrar, poetik apo prozë qoftë, nuk ka të bëjë me sasinë e rreshtave a të vargjeve. Një krijim mund të jetë i shtrirë por konçiz, pa ujë e pa llurbë. Këtë cilësi e ruajnë edhe këtu krijimet e mjeshtrit Ferit Lamaj.

Duke përfunduar na lind pyetja: cila është vlera e këtij botimi?

Themi me plot gojën e me bindje që kjo fabulistikë popullarizon edhe më tepër **veprën** dhe **personalitetin** e Kadaresë.

Urojmë poetin Ferit Lamaj për këtë dhuratë të bukur që na bëri ne, lexuesve.

Besnik Mustafaj: "Letrat e mia kredenciale (një rrëfim me Arta Markun"), botoi "Buzuku", Prishtinë, 2022.

ANAMNEZA E KRIJIMIT...

Nga Jusuf Buxhovi

Në filozofi, anamneza, është koncept i ringjalljes së kujtimive, të lindura para lindjes. Këtë teori e njohim nga dialogët e Platoni te "Menoni". Personazhi me të njëjtin emër, shtron para Sokratit çështjen, që më vonë do të identifikohet si "paradoks sofistik".

Vepra "Letrat e mia kredenciale (një rrëfim me Arta Markun"), një libër i zhanrit intervistues, i pari i tillë në letrat tona, në disa segmente, po qe se i referohet dialogut të Menonit me Sokratin, mund t'i takojë edhe asaj që merret si "paradoks i njohurisë", meqë kur i pari para filozofit të madh shtron pyetjen se si mund të njihet natyra e vullnetit të brendshëm kur, si e tillë, nuk shihet dhe, edhe po qe se ia arrin ta përshkruesh, ajo megjithatë mbetët e panjohur, Sokrati i Platonit, përgjigjet me teorinë e anamnezës.

Natyrisht se ringjallja e kujtimeve, qoftë edhe në formën e përkufizimit platonian, me atë se shpirti është i pavdekshëm meqë në "mbretërinë e ideve", është pajisur me njohuritë e së vërtetës, prej nga ato, nëpërmes procesit të ri-kujtesës rikthehen, në krijimtari reinkarnimi i tyre, pamëdyshje se i atribuohet anamnezës.

Meqë raportet e saj në krijimtari varen nga krijuesi dhe ndërlidhja e tij me shpërfaqjen e "botës së brendshme", gjë që atë e determinon si individualizëm që veprës i jep dimensionin e veçantë, me të cilën mandej lidhet lexuesi në forma të ndryshme intuive dhe përceptive, prej nga autori shkëputet nga vepra, pa kurrëfarë të drejte që ta interpretojë apo shpjegojë. Përkundër kësaj në universin krijues, veçmas atë letrar, përherë mbetet një hapësirë, si të thuhet, "e lirë" për autorin që "të manipulojë" me ide të caktuara, që i takojnë këtij universi. Natyrisht se ato, pa marrë parasysh volumin dhe thellësinë e shtrirjes, doemos se ndërlidhen me atë "paradoksin e njohurisë", pikërisht me atë nga filozofia sokrato-platoniane, që te biseda e Besnik Mustafajt me Arta Markun, shfaqen "si kredenciale" të autorit bashkëbisedueses, me çka fitohet përshtypja se doemos është dashtë të kenë për model dialogun që njohim nga filozofët antikë, jo që biseda të mbindertojë një diskurs mbi çështjet filozofike, të cilat edhe sot e gjithëditën mesin të hapura, por të pasqyrojë atë që A. Apolloni në hyrje e sheh si "marking-of që tregon prapaskenat e krijimit të veprave të autorit të njohur Besnik Mustafaj", prej nga del vlerësimi se "veprat e këtij autori janë lexuar vetëm si rezultate, kurse prej tash ato i shohim edhe si procese".

Vlerësimi i parjes së veprave të Mustafajt "si procese", nga sfondi i përgjithshëm i bisedës me Arta Markun, përkundër njohurive që dalin rreth kohës dhe rrethanave nëpër të cilat ka kaluar autori, nëpër dy binarë thuajse asimetrik shoqëror-politik dhe kulturor të përthyerjeve mdis diktaturës dhe pluralizmit, si të tilla, ato pasqyrojnë brendinë e këtij kapërcimi vertikalisht dhe horizontalisht me një çasje ndër më origjinalet në letërsinë tonë, megjithatë, nxjerr në pah edhe raportet tjera, nga kompleksitetit i njohjes, si dije, kulturë, e mbi të gjitha si pjesë e një kujtese, që shpalon ndjenja të thella shpirtërore që kanë ndikuar pasqyrimin e personazheve si karaktere të ndryshme. Nga këto shpalime, me interes të veçantë janë observimet e ndjenjave (dashuria - urrejtja, jeta

– vdekja) si pikëpamje mbi të cilat ndërtohet individualiteti si dhe ato të raporteve të krijuesit me politikën, me shoqërinë, prej nga fitohet përshtypja për një krijues i cili, në të gjitha fazat, madje edhe ato të hershmet të jetës në dikaturë me diktatet e njohura soc-realiste, ka pasë parasysh krijimin si një akt të lirisë, fillimisht të brendshme, pra atë të ëdërruar, që nuk është e thënë që si gjendje të ndryshojë edhe në rrethanat e lirisë "së jashtme", meqë ajo mbetët përherë e pakryer. Ky dimension më së miri paqitet në pyetjen rreth "lirisë së ëndërruar" dhe "lirisë së zhgjëndrrës", me ç'rast Mustafaj thotë se: "Liria në zhgjëndërr është, në njëfarë mënyre, një ëndërr e re: po aq e mrekullueshme, e pakëmbyeshme me asgjë tjetër. Por në këtë e re shfaqen, megjithatë, pafuqitë e lirisë, që nuk ishin në ëndrrën e parë. Që do të thotë se bashkë me mrekullimin, në këtë ëdërr të re unë kam gjithë kohën ca ankthe e ca dëshpërime, që nuk i kisha në ëndrrën e parë, atëherë kur kjo ëndërr i përkiste botës së parealizueshme, pra, ishte një ëndërr që më pëlqente, por nuk më ngjallte ndonjë shpresë..." Bashkëbiseduesi, me këtë rast shkrimtari Mustafaj, ankthin e "lirisë së zhgjëndrrës" e shpjegon me atë se zbulimi i saj (i lirisë) ka të bëjë me atë se ajo " nuk është dhe nuk mund të jetë e përsosur", vlerësim ky që lidhet me konceptin e një shkrimtari të madh gjerman (Gëte) i cili, lirie e definon si "të pakryer dhe asnjëherë të përhershme", ngaqë varet nga raportet e njeriut me të... Nga ky këndvështrim shfaqet edhe "dëshpërimi" ngaqë në zhgjëndërr "liria jetohet si një realitet konkret", aspekt ky që autorin e shtynë që ta përjetojë si "një ëndërr të dytë". Në këtë "ëndërr të dytë", ato mbesin të paprekura, diçka që ndjellin ankth dhe dëshpërim. Për ç'gjë Mustafaj sikur nxjerr "arsyetimin" me atë që thotë "se jeta pa to nuk do të ishte jetë... Do të ishte diçka tjetër..."

Këto dhe dilema të ngjashme, shumë herë të ngritura deri tek përmasat e çështjeve filozofike, bashkëbisedimin e Mustafajt me Ana Markun, krahas pasqyrimit të raporteve të shkrimtarit me veprën nga brenda, e radhisin ndër veprat e para të llojit të tillë, ku anamneza, nxjerr në pah përmasat e panjohura të botës së krijuesit nga thellësitë, që si të tilla, diskursit krijues i japin dimensionin e reinkarnimit imagjinativ të shpirtërores, asaj platonianës, që edhe më tutje ndikon edhe pavetëdijshëm vetëdijen tonë... Dorëzimi i kredencialeve, qoftë edhe i pjesërishëm, tumir këtë fatum të krijuesit...

Një vështrim i shkurtër mbi romanin"Puthja e Amazonës" të Mira Meksit.

HIMN I DASHURISË PËR JETËN

Nga Artur Spanjolli

Dy paralelë jete, dy ngjarje, i njëjti përfundim. E para, e lidhur me jetën bashkëkohore, me dramat shëndetsore të kohës tonë, me sfidat pandemike dhe me shpresën e madhe tek shkenca. Ndërsa linja tjetër, e zhytur thellë në kohë. Mijëra vjet më parë, kur hyjnitë ishin pjesë e mitologjisë, kur gruaja përleshej me to dhe elementët magjikë ndërthureshin kudo me jetën e përditshme.

Linja bashkëkohore mbetet një çast pezull, ngjarja futet në tisin e largët të kohës, duke i dhënë rrëfimit ngjyrim, frymëmarrje, thellësi filozofike, deri edhe duke i falur një dimension magjik, të cilin e gjenim aq natyrshëm tek letërsia e e vjetër greke. Letërsi me heronj legjendarë, të cilët pëmbushnin bëma legjendare. Mira Meksi, nuk heq dorë nga simbolika, shkon përtej përshkrimeve të jetës së përditshme. Ajo kërkon alternativa, kërkon ti japë thellësi, peshë filozofike ngjarjes së saj. Kërkon të përcjellë, (dhe e arrin atë) një mesazh të thellë, të rëndësishëm dhe thelbësisht njerëzor me librin e saj të fundit.

Jemi krejtësisht në botën shpirtërore të gruas. Jemi te destini i saj i paracaktuar- sakrifica.Të dyja gratë e romanit janë heroina, luftëtare të paepura. Njëra, Teuta e kohës tonë, do të përballet me një gjymtim të dhimbshëm për hir të vazhdimësisë së jetës. E dyta, luftëtarja amazonë, do të përballet edhe ajo me një gjymtim të pashmangshëm fizik, për të përmbushur një rit ancestral, trashëguar nga komuniteti i saj femëror, i cili do ta ngrejë në rangun e prijëses së amazonave.

...Po më kërkon të tradhtoj fisin tim? Të jem shkatërrimi i amazonave? Kush do ta përdorë Harkun e Pathyeshmërisë?"

Koha e heroinave të romanit të Meksit i ndan ato me mijëra vjet, por megjithatë, në rrjedhën e saj të pandalshme, gjendet një pikëpuqje kohore: e tashmja dhe e shkuara e tejlargët priten në një pikë. Të dyja gratë i japin, i transmetojnë njëra-tjetrës forcën e gjakut të tyre të pandërprerë për të arritur triumfin e jetës mbi vdekjen.

Ideja, ose më mirë, riti i sakrifikimit të trupit, është i lashtë sa vetë njerëzimi. Çdo epokë ka në themelet e saj therroritë e veta. Vetë Krishti u sakrifikua për të tjerët. Me qindra piramida, varre mbretërish, themele fortesash, vdekje sovranësh, si përbindësha të padukshëm, kanë kërkuar pa fund, veç gjak dhe sakrifica te tejskajshme.

Në romanin e Mira Meksit, sakrifica ndihet gjithkund. Ajo perceptohet tek dhunimi, gjymtimi i trupit të protagonistes. Gjymtim, i cili ndodh për hir të vazhdimësisë së jetës. Gjymtimi i Amazonës, e cila sfidon dashurinë dhe hyjnitë për të përmbushur detyrimin e saj si prijëse.

Në libër triumfon jeta. Ngjarja është një himn që autorja i thur dashurisë për jetën. E cila jo rrallë, na vë përballë provash të skajshme. Dhunimi fizik përballë estetikës dhe kënaqësisë trupore, apo triumfi mbi vdekjen? Autorja nuk ndjek vetëm linjën e kurajos së Teutës. Ajo e braktis linjën bashkëkohore dhe i jep ngjarjes një dimension fantastik, mitik, magjik nëpërmjet rrugëtimit nëpër mugujt e largët të kohës, në botë të harruara ku të vetmet lidhka me botën e sotme janë disa shenja apo objekte: tatuazhe, varëse, harqe... Ky rrugëtim në kohë i jep rrëfimit një tjetër frymëmarrje, gjërësi, thellësi filozofike. Edhe Teuta, si një amazonë bashkëkohore i duhet të luftojë me përbindëshat e saj në emër të jetës. Për të mbijetuar asaj i duhet të gjymtojë feminilitetin e saj. Jeta po kërkon t'i ngulë thikën prapa shpine.

Të dyja gratë, si Teuta e përhumbur në një Paris surreal të molepsur prej pandemisë, si Glaukia, amazonë e pamposhtur në një kontekst mitologjik, edhe pse paralelet janë aq të largëta në kohë, në thelb janë motërzime të pandashme. Ato kanë të njëjtin ideal. Vuajnë nga e njëjta e keqe: luftojnë të mbijetojnë.

Njëra, e braktisur nga i dashuri në çastin më kritik, përpiqet të triumfojë mbi vdekjen. Tjetra, e mbërthyer në kurthin vdekjeprurës të një dashurie të yshtur nga Zotat, vret dashurinë-pengesë për triumfin e misionit të saj, sfidon perënditë për të manovruar Harkun e prijëses. Një energji e pashtershme, karakteristikë e gjinisë femërore, buron nga shpirtërat e dy heroinave. Mbizotërimi i Harkut të Pathyeshëm të prijëses, është vetë simboli i kurajos. Pamposhtja dhe forca shpirtërore e personazheve. Objekti pra, sendi, kthehet në simbolikë. Ashtu siç kthehet në simbolikë edhe gërma e parë e alfabetit hebraik "Alef", si Hyrje në Kozmos, porta e parë e njohurisë Universale. Ajo është një gërmë me përndritje krejt hyjnore. Po ashtu edhe varsja kamè me kumtet e saj pellazge ka një simbolikë dhe një funksjon të përcaktuar në roman. Janë këto pra, objekte që shndërrohet në nyje lidhëse mes dy botëve aq të largëta. Asgjë nuk mund ta mposhtë dëshirën e zjarrtë të njeriut për të jetuar. Ky është një nga mesazhet e librit.

Romani ka vlera të padiskutueshme gjuhësore. Shqipja e mrekullueshme e autores, tregon se me sa dashuri dhe kujdesje Mira Meksi i përkushtohet gjuhës amtare, duke përzgjedhur leksikun dhe duke ripropozuar fjalë të vjetra. Për t'u vlerësuar gjithashtu është edhe përpjekja e saj e arrirë për të na dhënë një tërthore jete të zhytur në mitet dhe legjendat antike. Të na flasë pra, për një botë të largët dhe të humbur. Atë të amazonave. Një botë e "rrezikshme", plot kurthe për një shkrimtar. Botë, e cila kërkon jo vetëm njohje të thellë, erudicion të lartë, por edhe një intuitë të sprovuar dhe një përkujdesje mjeshtërore për ta krijuar. Mund të të shkruhen lehtësisht kujtime, apo mbresa nga jeta e njeriut. Sprovë e madhe është të rindërtohet besueshëm për lexuesin bota antike! Ndoshta në këtë sprovë matet vlera e një krijuesi.

Një roman aspak i lehtë për t'u ndjekur, "Puthja e amazonës" është një tjetër puzzle në mozaikun e librave që autorja e "Diktatorit në kryq" dhe e "Kutia e Agatha Christie-t" vazhdon të krijojë pa ndërprerje.

QAZIM SHEHU

Dy tregime

LIBRI I RI

Sapo e kisha botuar librin tim me tregime dhe po e kundroja me kujdes kopertinën, lidhjen, paraqitjen e tij estetike.Libri është si fëmija, thonë, por unë do të shtoja se , kur vjen një libër, ai lind i rritur dhe nuk ka më mundësi të provojë veten, nuk do kujdes, sepse kujdesi ndaj tij i përket punës paraprake.

E mora librin tim dhe e dërgova në një librari.Para më doli një vajzë e bukur, me një pamje disi të ndrojtur, por ndërsa komunikoja me të për mundësinë që ta reklamonte diku, ajo ma ktheu se nuk para ecte letërsia shqipe, veçmas librat me poezi, fare.Kishte kthyer mbrapsht sa e sa autorë dhe i vinte keq për këtë, por ishte e detyruar.

Nuk bëra zë, nuk doja ta zgjasja më këtë , vetëm tunda kokën dhe dola i heshtur. Në trotuarin përballë librarisë, sytë me kapën një radhë librash shtrirë përtokë. Emra të mëdhenj:Dostojevski, Tolstoi, Balzaku, Kafka, Xhojsi, Man, Heminguej. Libra filozofikë, histori, monografi, rrinin shtrirë përtokë dhe kalimtarët kalonin pa ua hedhur sytë.

Disa tituj më tregonin se i kisha lexuar, por seç kisha një tërheqje drejt tyre, pasi botimet ishin të reja dhe më ngjante sikur nuk i kisha lexuar.Ai që shiste ishte një i njohur , por u shmanga, bëra sikur nuk e pashë, sepse disa herë më kishte rekomanduar libra të mirë dhe unë i kisha blerë.Ai e dinte që blija libra dhe në disa raste isha zënë ngushtë, se s`më ndodheshin paratë e mjaftueshme.

Bëra tutje dhe po mendoja:Në Tiranë ka lokale luksoze, po nuk ka librari luksoze, ka dyqane mode, markete me hapësira të bollshme, por nuk gjendet që nuk gjendet një librari e përmasave të mëdha.Sikur të ishte një e tillë, ku autorët të çonin librat dhe njerëzit të shkonin, të lexonin, të blinin, të kontaktonin me autorët, të kishte lektorë të përgatitur dhe seriozë, sa mirë do qe!

I lodhur siç isha, hyra në një klub për të pirë diçka.Ndërsa kamarierja po vonohej, nxora librin tim të ri dhe po i gëzohesha. Mendoja se nuk ishte i keq.Por atij i rri përsipër një kopertinë e dyfishtë, mosnjohja dhe indiferenca.Edhe nëse e lexonte dikush, do të më lavdëronte për ato gjëra që edhe nuk duhen cekur, sepse çdo libër ka gjëra që nuk ritmojnë, këto i kupton autori, pas dy –tri vitesh , pasi ftohet pakëz.

E mora gotën e rakisë, më duhej një gotë sa për një tonus ngazëllyes, kur dëgjova një zë:

-Ej shkrimtar, ç`na ke shkruar?

Ngrita vështrimin nga libri dhe sytë më parë prokurorin EL, i ulur me dy shokë të tjerë, mbase gjykatës apo avokatë.Nuk kishte rëndësi.Dikur ai s`ka qenë prokuror, por shoku im, por, mbasi mbaroi kursin gjashtëmujor të Plepave, e ndoqi mirë karrierën gjyqësore dhe u bë një emër i dëgjuar i jurispudencës, i shqiptuar për çështje të prekshme edhe nga media.

-Një libër me tregime, -thashë.

-Mund ta shoh?

U ngrita dhe ia dhashë librin.Ai e mori dhe çoç foli me shokët.Filloi ta shfletonte, tundi kokën.Kur u ktheva në tavolinën time, vura re një broke verë dhe një pjatë me dy bërxolla.

-I ke nga prokurori, -tha kamarierja.

Nuk bëra zë, as falenderova.Po shihja drejt tij.Pasi e shfletoi një copë here, ai ia dha librin njërit nga shokët që rrinte me të, siç dukej, vartës i tij, i cili ma solli në tavolinë.

-Megjithë qejf do ta blija, -tha, -por nuk lexoj letërsi shqiptare, lexoj letërsi të huaj, franceze, angleze, amerikane…

Mua sikur më ra tavani mbi kokë.Ky kokoroç, që s`e di se çfarë ka qenë, ende fliska si për pasnesër.Mendo sesi mund të formulojë ky idiot akuzat, si mund të japë pretencat, dhe aty për aty, falë intuitës sime të thekshme, ia ktheva:

-Ti ke të drejtë, -thashë, -shkrimtarët shqiptarë vuajnë nga mungesa e leximit…

-Atëherë përse shkruani?…

-Këmbëngulim , për shkak të mungesës së leximit dhe besojmë se një ditë do të lexohemi…

-Aha!-ia bëri ai me ironi dhe një shpërfillje, që u ndie nga intonimi…

-Por, -vijova, -përpara se të përzëmë shkrimtarët shqiptarë nga ky vend, në fillim duhet të përzëmë prokurorët, gjyqtarët dhe avoketërit shqiptarë;nuk do të ishte keq, -vijonte ironia ime sipas logjikës së tij- t`i zëvëndësonim me prokurorë italianë, belgë, francezë, anlezë.Jeta do të bëhej më e bukur pa prokurorët shqiptarë, sesa pa shkrimtarët shqiptarë.Sepse, sado të dobët të jenë shkrimtarët shqiptarë, ata mundohen të ngrënë në këmbë të mirën , të bukurën, të cilën, siç është parë, ju e keni përdhosur…

U ngrita dhe dola pa ia prekur porosinë…

NGJYRA

Fytyra ime e zeshkët është nganjëherë bezdia ime.Herë-herë vështrohem në pasyrë dhe më kap një brengë e madhe:Vëllezërit e mi janë të bardhë, motrat po ashtu.Po unë nga dola kaq i zi?

Dikur nëna më thoshte se i ishterur qumështi i gjirit dhe më kishte mëndur jevga e fshatit, e cila, edhe ajo , disa djem të saj i kishte të bardhë .

"Ti atë e ke si nënë", më thoshte mamaja dhe qeshte.

Fytyra ime është e rregullt, me tipare të theksuara, balli i gjerë dhe sytë kanë ngjyrën e gështenjës.Thonë se jam i bukur, ndërsa edhe unë kam një vlerësim që nuk zbret në indiferencë për hijeshinë time.Nganjëherë nuk e vras mendjen për ngjyrën, fundja a nuk më njohin që jam i racës së bardhë?Por, në vetmi , rri e mendoj sërish dhe një trishtim i lehtë më kaplon e s`di sesi ajo ngjyrë zeshkane e theksuar, edhe sikur të përdor sapun magjik, nuk do më ikë…

Punoj në një ndërmarrje të madhe dhe aty është edhe një rom.Ai nuk ka dëshirë të shoqërohet me njeri tjetër, veçse me mua.Askush nuk ma mbush mendjen se ai nuk ndjen diçka instiktive.Po çfarë ndjen vallë, mos jam i racës së tij dhe për këtë më afrohet?Unë i shmangem me kujdes. Është djalë shumë punëtor, shpatullgjerë, i edukuar , fjalëpak dhe korrekt.Të gjithë e nderojnë, por i qëndroj ca ftohtë, pikërisht sepse ai kërkon të rrijë me mua, të pimë ndonjë gotë bashkë, të bëjmë ndonjë shëtitje.Duket do të më thotë diçka, po se çfarë nuk mund ta marr me mend.Sa bëhem gati gjej një shkak për t`u larguar, sajoj diçka dhe për këtë ka filluar të më vijë zor, por herë –herë pendohem e kthehem mbrapsht po ndërkohë ai ka ikur në punën e tij.

Atëherë futem diku dhe pi raki.Kjo më lehtëson.Një buzëmbrëmje, teksa po rrija në një lokal ku kishte mezeri, erdhi një orkestër romësh me klarinetë, dajre, fizarmonikë. Ata u afruan së pari te tavolina ku rrija, në respektin tim.Më quajtën të afërt.Të tjerët më shikonin.Nga halli apo zori, nxora një shuk parash dhe ua hodha mbi dajre.Më falenderuan dhe ikën.Muzika e tyre me tinguj të ngrohtë m`u duk si një jehonë që zvarriste brengën time.Ndërsa shkoj nëpër dyqane ku ka radhë, njerëzit më bëjnë vend me respekt dhe sesi më shohin, a nuk jam një nga ata?E di që ekziston një keqardhje për romët, një si farë ndjenje dobësie , për shkakun se ata janë pakicë, por unë nuk jam rom, unë jam një njeri si gjithë të tjerët, veçse lëkura ime zeshkane, tepër zeshkane, sikur më afron me ta.

Ka disa ditë që djalin nuk e kam parë. Ndjej nevojë ta takoj.Nuk e di pse kjo dëshirë bëhet e ngutshme.Kam filluar të kuptoj se ai nuk do të afrohet me mua, pse ngjaj si rom ose beson se unë jam rom, por për diçka tjetër.Ç`të më dojë vallë?E di që është i zoti, punon shumë, njeri që shkon me të tjerët, i afrueshëm, ndihmues dhe dashamirës.E di që edhe të tjerët e duan…Atëherë ç`të më dojë, çfarë duhet të mendojë?

Ndërsa vërtisja këto mendime, një ditë m`u afrua dhe më foli. Fjalë të zakonshme.

-Ore Dashamir(kështu e quajnë), -i thashë, -si i ke punët, -kam vënë re se shumë herë kërkon të më thuash diçka…

-E kam një hall!-tha ai dhe uli kokën.

-Nëse unë dua ta di, ma rrëfe, nëse të ndihmoj, nuk përtoj ta jap ndihmën time…

Dashamiri u skuq;është e bukur skuqja e një romi. Ngjyra zeshkane merr nuanca të kuqërremta. Duket si një muzg rishtar, kur nuk kanë ikur ende rrezet e fundit të diellit…

-Po ja, unë dua një vajzë edhe ajo është rome…

-Po mirë, të trashëgoheni!

-Sa lehtë duket, por nuk duan prindërit e saj që ne të bashkohemi…

-Përderisa ju duheni, prindërit do të pranojnë një ditë…

-Në të vërtetë ata duan, por me një kusht: nuk mund ta japin fjalën nëse unë nuk u çoj prindërit atje, dajat, xhaxhanë, ndërsa unë nuk kam prindër, as daja, as xhaxha.Nuk e di i kujt jam.Jam fillikat në këtë botë.A bëhesh ti daja im vetëm për një natë?E di që është e vështirë për ty, se ti je i bardhë, por…

Mbeta si i shtangur. Ai djalë ishte në hall, vuante nga brenga të shumëfishta, njëra brengë, që ishte njeri pa njeri në këtë botë sikur ishte fashitur, ndërsa brenga më e madhe, me sa kuptova, ishte ajo e dashurisë dhe e pengesave të bashkimit me atë vajzë.

-Po si jo! - thashë pa u menduar.

Pashë sesi fytyra e tij u çel menjëherë, sytë i morën një dritë tjetër, dhëmbët e bardhë rrezëllinë dhe ngjyra e lëkurës së tij mori një shkëlqim drithërues..

Ndërsa po shihja këtë përtëritje të tij dhe ndërsa ajo më mbeti në mendje për një kohë të gjatë, mendova se kisha bërë mirë dhe nuk u pendova.Thirra Asimin, një shokun tim, i cili edhe ai ishte zeshkan, jo si unë, dhe të dy u nisëm për te prindërit e vajzës.

Dashamiri na vinte pas.Ata ishin njerëz të mirë. Asimi u prezantua si xhaxhai, ndërsa unë si daja i Dashamirit. Na pritën me respekt të madh, na sajdisën si mbretër dhe dhanë fjalën.

Teksa mendoj se çfarë kam vuajtur unë kur u fejova me gruan që kam sot, (që atëhere ishte një vajzë bionde, sylarushe e shtatmënjollë), dhe prindërit e saj s`donin të ma jepnin, se vërtet isha katundar si ata, por nuk mund të shkonte një vajzë e bardhë me një djalë që e kishte fytyrën si fundi i tiganit, ndjej një gëzim të madh sot që bashkova dy njerëz.Dhe s`më shkon mendja më nëse jam rom a s`jam.Ngjyrat nuk ekzistojnë, ato janë ndjesia që kemi ne për to…

ia merrte lekët, ai, madje, u ngrit vetë dhe ia mbushi duart fëmijës me çokollata, biskota dhe karamele.

- Ç'më bëre!, - tha Marsi, - prit kur të vijnë edhe fëmijët e tjerë këtu, dhe ajo u rifut brenda banakut duke rregulluar disa mallra që kishin rënë përtokë.

Arseni u riul pranë tavolinës, kur erdhi dopio e tretë. Ai e piu atë me ngut. Kishte dëshirë të pinte atë ditë. Ishte rindezur nga pija dhe dashuria. Gjithnjë e më shumë buzëqeshja e bardhë- torturuese, që ndriste në fytyrën lulëkuq të ish-të dashurës po e sëkëlldiste.

Në dopion e pestë a të gjashtë ai nuk po mendonte më, por veç i tha Marsit se dëshironte të paguante: nxori portofolin e fryrë dhe pagoi .

- Janë shumë, - tha ajo.

-Jo, - tha ai, - janë pak. - Ti je gjithçka për mua!

Ishte pasdite e vonë, kur gruaja bukuroshe i tha atij se mund të dilnin jashtë, në tavolinën e oborrit së lokalit. Dielli, me kohë e kishte fshehur syrin në malin përballë, hijet e pemëve dhe të drurëve ishin njëtrajtësuar , duke u theksuar e humbur në trashjen e muzgut. Kur ai zgjati dorën drejt saj , ndjeu se ishte i pafuqishëm . Në ajrin e pastër, u lehtësua disi, por pas pak mendja iu turbullua aq shumë, sa u ul në karrige si i lëshuar.

Derdhi gotën e rakisë mbi pjatë dhe në atë çast mbështeti kokën mbi tavolinë sipër bërrylave. E zonja e lokalit s'dinte ç'të bënte. Vonë, kur erdhi burri, i tha se atë ditë ia kishte kaluar mirë, ishte lodhur ca, por sidoqoftë puna s'kishte ecur keq.

Ndërsa mbyllnin të dy derën e lokalit, duke futur brenda karriget , befas ai pa në tavolinë një njeri që gërhiste.

- Po ky?! - pyeti.

-Është një dehur, - i tha ajo qymyrxhiut, - ka pirë shumë.

- Ç'të bëjmë me të?

- Asgjë... , do t'i dalë rakia dhe do ikë vetë.

Rreth vëllimit me lirika "Nga ç'qiell ra trëndafili?" të S.Mezurajt

PËR SHKAK TË DASHURISË DHE VETËM ASAJ

Nga Alisa Velaj

Lirikën e dashurisë duket se çdo poet e shkruan nga e para. Ka poetë që e kanë pjesë të krijimtarisë së tyre, ka të tjerë syresh që lërojnë vargje vetëm në arat e saj. Ka poetë që shkruajnë prej rinisë së hershme. Ka të tjerë që poezinë e mbartin në shpirt, si dromca drite të një kohe të shuar, si jehonë kujtimesh rinie, ngjizur me mbresa nga momentet jetësore, leximet, ëndrrat, dëshirat. Sadedin Mezuraj zgjodhi t'i jepte lexuesit këtë përmbledhje lirikash vetëm tani në vitin 2022. Po të gjithë e dimë se në lëmin e poezisë, rëndësi ka produkti letrar dhe jo koha e botimit. A nuk janë krejt të zakonshme rastet kur poetët nuk botojnë kurrë poezi gjatë jetës së tyre tokësore? Vëllimi me lirika "Nga ç'qiell ra trëndafili?" e ngjiz dashurinë si ajri te njeriu dhe ajrinë si hapësirë kohe ku gjësendi dhe asgjëja shndërrohet në çdo gjë, dhe gjithçka vetëm e vetëm falë dashurisë. Nëpër honet e heshtjes kumbon e para dhe e fundit dashuria, ndërsa mes intervalesh enden plot farfuri metaforash e dashura dhe mendimi për të. Bota mbushet me imazhet e stinës së dashurisë dhe frymëmarrja e unit lirik ulet e ngrihet me ritmin e dallgëve kur furtuna vjen papritur. Pastaj? Pastaj furtuna fashitet, por fryma e dashurisë endet nëpër qiell, për të rënë pastaj si mister në shpirtin e njerëzve.

"Nga erdhe?
Nga ç'sfera misteri shigjeta u lëshua?
Bukuri fatale
parajsë e stolisur me lulet e ferrit." (Si erdhe?)

Prej asaj fryme, sa të shenjtë aq edhe tokësore, buisin të tjera këngë e serenata për atë, shkakun e lumturisë dhe dëshpërimit: dashurinë dritë-zjarr, dashurinë e gjallë, dashurinë e marrë.

Libri është ndërtuar përmes pesë cikleve poetike: *Në fillim ishin sytë, Pjalme prilli, Në karuselin e stinëve, Gjethe në erë* dhe *Motive me muzg*. Ciklet janë strukturuar si variacione rreth një teme të caktuar dhe si në çdo cikël të jetës, dashuria frymon me praninë e saj të dielltë. Qysh në titullin e librit, autori formëson konceptin e natyrës së dashurisë si pasion dhe frymë, me një përmasë mistike si shkak i metafizikës qiellore. Trëndafili, si shenjues i pasionit dashuror, mbart simbolikën e dashurisë si burim kënaqësie, lumturie, vuajtje dhe plagosje shpirtërore. Trëndafili ka petalet që shenjojnë bukurinë e dashurisë dhe gjembat, simbol i dhimbjes dhe trandjeve shpirtërore të shkaktuara nga dashuria:

"Ajme!
Në këtë stinë të re të pjalmimit të luleve,
sërish më plagosi shigjet' e Kupidit.
Nga plagët e zemrës
gjak i purpurt trëndafilash
pikon." (Tundim)

Në ciklin e parë *Në fillim ishin sytë*, Mezuraj e gjen shkakësinë e zanafillës së jetës në tokë tek sytë e përndezur nga drita e dashurisë. Madje sytë janë fillesa e kësaj të fundit. Ndryshe nga narrativa biblike, ku sipas së cilës në fillim ishte Fjala, për poetin, në fillim ishin sytë. Cilado ndodhi në tokën e dashurisë, bymehet dhe mpaket vetëm falë dritës që uni lirik merr nga vështrimi i syve të saj. Shenjuesi i *syve* është boshti që ngjiz tri ciklet e para dhe rishfaqet, ndonëse jo me të njëjtën denduri edhe në dy ciklet e fundit. Janë *sytë e drenushës, sytë me dritë misteri, sytë me epsh brendashkruar*, sytë demoniakë që plagosin, sytë tundues etj. Pra sytë e dashurisë që përndjekin poetin në karuselin e stinëve të jetës, në stinën e pjalmimit, në vjeshtën e rënies së gjetheve. Sytë si metaforë e përkohshmërisë, prej fillimit të jetës dhe deri në muzgun e saj, kur poeti i drejtohet herë të dashurës, herë fantazmës së saj.

Cikli *Pjalme prilli* sjell një tjetër dritë dashurie, të dëlirë, të ëndërrt, të kthjelltë, e cila vendos një rend të ri në kohën e poetit. Pranverës, verës, vjeshtës dhe dimrit, u është shtuar një stinë e pestë: stina e dashurisë qiellore. Është drita brenda dashurisë që e ka krijuar dalëngadalë këtë kohën tjetër, stinën e pangjashme të shpirtit të mikluar. Megjithatë, sado të tejmbushur me dashuri, sado të përndritur nga sytë e saj, ne qeniet tokësore e kemi të pamundur ta shuajmë përfare ankthin që na tundon përballë kohës që ikën e nuk kthehet më. Koha është përherë e pamjaftueshme për shuarjen e urisë për dashuri, prandaj nëse njeriu synon ta bëjë botën një vend më të mirë, është dashuria si vetëpërmbushje e ekzistencës, është fryma e saj, ajo që e shtyn qenien në këtë rrugëtim drejt tokës së premtuar. Ankthin ekzistencial përballë rrjedhës marramendëse të çasteve ikanake, poeti e shmang sa mundet, por jo përherë kjo shmangie është e vetmja mundësi. Mezuraj e ndjen vjeshtën deri në palcë, e kundron gjakun e gjetheve si vazhdim të gjakut të tij. Prandaj dhe nuk mundet t'i ikë ankthit me aq lehtësi. Po të mërgojë nga mëngjesi në mbrëmje, prej tokës në qiell, prej stinës në stinë, a nuk është prapë koha që e përndjek nëpër ikje? A nuk janë prapë çastet e pakthyeshme në rendjen e njeriut drejt lumturisë apo meditimit? A nuk është vallë meditimi një tjetër kohë e ikur? Poezitë "Memento Mori" dhe "Gjethe në erë" i përshkruajnë këto sensacione me një meditim të vrenjtur në retrospektivën e përjetimit, por me një gëzim shumë fëminor për kohën kur drita e dashurisë e ka mahnitur poetin në atë shkallë sa, jo vetëm se vdekjen nuk e ka menduar, por i është dukur se me dashurinë dhe ngazëllimin e dritës së saj, ka rrokur dhe përjetësinë:

"Momento mori, vajtonin lulet
në fundin e stinës që shkonte me nxitim.
Por ne të ngazëllyer nga hovet rinore,
jetën e mendonim një festë të pafundme
dhe veten të pavdekshëm e mendonim
si perëndi." (Gjethe në erë)

Poeti ka origjinalitetin e tij, po aq sa edhe frymën e arritjeve më të mira të lirikës shqipe dhe botërore. Ndjehet kozmogonia e lirikës lasgushiane, flladitja e tallazet e detit të Arapit, sensualiteti kremtues i dashurisë nga Neruda, trishtimi rreshpjan i mungesës se dashurisë, erosi i flakëruar i Ricosit, tragjiciteti dhe fryma e pasionit të Lorkës. Por të gjitha këto vijnë të shkrira në një simbiozë të tillë, ku kufiri mes frymës së tjetrit dhe mushkërive të tua komandohen nga përjetimet e një shpirti poetik të përveçëm: unit lirik të Mezurajt. Në poezinë "Prani dhe mungesë" poeti e përshkruan plotninë dhe paplotninë e shpirtit të dashuruar me vargjet: "Praninë e kishe përherë të mangët/ ndërsa mungesën kaq të plotë". Uni lirik ka uri për dashurinë. Ndihet përherë e më i paplotë, jo në kuptimin e zbrazëtisë, por në kuptimin e një pranie që e gjeneron veten përmes dëshirës për ta pasur sa më pranë dhe sa më shumë në thellësi të zemrës të dashurën. Dashuria pra, nuk është asnjëherë tepër. Ajo dëshirohet përherë e më tepër, sa më në palcë të pasionit të jenë qelizat e saj. Në lirikën e Mezurajt, njeriu ngopet me dashuri, po aq sa ngopet me ajër. Uni lirik i pangopur me dashuri, na shfaqet po aq i pangopur edhe me dimensionet kohore në të cilat frymon kjo dashuri. Ky un është i pangopur me vjeshtë, i pangopur me jetë, i pangopur me kaltërsi, i pangopur me dhimbje dhe me trishtim. Lumturia dhe trishtimi e gjejnë shprehinë e tyre në metafora të tilla të mrekullueshme si: *më merr atje ku Fjala bëhet dritë, fantazmat lule kërkojnë në varreza, prilli i dehur me pjalmin e luleve, kjo dashuri-kurorë lulesh të rritura në dhimbje, flokët e tua ujëvarë hënore, flautet e erës luajnë fugat e vdekjes, zogjtë më rrëfyen sekretin e fluturimit në qiej lirie* etj., apo paralelizma figurative mbresëlënëse, si: "U shuan zjarret e vjeshtës në pyje/ po fiken dhe flakët e një dashurie...". Në përgjithësi lirika e dashurisë i merr krahasimet e saj nga natyra, dhe të arrish të përputhësh natyrën e gjallë me natyrën e shpirtit të dashuruar duhet të jesh një lirik i buruar. Poeti ynë e arrin krejt natyrshëm këtë lloj procedimi poetik. Uni lirik luhatet mes dy ndjenjash skajshmërisht të kundërta: dashurisë pasionante, të qielltë, të dielltë e plot dallgë lumturie dhe pikëllimit të thellë si nata e mungesa. Dashuria shpërfaqet me të gjitha dimensionet dhe përjetimet si mall, mungesë, largësi, prani e papranishme, humbje, harresë. Në rastin e dytë të duket se koha ngrin, kraharorët e të dashuruarve e ndalin frymëmarrjen dhe elegjia në vend që të fillojë vajin, shkund zemrën e poetit më të tillë forcë, sa ky i fundit në vend të vajtojë mungesën, nis e shpik një tjetër prani surreale të së dashurës së munguar.

Alain Badiou, në librin "Lavd dashurisë", ndërsa mediton rreth vargut *Dashuria duhet rishpikur* të Artur Rembosë, thekson se dashuria është në thelb rishpikje e jetës. Në këtë kuptim, çdo poet, përmes frymës dhe fjalës poetike, rishpik dashurinë edhe kur ajo mungon. Kështu, mungesa e dashurisë nuk mund të mbushet veçse me një fantazmë dashurie të thirrur enkas nga shkretëtirat e shpirtit. Një fantazmë që me patjetër duhet trupëzuar, që shpirti të nisë të marrë rishtas veten pas përhitjes. Sepse, për shkak të dashurisë jetojmë dhe vetëm prej saj i rilindim shpirtrat tanë. Është dashuria që e tremb për vdekje hijen e vdekjes, sapo nis avitet dhe asnjëherë e kundërta. Dashuria, thotë Mezuraj, është "melhemi për jetën shafran", është ngushëllimi përballë ankthit ekzistencial të kohës që shkon pa kthim. Madje për poetin, dashuria është formula e kundërvdekjes:

"Mos na prit Karont!
Atje mbi brigjet e lumit Lethe
as sonte, as nesër
as deri në natën e fundit të ditëve
me vdekje të vogla,
Vdekjen do ta mbajmë
larg territoreve të jetës."
(Kjo natë hyjnore)

Ky shpirt i shpikur nga të lashtët dhe i përndritur nga dashuria e poetëve të çdo kohe, është misteri që e bën lirikën e dashurisë një melodi të krijuar përherë nga e para. Ngase për secilin këngëtar bien trëndafila të ndryshëm nga qiejt e dashurisë.

LUNDËRTAR I VONUAR

Cikël poetik
nga Sadedin Mezuraj



Lundërtar i vonuar

Unë vija nga detet e largëta të natës,
lundërtar i vonuar
i mbetur pa shokë.
Këngët e tua m'i sillte era.
Erdha mes mjegullës në pragun e agut,
në ishullin tënd me trëndafila gjaku.

Pi në burimet e tua mistike
dhe etja ime,
flakë që nuk shuhet.
Kuaj qimekuq,
shkrofëtijnë në shkretëtirat e oazeve të tua.

Futem në syrin tënd të perënduar,
dhe pafundësia hapet,
si humnerë e errët drite.

Bëj të iki prej teje dhe dot nuk iki.
Në rrjetën e flokëve të tua kam ngecur,
pas trupit tim mpleksur si kulpër.

Nëse një ditë
ke për të më vrarë
(se dashurinë sirenë, ti e ke sadiste)
më vrit butësisht me këngët e tua.
Shpirtin ma kurse,
trupin ma mbulo me trëndafila gjaku
në një varr të errët
në syrin tënd të bukur.

Sytë e drenushës

Njeriu i malit veshur me të zeza
kërkon nëpër pyll kafshën e humbur
Pas gjetheve të kuqe të dushkut në një shteg,
një çast u dukën sytë e drenushës

Vezullim pasqyrash me dritë të errët.
U shtang i ngjethur
si prej syve të zanave.

Vërshojnë hijet dhe muzgu zbret nga malet.
Mbi fushën e shkretë
Flautet e erës
përcjellin
lutjet e ditës që shuhet.

Njeriu me të zeza kthehet në kullë.
Natën në ëndrra i shfaqet drenusha,
me dritë hënore në sytë e pikëlluar.

Tundim

Ajme!
Në këtë stinë të re të pjalmimit të luleve,
sërish më plagosi shigjet' e Kupidit.
Nga plagët e zemrës
gjak i purpurt trëndafilash
pikon.

E ndjej si rrëzohet e thërrmohet
arkitektura e ditëve të bukura me ty.
Koha e hareshme
kur si peshk përpëlitesha
në rrjetën e fjalëve të tua të rrejshme
fundoset në harresë.

Nga copëzat e pasqyrave të thyera të kujtimeve
rishfaqet shëmbëllimi yt i dyzuar,
si portreti i Dora Maar në pikturat e Van Gog,
Sytë-dy pellgje me dritë dyshimi
buzët-lulëkuqe të mpiksura
nga puthjet pa pasion.

Lamtumirë Zahir!
Tani dy sy të tjerë me dritë dëshirimi
më joshin në shtegun e zjarrit mistik.

Jam thirrur sërish në rrugën e mundimit.
Prej Qiellit vjen kjo shigjetë shenjtërimi.

U bëftë vullneti yt, o Zot!

Brenda teje është drita

Më zgjo
më thirr
më merr.
Atje ku Fjala bëhet dritë
atje ku Fryma bëhet qiell.

Pemë të larta
me heshtje solemne
me degë të zhveshura
drejtuar nga qielli
si duar të dëshpëruara
në orën e lutjeve.

Këto pemë te duruara
presin pranverën
ta shpërthejnë harenë
në orgji gjethesh
puthje me aroma ngjyrash.

Nga toka e lagësht
e ngrirë e dimrit
kanë çelur ca lule
të vogla, të brishta,
si buzeqeshje të drojtura
mbi peizazhet e zymta.

Zgjohu dhe ti
më thirr
më merr
më nxirr nga ky terr!

Jashtë është udha
brenda teje është drita.

Nga ç'qiell ra trendafili?

Nga strehët e muzgut pikon zëri yt
dhe mbush qenien time
me një rrjedhë të gëzuar.
Pastaj bëhet natë,
jashtë dhe brenda meje.

Një nga një mbyllen sytë e dritareve.
Ç'paqe o Zot
në kopshtijet e Qiellit
ku hëna shëtit
si vejushë e vetmuar!

Fantazmat lule kërkojnë në varreza.
Të pagjumët yjet kundrojnë.
Nga ç'qiell ra trëndafili
në shpirtin e trazuar?

Një luleje

Lule e mbirë buzë një krateri të shuar
ti ëndërroje një dashuri të bukur
ti ëndërroje një dashuri të gjatë.

Lule, lule.
dashuria është më shumë se një ëndërr,
dashuria është më shumë se një natë.

Goja jote, - lulëkuqe zjarri
shkrinte akullin në natën e ftohtë.

Duart e mia si gjethe vjeshte
digjeshin mbi gjinjtë e tu të ngrohtë.

Tani në ëndrrën time bie dëborë.
Hëna e ngrirë rrëzohet nga qielli.
Sytë e tu, si sytë e pikëlluar
    të një drenushe të vrarë.

Ra një mjegull dhe humbëm
    si në balada.

Lule, lule
ëndërr dhe mall.
Lule e mbirë mes vjeshtës së fundit,
si do t'i mbijetosh këtij dimri të gjatë?

Gjithçka që shkon e lë një shenjë

Varkëza të bardha lënë portin e heshtur
e nisen në rrugët e kaltra të detit.
Krahë pulëbardhash
në eklipse klithmash
i ndjekin nga pas.

Gjithçka që vjen
shkon
dhe lë një shenjë.

Ç' trishtim!
Fluturuan kaq shpejt ditët e verës
malli do të marrë formën e buzëve të tua
me shije qershish e manaferrash miksuar.
Brenga, emrin tënd, tatuazh
do ta ketë të brendashkruar.

Ditët do të rrotullohen në karuselin e stinëve
do të bjenë shirat e vjeshtës
por muzgjet, aromën e flokëve te tua
s'do të kenë.

Gjithçka që vjen
shkon
dhe lë në shpirt
një gjurmë
një shenjë.

Plakja e Uliksit

Heronjtë e mëdhenj kishin vdekur me kohë
kujtesa i rrënohej
si një ngrehinë e vjetër.
Të pafuqishëm i ndjente krahët për harkun.
Te mpirë e ndjente mendjen për kurthe te reja.

Asgjë si kujtohej nga bëmat e luftës
as Circja magjepsëse
as kënga e sirenave në të largëtat dete.

Nuk kishte këngë e hymne nga aedët
njëmijë gjinkalla të çmendura i këndonin
    atje në Itakë,
nën hijen e ullinjve në ditët e verës.

Vetëm Kali i drunjtë i fanepsej në livadhe.
me jelet e flakëve të Trojës permbi
(ndërgjegjia e vrarë, karma, hakmarrja...)
dhe Penelopa e plakur
thurte e shthurte pëlhurën e vdekjes.

Mieko Kawakami

GJINJ DHE VEZË

fragment nga romani

Përktheu nga anglishtja
Antonio Çikollari

1. A je i varfër?

Nëse do të dish sa i varfër është rritur dikush, pyete sa dritare ka pasur. Mos e pyet ç'ka pasur në frigorifer apo në gardërobë. Numri i dritareve i thotë të gjitha. Thotë gjithçka. Nëse nuk ka pasur asnjë, apo një ose dy, kaq mjafton për ta ditur.

Mbaj mend t'ia kem thënë njëherë dikujt këtë. S'më kujtohet kujt, por ama ajo m'u hakërrye: "Hë pra, tani. Po sikur të kesh vetëm një dritare, të stërmadhe, me pamje nga oborri apo diçka të ngjashme? E ke parasysh, një si ato dritaret e bukura gjigante. E si mund të jetë një e tillë shenjë e varfërisë?"

Me aq sa jam në dijeni, askush që ka qenë i varfër nuk e ka menduar në këtë formë. Pamje kah oborri? Dritare e bukur gjigante? E kush mund të ketë oborr këto kohë? Dhe ç'dreqin mund ta bëjë "të bukur" një dritare?

Për njerëzit e varfër, madhësia e dritares as që marramendet. Askush nuk ka një pamje. Një dritare nuk është gjë tjetër veçse një xham i turbullt fshehur pas rafteve të ngushtë prej kompensate. E kujt ia merr mendja që ajo gjëja mund të hapet. Një dritare nuk është veçse një drejtkëndësh i yndyrshëm krah ventilatorit të prishur që familja jote nuk e ka përdorur dhe nuk ka për ta përdorur kurrë.

Të vetmet raste kur ti e di ç'do të thotë të jesh i varfër, apo ke të drejtën të flasësh për varfërinë, janë vetëm atëherë kur ke qenë vetë pjesë e asaj shtrese. Mbase je i varfër në të tashmen. Mbase ke qenë i varfër në të shkuarën. Unë bëj pjesë te të dyja kohët. Kam lindur e varfër, jam ende e varfër.

Arsyeja që më bëri të mendoja përsëri për këtë gjë, qe vajza ulur përballë meje. Linja Jamanote qe çuditërisht e boshatisur për një ditë vere. Të gjithë shihnin punën e tyre, qëndronin në telefon ose lexonin.

Vajza duhet të ishte tetë ose dhjetë vjeç. Në të majtë të saj qëndronte një djalosh me çantën e sportit mes këmbëve, ndërsa në të djathtë kishte disa vajza më të mëdha që mbanin mbi kokë kordele me nyje të zezë. Ajo dukej e vetmuar.

Kjo fëmijë ishte tmerrësisht e dobët. Lëkura e saj e zezë i bënte njollat e psoriazisit të pamundura për të mos i vështruar. Mbathur pat një palë tuta të shkurtra gri, këmbët po aq hollake sa krahët që vareshin mes mëngëve të bluzës së bruztë. Buzët i kishte të tërhequra dhe supet e ngurtë – më kujtonte veten time fëmijë. Kjo më bëri të ndërmend se ç'do të thotë të jesh e varfër.

Vështrova jakën e hekurosur të bluzës së saj dhe atletet e zbehura, që me siguri dikur kanë qenë të bardha borë. Sa e tmerrshme do të qe nëse ajo do të hapte gojën dhe të gjithë dhëmbët në të do të ishin të krimbur. Vërejta se nuk kishte çantë. As çantë shpine, as çantë dore, as portofol. Mos ndoshta i mban paratë dhe biletat në xhep? Nuk e kam idenë sesi vishen vajzat e moshës së saj kur iu duhet të marrin trenin, por fakti që ajo s'kishte asgjë me vete më shqetësonte.

Ndjeva të ngrihesha prej ku isha dhe të shkoja t'i pëshpëritja diçka, diçka që askush tjetër nuk do ta kuptonte, si ato shënimet në miniaturë që shkruajmë në këndet e fletores duke e ditur që askush tjetër nuk mund t'i lexojë. Por çfarë mund t'i thosha? Ndoshta diçka rreth flokëve të saj të dendur e të ngrirë, ose ndoshta për lëkurën. Psoriazisi do të të zhduket krejt kur të rritesh. Mos e lër të të vërë përposhtë. Po sikur ta pyesja sa dritare kishte? Nuk i kam pasur kurrë ato lloj dritaresh ku mund të shohësh përjashta. Po ti?

Pashë orën. Shënonte mesditën. Treni rrëshqiste nëpër vapën e vagullt të verës. Nga altoparlanti u dëgjua një zë i mbytur që lajmëronte se stacioni i radhës ishte Kanda. Në stacion, dyert u hapën me shoqërimin e një zhurme të çuditshme, dhe një plak i dehur u hodh brenda. Njerëzit rreth tij i hapën vend instinktivisht. Ai nxori një rënkim të mbytur. Mjekra e tij gri, në dukje si lesh çeliku, varej e dendur mbi kopsat e uniformës së ndëshkuar. Shtrëngoi çadrën shkatarraqe në njërën dorë dhe zgjati tjetrën në kërkim të një rripi mbajtës, por thuajse ra kur doli huq. Dera u mbyll dhe treni u nis. Kur ktheva kokën, vajza qe zhdukur.

Me të vënë këmbë në Stacionin e Tokios, u ndala një grimë para shikimit të të gjithë njerëzve. Nga vinin gjithë këta? Nga shkonin? Dukej më shumë si një garë e çuditshme sesa si turmë. Kisha ndjesinë se isha e vetmja që nuk i dija rregullat e kësaj gare. Duke shtrënguar fort rripat e trastës sime, u përpoqa të mbushem me frymë.

Vizitën e parë në Stacionin e Tokios e pata bërë dhjetë vjet të shkuar, atë verë kur sapo kisha mbushur të njëzetat. Qe një ditë si kjo e sotmja, ku djersa më rridhte çurg.

U shfaqa duke marrë me vete thuajse dhjetë libra prej autorëve të mi të preferuar, të cilët mund t'i postoja paraprakisht me pjesën tjetër të sendeve të mia, si çdo njeri normal, por këmbëngula t'i kem me vete gjatë gjithë kohës, pasi ndihesha më e sigurt, ndihesha më e qetë duke i mbajtur në çantën e rëndë dhe të madhe të shpinës, së cilës i kisha ngulur sytë për një kohë të gjatë në vitrinën e dyqanit të rrobave të përdorura në vitet e gjimnazit (çantë që e përdor ende me raste). Kjo ndodhi në 1998-n. Dhjetë vjet prej së sotmes. Në të njëzetat dyshoja vërtet ta shihja veten, në ëndrrat e mia të mjegullta të së ardhmes, ende në Tokio kur të kapja të tridhjetat. Askush nuk i lexon shkrimet e mia (blogu ka zënë pluhur në internet, ka një apo dy vizitorë në ditën më të mirë), dhe asnjë prej këtyre punëve nuk e ka parë dritën e botimit. Harroji lexuesit, rrallë kam edhe miq. Banoj ende në të njëjtën shtëpi me muret e rrjepur, gjithë harta, dhe me të njëjtin diell përvëlues, duke mbijetuar prej së njëjtës punë me pagë minimale, duke punuar me kohë të plotë e duke mos u paguar më shumë se 100 mijë jen në muaj, dhe ende shkruaj e shkruaj, pa asnjë ide se ku po shkoj. Jeta ime ishte si raftet e pluhurosur të librarisë së vjetër, ku çdo vëllim është pikërisht aty ku kish zënë vend prej shekujsh, i vetmi dallim i dukshëm qe trupi im i plakur me një dekadë më shumë.

Pashë përsëri orën. Dymbëdhjetë e çerek. Meqë isha shfaqur nja pesëmbëdhjetë minuta më herët, u mbështeta pranë një kolone të trashë guri, shtriqa shpinën dhe nisa të shihja njerëzit. Në turmën e pafund të zërave dhe zhurmave, vërejta një familje që nxitonte prej të djathtës sime drejt së majtës, duke tërhequr pas vetes gjithë ç'kishin në këtë jetë. Pashë një nënë që tërhiqte të birin prej dore, të cilit i varej në kyç një shishe uji e stërmadhe. Një foshnjë po ulërinte dhe një çift të rinjsh ngjyer me makijazh zbardhnin dhëmbët.

Nxora telefonin prej çantës. Asnjë telefonatë apo mesazh prej Makikos. Ato duhet të kenë hipur në Shinkanses nga Osaka në orar dhe duhet të mbërrijnë në Stacionin e Tokios për pesë minuta. Plani ishte të takoheshim këtu, në daljen veriore të Linjës së Marunouçit. U kisha dërguar një hartë me postën elektronike që të dinin ku të shkonin, por tani isha e shqetësuar dhe nisa të kontrolloj datën në telefon. Njëzet Gusht. Deri tani asnjë problem. Plani ishte të takoheshim jashtë daljes veriore të Linjës Marunouçi në Stacionin e Tokios në datën njëzet Gusht – që ishte sot – në orën 12:30 të drekës.

I dashur ditar,

Dakord. Pra, kam ngrënë vezë gjatë gjithë jetës sime. Por sot mësova që gratë kanë "ova", njëjtë si "ovale", që në të vërtetë do të thotë vezë. Si është e mundur që më parë kisha mësuar për spermën? Nuk më duket e drejtë. Gjithsesi, ky qe zbulimi im i madh për sot. Kam provuar disa herë bibliotekën e shkollës, por ma bëjnë të vështirë huazimin e librave, a thua se kanë ndonjë përzgjedhje titujsh kushedi se çfarë. Shto këtu që është vend i vogël dhe thuajse i errët. Nëse ulesh në tryezë dhe nis të lexosh diçka, do të zgjatet patjetër dikush mbi kokë për të parë çfarë po lexon. Ndaj u detyrova të shkoj në një bibliotekë të mirëfilltë. Kështu që mund të përdor dhe kompjuterin. Për më tepër, shkolla sikur më shteron. Është idiotësi. Gjithçka është budallallosje. Por është idiotësi të shkruash që është idiotësi. Të paktën në shkollë gjithçka thjesht ndodh. Nuk ngjason aspak me mënyrën sesi rrjedhin gjërat në shtëpi. A thua janë dy botë të ndryshme. Gjëja më e mirë është të shkruaj. Mund ta bësh kudo për aq kohë sa ke laps e letër. Mbi të gjitha është falas. Dhe mund të shkruash ç'të duash. Kjo është ç'është. Po mendoja mbi mënyrat e ndryshme të të shprehurit urrejtjen mbi diçka. Mund ta quash të pakëndshme, neveritëse, revoltuese. I hodha një sy fjalorit për "pakëndshme". Pjesa "pa" është mohuese, "këndshme" qëndron për shijet. Mendoj që ka kuptim.

—Midoriko

Makiko, vizitorja nga Osaka, është motra ime e madhe. Ajo është tridhjetenëntë dhe ka një vajzë dymbëdhjetë vjeçare që quhet Midoriko. Vajzën e ka rritur e vetme.

Disa vite pasi mbusha tetëmbëdhjetë, kur Midoriko qe ende foshnjë, jetoja me to në një shtëpi në Osaka. Makiko dhe i shoqi qenë ndarë gjatë kohës së shtatzënisë së saj, dhe si një nënë e vetme i nevojitej ndihmë si në të ardhura, ashtu edhe në punë shtëpie. Në vend që unë të bëja hyrje-dalje në shtëpinë e saj, e menduam si më me vend nëse do të zhvendosesha tek ato. Midoriko nuk e ka takuar kurrë të atin, të paktën me aq sa jam në dijeni. Madje nuk ka asnjë të dhënë mbi të.

Ende nuk e di përse u ndanë Makiko dhe i shoqi. Mbaj mend biseda të gjata me Makikon për ish-in e saj dhe se kur do të ishte koha e përshtatshme për ndarjen, dhe mbaj mend që situata qe e rëndë, por tashmë as që më kujtohet si ndodhi. Ish-i i Makikos vinte prej Tokios, atje qe rritur. Kish ardhur në Osaka për punë. Nuk kishin jetuar pranë njëri-tjetrit prej shumë kohësh gjatë shtatzënisë. Diçka që më kujtohet si nëpër tym, është mënyra si ai e quante "zemër". Në Osaka askush nuk fliste në këtë formë. Fjalë si këto thuheshin vetëm nëpër filma.

Ne u rritëm në katin e tretë të një apartamenti të vogël ndërtuar buzë oqeanit. Vetëm dy dhoma, njëra më keq se tjetra, pa mure apo ndarje tjetër mes tyre. *Izakaia* në katin përdhese. Mund të shihje oqeanin prej aty. Mbaj mend që shkoja pranë bregut dhe shihja dallgët që përplaseshin te valëthyesit, e që më pas tërhiqeshin për të sulmuar sërish. I gjithë qyteti dukej i kripësuar dhe i përhumbur prej baticave. Natën pushtohej prej burrave të zhurmshëm dhe të dehur. Mbaj mend të shihja njerëz strukur rrugicave, pas ndërtesave. Ndeshjet me grushte dhe të bërtiturat e turmave qenë diçka e përditshme dhe e zakonshme. Madje njëherë, dikush flaku një biçikletë ngjitur me mua. Qentë e rrugëve pillnin gjithmonë këlyshë, dhe me t'u rritur mjaftueshëm, pillnin dhe ata këlyshët e tyre. Në kohën që u futa në shkollë fillore, babai na braktisi, dhe ne të trija u shpërngulëm te gjyshja e cila jetonte në një banesë publike.

Babanë e pashë vetëm ato shtatë vite. Edhe pse fëmijë, mund ta them me bindje se qe burrac. Ai kishte trupin e një nxënësi. Nuk punonte kurrë. Thjesht vërtitej nëpër shtëpi nga mëngjesi në mbrëmje. Komi – mamaja e mamasë – e përçmonte kaq shumë tim atë ngaqë ia mundonte shpirtin të bijës. I ngjiti nofkën "parazit" nga pas. Ai mbante veshur gjithmonë të njëjtën bluzë të njollosur me xhinset e gjata e të gjera dhe shtrihej sa gjerë-gjatë mbi futonin e tij, mobilie e ngahershme e dhomës. Nuk e fikte kurrë televizorin, madje as atëherë kur të gjithë ne flinim. E rrethonin revistat dhe kanoçet e boshatisura. Tymoste duhan pa fund, duke qelbur kështu të gjithë shtëpinë, dhe hirin e shkundte në kanoçe. As që e luante të rëndit të ngrihej vendit, madje ishte i gatshëm të përdorte një pasqyrë të vogël për të parë pas, vetëm e vetëm që të

mos kthehej. Ndonjëherë bënte shaka, kur ishte në të tijat, por në thelb ishte njeri fjalë cekët. Nuk mbaj mend njëherë të vetme të luante me ne apo të na shpinte diku. Nëse kishte diçka që e shqetësonte kur ishim duke fjetur apo kur shihnim televizor, do të na ulërinte, dhe kur dehej, e humbiste durimin dhe godiste mamanë. E me të nisur me shuplakat mbi të, do të gjente me patjetër arsye për ta lëshuar dorën edhe mbi mua me motrën. Thellë-thellë të gjithë i tuteshim.

Një ditë, kur u ktheva nga shkolla, nuk e gjeta më në shtëpi.

Qe e njëjta shtëpi, e rrënuar dhe e muzgët, me rrobat e palara kudo, por pa atë nëpër këmbë gjithçka dukej ndryshe. U mbusha me frymë dhe shkova në mes të dhomës. Bëra të nxjerr zë. Në fillim nuk munda, a thua se ishte gjë e re për mua, por pastaj e lëshova gojën dhe nisa të them ç'më vinte për mbarë. Nuk kisha njeri rrotull. Askush nuk mund të më ndalonte. Pastaj nisa të lëviz, të kërcej. Sa më shumë i lëvizja gjymtyrët, aq më të pavarura i ndjeja. Mund të ndjeja forcën që buronte brenda meje. Pluhuri qetonte mbi televizor, enët e palara qenë kapicë mbi pjatalarëse, figurinat e ngjitura mbi kapakët e bufesë, kolona e drunjtë ku kishim shënjuar gjatësitë tona. Këto gjëra i shihja përditë, por tani ato shkëlqenin, a thua ishin spërkatur me pluhur magjik.

Kjo gjë më trembte, pasi e dija që nuk do të zgjaste përgjithmonë. Gjërat mund të ktheheshin si më parë. Babai mund të mos ishte, por do të kthehej përsëri. E hodha çantën e librave në dysheme dhe u ula në vendin e zakonshëm në qoshe dhe u përpoqa të mbushem me frymë.

Ai nuk u kthye kurrë. As ditën tjetër e as ditën pas saj. S'kaloi shumë dhe shumë burra të çuditshëm nisën të shfaqen në derë, burra të cilët nëna i përzuri. Pastaj filluam të hiqeshim sikur nuk gjendeshim në shtëpi, ama të nesërmen në agim gjenim gjithmonë një kapicë me bishta cigaresh pranë derës. Kjo zgjati ca kohë. Më pas një ditë, thuajse një muaj pas zhdukjes së babait – më në fund mamaja mblodhi futonin e tij, çarçafët e gjithë sa ishin, në banjë e ngado nëpër shtëpi dhe i futi në vaskën e papërdorur prej kohës kur qe prishur ngrohësi. I ngjeshur në atë pak hapësirë të mykur dhe të rënduar prej erës së djersës dhe nikotinës, futoni i babait dukej edhe më i qelbur nga sa mund të duronte njeriu. Pasi i pat ngulur sytë një grimë here, mamaja nisi ta gjuante me ç'i kapte dora. Një muaj pas kësaj, mamaja na shkundi prej gjumit në mes të natës duke na thënë, "çohu, çohu, çohu". Nuk ia shihnim dot fytyrën, por e dinim që gjendja qe serioze. Hipëm në taksi dhe nuk e pamë më kurrë atë vend.

As që mund ta imagjinoja se përse po ia mbathnim apo se ku po shkonim në atë orë të vonë. As që ma merrte mendja. Me të kaluar pak kohë, u përpoqa ta pyes se ç'kish ngjarë, pa ia ngritur nervat, por e dija që babai qe bërë i papërmbajtshëm. Nuk munda të marr një përgjigje prej saj. Dukej sikur do të udhëtonim përmes errësirës në përjetësi, por ja ku mbërritëm në shtëpinë e Komit, në krahun tjetër të qytetit, thuajse më pak se një orë me tren. Komi ishte më e mira.

Mua më zuri makina. Mamaja zbrazi çantën e tualetit dhe ma mbajti pranë që të mund të villja, por nuk po arrija të nxirrja gjë. Fshiva pështymën prej fytyrës me të pasmen e dorës. Mamaja më fërkoi shpinën, por e vetmja gjë që mund të mendoja atë çast ishte çanta e librave. Ajo mbartte gjithçka më nevojitej për orarin mësimor të së martës, fletoret, ngjitëset. Nën to, mes fletores së vizatimit, gjendej palosur vizatimi i një kështjelle që kisha ditë që e punoja dhe të cilin e kisha përfunduar një natë më parë. Regjistruesi qe futur në xhepin anësor. Çanta e ushqimit varej nga jashtë në krah. Kuleta e re e lapsave me ngjyrat, bojërat e preferuara dhe me fshirësit apo topat fosforeshentë. Dhe kapela ime rozë. E doja çantën time të librave. Natën e mbaja te koka pranë futonit tim, dhe kurdo që lija shtëpinë, i shtrëngoja mirë rripat e krahëve pas vetes. Ishte gjithçka për mua. Çanta ishte për mua dhoma personale që e merrja me vete kudo shkoja.

Por ja që e braktisa kur u larguam nga shtëpia. Ia mbathëm në mes të natës, pa bluzën time të preferuar, pa kukullën, pa librat e mi, apo edhe pa tasin tim. E kuptova që nuk do të ktheheshim kurrë pas. Dhe kjo do të thoshte që nuk do ta shihja më kurrë as çantën, aq më pak kuletën e lapsave që e vendosja gjithmonë në tryezën e çajit të nxehtë ku mësoja si të shkruaja, nuk do të ulesha më atje për të mprehur lapsat apo të mbështetesha pas murit të gërvishtur dhe të lexoja. Ndihesha çuditshëm ndërsa mendoja këto gjëra, a thua se një pjesë e trurit tim qe në gjumë. Nuk kisha pikën e fuqisë të lëvizja këmbët apo duart. Pyesja veten nëse isha vërtet unë. Dua të them, më dukej sikur gjysma tjetër e imja do të zgjohej papritur dhe do të nisej për në shkollë, duke pasur një ditë krejt normale. Vetja ime që mbylli sytë për të fjetur nuk do ta kishte imagjinuar kurrë që disa orë më pas do të linte gjithçka pas dhe do të kërcente mbi taksi me mamanë dhe Makikon dhe do t'ia mbathnin përmes natës për të mos u kthyer kurrë. Kur ngula sytë në errësirën e natës përtej xhamit, dukej sikur ajo pjesë e imja, që nuk e kishte menduar se kjo do të ndodhte, ishte ende në gjumë, nën shtroje. Kur të zgjohesha mëngjesin e ardhshëm dhe të shihja që nuk isha aty, si do të reagoja? Këto mendime sikur më sollën në vete. Lëviza pak shpatullën mbi krahun e Makikos. Më flihej shumë. Me qepallat thuajse mbyllur, mund të shihja reklamat e gjelbra që ndriçonin përmes errësirës. Sa më larg shtëpisë shkonim, aq më të mëdhenj bëheshin numrat pa lëshuar as një zhurmë.

Ia mbathëm dhe nisëm një jetë të re duke jetuar me Komin, gjë e cila nuk zgjati shumë.

Mamaja vdiq kur isha trembëdhjetë vjeç, Komi vdiq dy vite më vonë.

Me të mbetur vetëm të dyja, nisëm të punonim si të çmendura. E vetmja gjë që na mbante larg rrugës ishin ato 80,000 jen që Komi i kishte fshehur nën altarin e familjes. Nuk mbaj mend thuajse asgjë prej fillimit të shkollës së mesme, kur mamaja mori vesh që kishte kancer gjiri, e as prej gjimnazit, kur kanceri i mushkërive mori Komin. Isha shumë e zënë me punë. Ajo që mbaj mend janë gënjeshtrat e thëna nëpër fabrikë rreth moshës sime çdo pushime, pranverë, verë dhe dimër, përgjatë gjithë trevjeçarit të shkollës së mesme. Hekurat e salduar që vareshin në tavan dhe ciflat e shkëndita. Male të lartë me kuti kartoni të palosura. Shumica e kujtimeve asokohe i kam prej lokalit. Një vend i vogël që e kishte një shoqe e mamasë. Mamaja bënte disa punë gjatë ditës dhe darkave shërbente këtu. Makiko ishte në gjimnaz atëherë dhe nisi punë aty përpara meje, lante enët. Shumë shpejt nisa të punoj në kuzhinë, duke shërbyer sake dhe ushqim të shpejtë, ndërkohë që mamaja mbante me muhabet klientët. Makiko gjeti një punë të dytë në një restorant me gatime skare dhe punonte aq sa i binte të fiktë. Paguhej 600 jen në orë, por në muajt më të mirë arrinte të fitonte edhe 120,000 jen (gjë që e bënte të famshme në atë vend). Për disa vite pas gjimnazit, e vendosën në kasë, ku edhe punoi derisa puna u mbyll. Pastaj mbeti shtatzënë me Midorikon dhe nisi t'i ndërronte punët shpesh, por pas gjithë këtyre viteve, në moshën tridhjetenëntëvjeçare, punon ende në një bar, pesë net në javë, duke bërë thuajse të njëjtën jetë si mamaja jonë. Një tjetër mama e vetme që e stërmundon veten deri në vdekje.

Kishin kaluar pesëmbëdhjetë minuta prej kohës kur duhet të takoheshim dhe Makiko me Midorikon as që dukeshin. U përpoqa t'i telefonoj, por Makiko as më përgjigjej e as më shkruante. Ku kishin humbur? Pesë minuta më vonë, kur bëra ta telefonoja përsëri, dëgjova të më vijë një mesazh.

"Si ta gjej daljen? Jam mbi platformë."

Pashë ekranin e mbërritjeve, gjeta trenin që isha e sigurt se ato kishin marrë nga Osaka, bleva një biletë tek makineria, kalova përmes dyerve e më pas u drejtova për te shkallët. Lart tek shinat, i nxehti i Gushtit ngjante si banjat e avullit. Kisha nisur të djersija. Pasi çava mes turmës që priste trenin e radhës në rresht pranë kioskave, më në fund sytë më zunë Midorikon dhe Makikon ulur në një stol aty nga fundi i platformës.

- Ej! - bërtiti Makiko. - Pa shiko.

Ajo qeshi kur më pa dhe s'mund të bëja ndryshe veçse t'i ktheja buzëqeshjen. Midoriko, ulur krahë saj, qe rritur edhe njëherë aq sa e mbaja mend herën e fundit. Nuk iu besoja syve sa e madhe qe bërë.

- Midoriko! - thashë me gjysmë zëri. - Po këto këmbë nga na dolën? Ua.

Me flokët e kapur bisht kali nga pas, Midoriko mbante veshur një bluzë lisho dhe pantallona të shkurtra. Mbase dukej ashtu ngase qëndronte ulur – por këmbët i pat vërtet të gjata. E preka lehtë në gju. Më pa e turpëruar, por e ëma ndërhyri.

- E di, është e pabesueshme, as unë nuk mund ta besoj sa shumë është rritur.

Midoriko sikur u bezdis nga këto fjalë dhe ktheu kokën tej. Mori çantën e shpinës që ndodhej në stol krah saj dhe e pushoi mbi prehër. Makiko më pa me një fytyrë të shtrembër dhe plot dhimbje. Kjo i thoshte të gjitha.

Midoriko nuk i kishte folur të ëmës për plot gjashtë muaj.

Nuk e dija pse. Një ditë, Makiko e pyeti për diçka dhe ajo nuk iu përgjigj. Kaq ishte. Në fillim ajo mendoi se Midoriko ishte e dëshpëruar, por nuk dukej të qe kjo. Ajo ishte mendërisht e shëndetshme, shkonte në shkollë dhe fliste me shokët e klasës dhe mësuesit si normalisht. Por me të ëmën ishte ndryshe. Nuk dukej se kishte ndonjë përplasje mes tyre. Thjesht nuk donte t'i ndihej zëri nëpër shtëpi. Ishte e qëllimshme. Makiko qe përpjekur të zbulonte ndonjë gjë, duke u treguar e kujdesshme, por asnjë shenjë. Midoriko nuk linte shteg për zgjidhje.

- Ne nuk flasim me njëra-tjetrën. Thjesht shkëmbejmë letra.

Jo shumë kohë pas këtij vendimi, Makiko më telefonoi, e stresuar, dhe më rrëfeu ç'po ndodhte.

- Letra?

- Po. Laps e letër. Asnjë fjalë. Domethënë, unë ende flas, por Midoriko më kthen përgjigje me të shkruar. U bë thuajse një muaj.

- Një muaj?

- Plot një muaj.

- Çdo ditë?

- Në fillim nuk dija si të reagoja. E pyeta pafundësisht, por nuk zbulova asgjë. Diçka ka ndodhur, jam e sigurt, por nuk do të ma tregojë çfarë. Edhe kur i bërtas, nuk bëzan. E kam thikë në zemër, por mesa duket ajo bisedon me të gjithë në shkollë krejt normalisht... Vë bast se është ndonjë nga këto gjërat e reja ku fëmijët fajësojnë prindërit për gjithçka. Është mosha. Nuk do të zgjasë përgjithmonë. Do të kalojë, do të kalojë patjetër.

Makiko qeshi në telefon në përpjekje për t'u dukur e lumtur. Por ja ku kishte kaluar një gjysmë viti. Tashmë kështu qenë gjërat dhe nuk kishte shenjë për ndryshime.



Ligjërata e Nobelit për letërsinë, 7 dhjetor 2022

ANNE ERNAUX

Nuk e shoh si fitore individuale çmimin Nobel që më është blatuar

Përktheu nga anglishtja: Granit Zela

Ku të filloj? Këtë pyetje ia kam bërë vetes dhjetëra herë, duke vështruar ngultas një faqe të zbrazët. Sikur të më duhej të gjeja fjalinë e vetme, të vetmen që do të më jepte hyrjen në shkrimin e librit dhe do të më largonte sakaq të gjitha dyshimet aty për aty – një lloj çelësi. Sot, teksa përballem me një situatë, e cila, pasi ka kaluar hutimi fillestar – "a po më ndodh përnjëmend mua e gjitha kjo?" – imagjinata ime vepron në një mënyrë që e shton tmerrin pak e nga pak, kësisoj përballem me të njëjtën domosdoshmëri, gjetjen e fjalisë që do të më japë lirinë dhe vendosmërinë për të folur pa u dridhur në këtë vend ku më keni ftuar këtë mbrëmje.

Për ta gjetur atë fjali, nuk më duhet të kërkoj shumë larg. Shfaqet në çast. Me gjithë qartësinë dhe dhunën e saj. E skalitur mirë. E pakundërshtueshme. Është shkruar në ditarin tim gjashtëdhjetë vjet më parë. "Do të shkruaj për të marrë hak për racën time, j'écrirai pour venger ma race". I bënte jehonë thirrjes së Rimbaud: "Unë jam nga një racë inferiore për gjithë përjetësinë". Isha njëzet e dy vjeçe, duke studiuar letërsi në një fakultet provincial me vajzat dhe djemtë e borgjezisë vendase, në pjesën më të madhe. Me krenari dhe naivitet besoja se të shkruarit e librave, duke u bërë shkrimtare, si e fundit në radhën e punëtorëve pa tokë, punëtorëve të fabrikave dhe shitësve, njerëzve të përbuzur për sjelljet, theksin, mungesën e edukimit, do të mjaftonte për të ndrequr padrejtësinë sociale lidhur me klasën shoqërore të cilës i përket në lindje. Që një fitore individuale mund të fshinte shekujt e sundimit dhe varfërisë, një iluzion që shkolla e kishte ushqyer tashmë tek unë për shkak të suksesit tim akademik. Si mund të kishin shlyer arritjet e mia personale ndonjë nga poshtërimet dhe fyerjet e bëra? Kjo nuk është një pyetje që ia kam bërë ndonjëherë vetes. Kisha gjetur disa shfajësime.

Që nga koha kur mund të lexoja, librat ishin shoqëruesit e mi dhe leximi ishte puna ime e natyrshme jashtë shkollës. Ky oreks ushqehej nga një nënë, e cila mes klientëve, në dyqanin e saj, lexonte shumë romane dhe parapëlqente që unë të lexoja më shumë se sa të qepja dhe thurja me shtiza. Çmimi i lartë e librave, dyshimi me të cilin shiheshin në shkollën time fetare, i bënte edhe më të dëshirueshëm. Don Kishoti, Udhëtimet e Guliverit, Jane Eyre, përrallat e vëllezërve Grim dhe të Andersenit, David Koperfild, "Bashkë me erën", dhe më vonë "Të mjerët", "Vilet e zemërimit", "Neveria", "I huaji", leximet e rastësishme, më shumë se recetat e shkollës, përcaktuan atë që unë lexova.

Duke zgjedhur studimet letrare, zgjodha të qëndroja brenda letërsisë, e cila ishte bërë gjëja me vlerën më të madhe, madje një mënyrë jetese që më bëri të projektoja veten në romanet e Floberit ose të Virxhinia Vulfit dhe t'i përjetoj në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Letërsia ishte një lloj kontinenti të cilin në mënyrë të pandërgjegjshme ia kundërvura mjedisit tim shoqëror. Dhe e konceptova shkrimin si asgjë më pak se mundësia e shpërndërrimit të realitetit.

Nuk ishte refuzimi i romanit tim të parë nga dy ose tre botues – një roman merita e vetme e të cilit ishte përpjekja për të gjetur një formë të re – ajo që ndrydhte gjakimin për të shkruar dhe lëndonte krenarinë time. Ishin situata të jetës në të cilat pesha e dallimit midis ekzistencës së një gruaje dhe asaj të një burri ndihej fort në një shoqëri ku rolet përcaktoheshin sipas gjinisë, ku parandalimi i shtatzënisë ishte i ndaluar dhe ndërprerja e saj një krim. E martuar me dy fëmijë, me pozitën e mësueses dhe përgjegjësisë e plotë për punët e shtëpisë, çdo ditë i largohesha gjithnjë e më shumë shkrimit dhe premtimit tim për t'u hakmarrë për njerëzit e mi. Nuk mund ta lexoja parabolën "Para ligjit" nga "Gjyqi" i Kafkës pa parë formën e fatit tim: të vdisja pa hyrë kurrë në portën e bërë vetëm për mua, pa librin që vetëm unë mund ta shkruaja.

Por kjo është gjendja pa marrë parasysh rrethanat private dhe historike. Vdekja e tim ati i cili ndërroi jetë tre ditë pasi mbërrita në shtëpi me pushime, një punë ku u jepja mësim studentëve me prejardhje nga klasa punëtore e ngjashme me timen, lëvizje proteste kudo në botë: të gjithë këta faktorë më kthyen, nëpërmjet shtigjesh të paparashikuara afër botës së origjinës sime,të "njerëzit" e mi, dhe më ngjallën dëshirën për të shkruar me një ndjesi të fshehtë dhe ngulmim absolut. Hoqa dorë nga "të shkruarit" e gënjeshtërt "për asgjë" që bëja kur kisha mbushur të njëzetat, tani ishte çështja për të depërtuar në të papërshkrueshmen tek kujtesa e shtypur dhe për të nxjerrë në dritë mënyrën se si jetonin njerëzit e mi. Të shkruaja për të kuptuar arsyet, brenda dhe jashtë vetes sime, që më kishin bërë të krijoja largësi me origjinën time.

Tek të shkruarit, asnjë zgjedhje nuk është e vetëkuptueshme. Por ata që, si emigrantë, nuk flasin më gjuhën e prindërve të tyre dhe ata që, si të braktisur nga klasa shoqërore që i

përkasin, nuk kanë më të njëjtën gjuhë, mendojnë dhe shprehen me fjalë të tjera, përballen me pengesa të tjera shtesë. Një mëdyshje. Ata vërtet e ndiejnë vështirësinë, madje edhe pamundësinë për të shkruar në gjuhën e përvetësuar, mbizotëruese, të cilën e kanë zotëruar dhe e admirojnë në veprat letrare, çdo gjë që lidhet me botën e tyre të origjinës, më të parën botë të formësuar prej ndjesish dhe fjalësh që përshkruajnë jetën e përditshme, punën, vendin e njeriut në shoqëri.

Nga njëra anë është gjuha me të cilën ata mësuan t'u vënë emër gjërave, me vrazhdësinë dhe heshtjet e saj, për shembull ajo e shkëmbimit intim midis një nëne dhe një djali në tekstin shumë të bukur të Albert Kamys, "Mes po-së dhe jo-së". Nga ana tjetër janë modelet e veprave të çmuara, të brendësuara që e bënë më të parën botë të hapur dhe ndaj të cilave ata ndihen borxhli për lartësimin që kanë përjetuar prej tyre; të cilin ndonjëherë e shihnin edhe si atdheun e tyre të vërtetë. E imja përfshinte Floberin, Prustin, Virxhinia Vulfin. Asnjëri prej tyre, kur iu ktheva shkrimit, nuk më ndihmoi. M'u desh të shkëputesha nga fjalitë e "shkruara mirë" dhe të bukura – pikërisht prej atyre që u mësoja të shkruanin studentëve të mi – për të çrrënjosur, shpërfaqur dhe kuptuar plagomën që më kishte ndodhur mua. Ajo që më erdhi vetvetiu ishte klithma e një gjuhe që përcillte zemërim dhe tallje, madje edhe vrazhdësi; një gjuhë e teprisë, kryengritëse, e përdorur shpesh nga të poshtëruarit dhe të fyerit si reagimi i tyre i vetëm ndaj kujtimit të përbuzjes së të tjerëve, turpit dhe turpit që ndjen turp.

Po kështu, shumë shpejt, u duk e vetëkuptueshme – deri në pikë sa nuk mund ta imagjinoja ndonjë mënyrë tjetër për të filluar – të ngërthej historinë e plagomës së qenies time shoqërore në situatën që kisha qenë e imja si studente, një situatë revoltuese në të cilën shteti francez ende i dënonte gratë, nevojën për të kërkuar mënyra klandestine duke përfunduar në duart e abortuesve të rrugës. Dhe unë doja të përshkruaja gjithçka që kishte ndodhur me trupin time rpej vajze; zbulimin e kënaqësisë, periodat. Dhe kështu, pa qenë e vetëdijshme për këtë asokohe, ai libër i parë, i botuar në vitin 1974, përcaktoi sferën në të cilën unë do ta vendosja të shkruarit, një sferë sociale dhe feministe. Shpagimi për njerëzit e mi dhe shpagimi për gjininë time, do të ishin, që nga ajo kohë, e njëjta gjë.

Si mund të reflektohet për jetën pa reflektuar edhe për të shkruarin? Pa e pyetur veten nëse shkrimi përforcon apo prish paraqitjet e pranuara, të brendësuara të qenieve dhe sendeve? Me dhunën dhe talljen e tij, a nuk pasqyronte shkrimi rebelues qëndrimin e të sunduarve? Kur lexuesi ishte i privilegjuar në aspektin kulturor, ai mbante të njëjtin këndvështrim detyrues dhe nënçmues për personazhin e një libri ashtu si do të bënte në jetën reale. Prandaj, fillimisht, uhej shmangur ky lloj shikimi, i cili, kur i drejtohe babait tim, historinë e të cilit do të tregoja, do të ishte e padurueshme dhe, e ndjeva sikur po bëja një tradhti, prandaj duke filluar me librin tim të katërt, përvetësova të shkruarit asnjanës, objektiv, "të rrafshtë" në kuptimin që nuk përmbante as metafora dhe as

shenja emocioni. Dhuna nuk shfaqej më; dilte nga vetë faktet dhe jo nga shkrimi. Gjetja e fjalëve që përmbajnë realitetin dhe ndjesinë që jep realiteti do të bëhej dhe do të mbetej edhe sot e kësaj dite, shqetësimi im i vazhdueshëm gjatë shkrimit, ciladoqoftë nga tema.

Ishte e nevojshme që të vazhdoja të thoja "unë". Në përdorimin letrar, rrëfimi në vetën e parë – asaj përmes të cilës ekzistojmë, në shumicën e gjuhëve, që nga çasti kur dimë të flasim deri në vdekje – shpesh shihet si veprim vetëdashës kur nënkupton autorin dhe jo një "unë" të trilluar. Ia vlen të kujtohet se "unë", deri atëherë privilegji i fisnikëve që tregonin bëmat e armëve në kujtimet e tyre, ishte në Francë një pushtim demokratik i shekullit të tetëmbëdhjetë, pranimi i barazisë së individëve dhe i së drejtës për të qenë tema e historisë së tyre, siç mëtohet nga Zhan Zhak Ruso në këtë hyrje të parë të "Rrëfimeve": "Dhe askush të mos kundërshtojë se, ngaqë jam njëri prej njerëzve të zakonshëm, nuk kam për të thënë asgjë që meriton vëmendjen e lexuesve. [...] Pavarësisht se sa e rëndomtë mund të ketë qenë jeta ime, nëse kam menduar më shumë dhe më mirë se mbretërit, historia e shpirtit tim është më tërheqëse se e tyrja".

Nuk ishte kjo krenaria plebejane që më ka motivuar (edhe pse, e kam thënë tashmë...) por dëshira për të përdorur vetën e parë "unë" – një formë sa mashkullore dhe femërore – si një mjet hulumtues që përkap ndjesitë: ato që kujtesa i ka varrosur, ato që bota rreth nesh vazhdon të japë, kudo dhe gjatë gjithë kohës. Parakushti i ndjeshmërisë për mua është bërë edhe udhërrëfyesi dhe garancia e vërtetësisë së kërkimit tim. Por për çfarë qëllimi? Jo për të treguar historinë e jetës sime dhe as për të çliruar veten nga të fshehtat e saj, por për të deshifruar një situatë të jetuar, një ngjarje, një marrëdhënie romantike dhe në këtë mënyrë të zbuloj diçka që vetëm shkrimi mund të sjellë në jetë dhe ndoshta t'ia kalojë ndërgjegjes dhe kujtimeve të të tjerëve. Kush mund të thotë se dashuria, dhimbja dhe zia, turpi, nuk janë universale? Viktor Hygo ka shkruar: "Asnjëri prej nesh nuk ka nderin të jetojë një jetë që është vetëm e tij". Por ndërsa të gjitha gjërat jetohen pashmangshëm në mënyrë individuale – "a po më ndodh përnjëmend mua e gjitha kjo?" - mund të lexohet vetëm në të njëjtën mënyrë nëse "unë" e rrëfimit të librit bëhet i tejdukshëm, në njëfarë kuptimi, dhe "unë" i lexuesit arrin ta bëj të vetin. Nëse ky "unë", për ta thënë ndryshe, bëhet ndërnjerëzor.

Kështu e konceptova përkushtimin tim ndaj të shkruarit, i cili nuk ka të bëje më të shkruarit "për" një kategori lexuesish, por me të shkruarit që merr jetë nga "përvoja ime si grua dhe emigrante e brendshme; dhe nga kujtesa ime gjithnjë e më e pamatë e viteve që kam jetuar, dhe nga e tashmja, që më ushqen pareshtur me imazhe dhe fjalë të të tjerëve. Ky përkushtim me anë të të cilit shkruaj mbështetet te besimi, i cili është bërë i palëkundur, se një libër mund të kontribuojë në ndryshimin e jetës vetjake, të ndihmojë në shkërmoqjen e vetmisë së përvojave të mbajtura dhe të ndrydhura brenda vetes dhe t'u mundësojë qenieve të riimagjinojnë veten. Kur e pathëna del në dritë, ajo është politike.

E shohim sot në revoltën e grave që kanë gjetur fjalët për t'i dhënë fund pushtetit mashkullor dhe që janë ngritur, si në Iran, kundër formës së tij më arkaike. Megjithatë, duke shkruar në një vend demokratik, vazhdoj të pyes veten për vendin që zë gruaja në fushën e letrave. Ata nuk kanë fituar ende legjitimitet si krijuese të veprave të shkruara. Ka burra në botë, duke përfshirë edhe sferat intelektuale perëndimore, për të cilët librat e shkruar nga gratë thjesht nuk ekzistojnë; ata kurrë nuk i citojnë ato. Njohja e punës sime nga Akademia Suedeze është një shenjë shprese për të gjitha shkrimtaret femra.

Në nxjerrjen në dritë të së pathënshmes sociale, të atyre marrëdhënieve të brendshme të pushtetit të lidhura me klasën shoqëroee dhe/ose racën, dhe gjithashtu me gjininë, të ndjera vetëm nga njerëzit që përjetojnë drejtpërdrejt ndikimin e tyre, shfaqet mundësia e emancipimit individual por edhe kolektiv. Të deshifrosh botën reale duke e zhveshur nga vizionet dhe vlerat që u jep gjuha, e gjithë gjuha, mbart brenda saj, do të thotë të përmbysësh rendin e vendosur, të prishësh hierarkitë e saj.

Por unë nuk e ngatërroj veprimin politik të shkrimit letrar, në varësi të pritjes së tij nga lexuesi, me qëndrimet që ndihem e detyruar të mbaj në lidhje me ngjarjet, konfliktet dhe idetë. Unë u rrita si pjesë e brezit të pasluftës, pas Luftës së Dytë Botërore, kur shkrimtarët dhe intelektualët u pozicionuan në lidhje me politikën franceze dhe u përfshinë në betejat sociale si një gjë e natyrshme. Sot është e pamundur të thuhet nëse gjërat do të kishin shkuar ndryshe nëse ata nuk do të kishin folur dhe nuk do të ishin angazhuar. Në botën e sotme, ku shumëllojshmëria e burimeve të informacionit dhe shpejtësia me të cilën përcillen imazhet kushtëzojnë një formë mënjanësie, përqendrimi në artin e dikujt është një ngasje. Por, ndërkohë, në Evropë, është në rritje një ideologji tërheqjeje dhe mbylljeje, ende e fshehur nga dhuna e një lufte imperialiste të zhvilluar nga diktatori në krye të Rusisë, dhe që fiton vazhdimisht terren në vendet e deritanishme demokratike. E mbështetur në përjashtimin e të huajve dhe emigrantëve, braktisjen e të dobëtve ekonomikisht, mbikqyrjen e trupave të grave, kjo ideologji kërkon një detyrë për t'u treguar tejet syhapur, si unë ashtu edhe të gjithë ata për të cilët vlera e një qenieje njerëzore është gjithmonë dhe kudo e njëjtë.

Duke më dhënë vlerësimin më të madh letrar të mundshëm, një dritë e shndritshme po ndriçon mbi veprën që përbëhet nga të shkruarit dhe kërkimi personal i kryer në vetmi dhe me një ndjenjë dyshimi. Kjo dritë nuk më verbon. Nuk e shoh si fitore individuale çmimin Nobel që më është blatuar. Nuk ka të bëjë as me krenarinë dhe as me modestinë fakti që unë e shoh, në një farë kuptimi, si një fitore kolektive. Unë ndiej të njëtën krenari që niejnë ata të cilët, në një mënyrë apo në një tjetër, shpresojnë për më shumë liri, barazi dhe dinjitet për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga seksi apo gjinia, ngjyra e lëkurës dhe kultura e tyre; dhe me ata që mendojnë për brezat e ardhshëm, për të mbrojtur një Tokë ku pak njerëz të etur për fitime e bëjnë jetën gjithnjë e më të pajetueshme për të gjitha popullsitë.

Nëse e kthej kokën pas tek premtimi i bërë kur ish në të njëzetat për të marrë shpagim për njerëzit e mi, nuk mund të them nëse e kam përmbushur. Pikërisht nga ky premtim dhe nga paraardhësit e mi, burra e gra punëtorë që bënin punë që ishin shkaku pse ata vdisnin herët, gjeta forcën dhe zemërimin e mjaftueshëm për të pasur dëshirën dhe ambicjen për t'u dhënë atyre një vend në letërsi, mes këtij kori zërash që më shoqëruan qysh në fillim, duke më bërë të mundur të hyjë në botë të tjera dhe mënyra të tjera të qenies, që përfshijnë edhe atë të rebelimit, edhe dëshirën për ta ndryshuar, në mënyrë që të gdhend zërin tim si një grua dhe një dezertore shoqërore që hidhet në krahun e kundërt, në atë që ende paraqitet si një hapësirë emancipimi, letërsia.







Elivjana Shukulli

VJESHTA NGA SYTË E GJETHES

"Vjeshta është një pranverë e dytë, ku çdo gjethe është një lule"

ALBERT CAMUS

Ta dije si është të zgjohesh me dritën e diellit, që të bie mbi fytyrë, me flladin e lehtë, që të ledhaton, gati-gati të shkund, që të çohesh me zhurmat e natyrës, të cilat krijojnë në ajër një melodi të qetë, një harmoni tingujsh, një muzikë paqësore, do të doje të ishe si unë. Për një kohë të gjatë, mbaja veshur fustanin tim jeshil, atë, të thjeshtin, por, lozonjarin. Isha më e re, më e freskët, të gjithë më dashuronin. Tani, që koha ndryshoi pak dhe era e ftohtë më drithëron, vendosa t'i shtoja pak ngjyra jetës sime. Mora pëlhurën time të artë, copën time më të bukur dhe, me penelin tim të hollë, vizatova, mbi të, motive abstrakte, me kombinime ngjyrash, me vija të lakuara, pa fillim e pa fund, që ndajnë, në mënyrë, pothuajse të përsosur, të verdhën nga portokallia, të kuqen nga kafeja.

Me kalimin e ditëve dhe muajve, kam ndryshuar. Dhe jo vetëm unë... Nëna ime, vazhdon akoma, e mban familjen tonë nën krahët e saj. Edhe pse është më e dobët, më e përgjumur nga ç'ka qenë, ajo, prapë, mbetet mahnitëse. Por, ne, si fëmijët e saj, nuk harruam t'ia shpërblenim mundin. U bashkuam dhe e veshëm me flori. Thesari ynë u bë pamja e saj. I dhamë një tjetër ngjyrë, një tjetër ndriçim, jo si atë të verës, por i dhamë një shkëlqim të veçantë, një, që depërton lëkurën dhe kockat dhe arrin shpirtin, një, që ta mbërthen shikimin, sa të bën të harrosh sensin e kohës. Është i njëjti shkëlqim, që frymëzon poetët t'i thurrin poezi dhe këngëtarët t'i kushtojnë këngë...

I ngrohti ikën, ashtu si perëndon dielli: ngadalë-ngadalë, në heshtje, por, me çdo sekondë që kalon, ti, e ndien edhe më shumë mungesën e tij. Ky yll i zjarrtë, vërtet, më bën ta adhuroj. Me hijeshinë e tij mbretërore dhe me hapa të rëndë aristokratikë, u drejtohet maleve dhe fillon, pak nga pak, të fshihet pas tyre. I mbulohen këmbët, të parat, pastaj trupi, shpatullat, qafa, koka... Dhe ja, i shikoj për herë të fundit sytë, ata, që ma verbojnë shikimin, ata, që e dallojnë nga gjithë yjet e tjera, pika e tij më e fortë. Shënjestron qiellin dhe e godet, me ngjyra, pa pushim, ashtu si, një piktor i pasionuar, hedh bojën mbi telajo. Shikoj se si e kaltra bashkohet dhe shkrihet me të kuqen, të verdhën, pak lilanë dhe rozën. Një kryevepër! Vetëm ta vështrosh dhe qetësohesh, të kënaqet shpirti, duket sikur rinon trupin tim të thatë. Dhe s'është vetëm kaq.

Nata është ajo, që të zgjon interesin, për të parë një botë tjetër, një botë që të sfidon kureshtjen. Drita e argjendtë e hënës tregon se ka ardhur ora e qetësisë, ora e filozofëve dhe mendimtarëve, ora e së vërtetës (Paradoksale: Në dritë, fshihet e gjithë gënjeshtra dhe, në errësirë, zbulohet mashtrimi dhe bien maskat). Nata është plot mistere, plot të panjohura. Edhe pse bie të fle, me sigurinë, që më jep hëna nga lart, kur më shikon, gjithmonë pres të papriturën. Dhe ja! Siç e parashikova. Erëra të tmerrshme, si kuaj të egër, që shfryjnë dhe kërcasin dhëmbët, teksa tërheqin litarët, që i mbajnë lidhur, stuhi të frikshme, që duket sikur kërkojnë hakmarrje, vijnë për të marrë pushtetin. Shtrëngoj duart pas krahëve të nënës dhe përpiqem të rezistoj. Lëkundem njëherë majtas e njëherë djathtas. Më duket, sikur duan të më rrëmbejnë nga foleja ime. Shikoj se si, të tjerët, po i lenë fuqitë, shkëputen nga familja e tyre dhe humbasin në errësirë. Dhe, atje ku mendova, se i njëjti fat do të më ndiqte dhe mua, gjithçka pushon. Hedh sytë rreth e rrotull, përpiqem të kap, qoftë dhe zhurmën më të vogël. Por jo. Asgjë. Kaq ishte...për sot. Siç e thashë: Nata është plot mistere, plot të panjohura.

Mëngjes. Aroma e tokës, në këtë kohë, është më e ëmbël, se në çdo periudhë tjetër të vitit. Është një bashkim i lagështisë së tokës, freskisë së drurëve, tymit të pakët të oxhaqeve të para, që janë ndezur, ngrohtësisë së vatrave familjare, thjeshtësisë së natyrës dhe, sado e trishtë të dëgjohet, fundit të jetës...

Cikli jetësor mbetet cikël, fillimi kërkon një fund, lumturia ka nevojë për trishtimin. Ajo, çfarë më pëlqen më shumë, tani në fund, është se ndihem e përmbushur, e kam zemrën plot, kam parë gjithçka, që duhej të shikoja, kam kaluar çdo stinë, kam përjetuar çdo emocion, kam fituar përvojë. Kjo ishte e gjitha për mua. Dhe, ky është momenti, kur ndihem më e gjallë se kurrë. Kujtoj të shkuarën time, por, në të njejtën kohë, ndiej këputje, duart më janë mpirë, nuk mbahem dot më. Koha afrohet akoma më shumë. E sa do të duroj? Miqtë e mi u dorëzuan para meje. Më prisni motra e vëllezër, do t'ju bashkohem. A do të më marrë malli? S'e di. Por, kjo kornizë e mrrekullueshme, e kësaj stine, e krijuar prej balancës së paqes dhe luftës ka për t'u skalitur në mendjen time.

Shikoj pemë tërësisht të zhveshura. Me degët e rrëzuara, përpiqen të mbulohen sadopak. Siluetat e tyre, ashtu, të brishta dhe të paprekura, siç duken, janë një art më vete. Kush jam unë që t'ua prish bukurinë duke i parë? Dhe lëshoj duart.

Fluturoj ngadalë, rrotullohem rreth vetes, thua sikur kërcej valsin e dashurisë me ajrin dhe, në fund, prek tokën. Këtu poshtë ka një tjetër pamje. Sa i madh qënka qielli! Ah! Më në fund! I parapëlqyeri im! Shiu. Çdo pikë vallëzon me shoqen e vet, qeshin e kënaqen. Përplasen pas çative, stolave, rrugëve e luleve. Më vjen të këndoj nën ritmin e tyre. Mund ta ndiej edhe prekjen e tyre të butë. Duket sikur më japin njëmijë puthje në të njejtën kohë. Dhe ja, kështu, në fund të udhëtimit, vazhdoj të jem e lumtur. Bota nuk duhet të më shikojë me keqardhje. Një fund ka, pas tij, një tjetër fillim. Lumturia qendron tek vlerësimi i së tashmes. Dhe unë e jetova të tashmen. Dhe kjo, që përjetoj tani, nuk zëvendësohet, as me gjithë thesaret e botës, as me një jetë të dytë.

DY FJALË PËR ELIVJANËN

Pak pasi u ktheva nga një promovim nga Korça, së bashku me Visar Zhitin, shoh që më kishte ardhur një e-mail në adresën time personale me subjekt "Kërkesë për botimin në gazetën 'ExLibris' të një shkrimi letrar". Kryesisht subjektet janë "Për botim", "Botoje!" ose "Përshëndetje", ndaj edhe u nxita ta lexoja.

Takimi në Korçë ishte kryesisht me gjimnazistë të qytetit dhe vajza që shkruante ishte pikërisht një gjimnaziste e atij qyteti. Më thoshte se *gazeta "ExLibris" përfshin disa nga shkrimet më të bukura që ka lexuar...*

Paraditen e asaj dite, dikush më kishte treguar në kafe disa komente në një profil facebooku. Njëri që pasi merr financime nga aksh shoqatë, shkruan kundër saj; pasi mirëpritet në zyrë nga një ministër, e shan atë pse s'i jep para e gjëra të atilla, shkruante edhe për gazetën pse aty nuk i ishte botuar një shkrim i tiji për të cilin qartësisht kishte marrë para. U mërzita, pse këto njerëz e kanë rrethin e gjerë në mediat sociale dhe e kthejnë hapësirën e tyre në tabelë qitjeje për këdo që s'u përmbush interesat. Pas asaj shëmtie të thurur me shkronja dhe shijes së keqe që më la, vjen ky mesazh me të cilin u mbusha plot.

M'u kujtua vetja ime si shtatëmbëdhjet vjeçar, dërgoja poezi e tregime ngado dhe shpesh, ose në të shumtën e rasteve nuk merresha seriozisht, nuk merrja përgjigje – heshtja më torturonte. Por nuk hiqja dorë, as nuk shaja redaksi në facebook, vazhdoja e shkruaja, deri kur më në fund edhe u botova për herë të parë, të dytë, të tretë...

Ndaj edhe krejt ndryshe nga natyra e përgjigjeve të mia, Elvianës i shkrova gjatë dhe i premtova botimin e kësaj proze të shkruar në një mënyrë që e pëlqeva shumë. I kërkova edhe një shënim për veten, kush ishte. Më nisi këtë:

"*Më quajnë Elivjana Shukulli. Jam 17 vjeç. Vij nga qyteti i Korçës. Jam një gjimnaziste e vitit të tretë dhe studioj në gjimnazin jopublik "Platon". Mes pëlqimit tim për shkencën, një vend të veçantë në zemrën time zë edhe arti i të shkruajturit. Kur shkruaj ndihem e lirë dhe e qetë, sepse arrij të largohem, qoftë dhe për pak minuta, nga zhurma e përditshmërisë. Mbi të gjitha, kur shkruaj, jam vetvetja dhe kjo më fal kënaqësi.*"

Theshte diçka shumë të vërtetë e të bukur, *kur shkruaj ndihem e lirë*. Shkruan për lirinë e saj. Kështu duhet bërë dhe kjo duhet *potencuar* sikurse thonë në Kosovë sidomos sot. Sot kur shkruhet prej urrejtjes, inatit, zilisë, smirës... Shkruhet nga ai pse shkruan dhe ajo, shkruhet nga ajo pse shkruhet nga unë, krijohet një portal pse ekziston një gazetë, ndizen polemika për hir të polemikës e jo të asaj çka e gjithë kjo mund të sjell...

Ne që merremi ditë për ditë me këto punët e letrave qofshim shkrimtar, gazetar a stduiues, mendoj se duhet dhe mund të mësojmë nga dëshira e sinqertë që e shtyn Elivjanën të shkruajë, të harrojmë meskinitetet dhe të shkruajmë për të qenë të lirë, vetvetja dhe për të përftuar kënaqësi.

"ExLibris" i ka çelur dyer për herë të parë shumë shkrimtarëve që më vonë botuan librat e tyre. Ndoshta kjo do të ndodh edhe me Elivjanën. Ky është një ndër misionet, ndoshta më kryesori i gazetës.

Andreas Dushi

100-vjetori i botimit të parë [*Uliksi*: James Joyce]

"ULIKSI" – ROMANI "KATEDRALE"

Nga Feride Papleka

"Mendoni për romanet e mëdha të kohës sonë, mendoni për *Uliksin* e James Joyce-it".
Jorge Luis Borges
L'Art de poésie, Gallimard, Paris, 2000, f. 54.

Është një rrugë në Paris, rruga Odeon, e cila mund të ishte quajtur rruga Uliks, meqë botimi origjinal i romanit monumental Ulysses (*Uliksi*) i James Joyce-it, u mor përsipër të botohej më 1922 nga Sylvia Beach që kishte aty librarinë Shakespeare & Company; përkthimi frëngjisht (*Ulysse*) doli shtatë vjet më vonë nga botuesja Adrienne Monnier, mikeshë e S. Beach. Monnier që nga viti 1916 kishte botuar disa autorë francezë, mes tyre edhe Paul Fort, Jules Romain dhe Roger Caillois, pa harruar edhe një revistë jetëshkurtër, ku botuan autorë si: Blaise Cendrars, Jean Giraudoux, Jules Supervielle, Antoine de Saint-Exupéry. Mund të përmenden edhe miqtë shkrimtarë që frekuentonin librarinë si Guillaume Apollinaire, Colette, Jean Cocteau, Jacques Prevert, Saint-John Perse e të tjerë. Me kulturë të gjerë letrare dhe me kuptimësi për rëndësinë e kësaj vepre, ajo ua besoi punën e hollë e të vështirë të përkthimit dy figurave të njohura si përkthyes të anglishtes e që u rishikua i tërë nga shkrimtari Valery Larbaud dhe nga vetë autori.

I cilësuar nga Borges-i si "katedrale e prozës" (*Parathënie*, Pléiade), ai është çmuar si një nga romanet më të rëndësishme të letërsisë moderne duke zënë vendin e parë në listën e 100 romaneve më të mira të gjuhës angleze në shekullin XX që hartoi *The Modern Library* më 1998.

Përkthimi në shqip i romanit *Uliksi* të Joyce-it nga Idlir Azizi dhe botimi i tij nga Shtëpia Botuese Zenit, mbetet një ngjarje kulturore. Sepse kjo vepër e Joyce-it është si një univers i pafund, me regjistrat gjuhësorë dhe stilet e të shprehurit që përmbledh ligjërimi i tij i panjohur më parë në letërsi. Përkthimi i Azizit është një aventurë e guximshme dhe e bukur, por që ka brenda edhe mundimin, si medalje e pakundërshtueshme e gjithë atyre që i kanë hyrë përkthimit të një vepre të vështirë.

HISTORIKU I VEPRËS

Romani *Ulysses* doli për herë të parë në formën e një rubrike të përjavshme në *The Little Review*[1], në Nju Jork, gjatë muajve mars 1918 dhe nëntor 1920, para se të botohej i plotë në Paris, në shkurt 1922, nga libraria *Shakespeare & Company* (ky do të mbetet i vetmi botim me tirazh të madh i librarisë). Që nga botimi i tij me fragmente në Shtetet e Bashkuara, romani nxiti diskutime, sidomos një ankesë nga *New York Society* për heqjen e pjesëve që u quajtën të turpshme. Madje ajo e cilësoi krejt librin të pabotueshëm. Romani u ndalua në Shtetet e Bashkuara deri në vitin 1933. Pas kësaj ai u komentua pareshtur dhe do të bëhej objekt i studimeve të panumërta.

ULIKSI, VEPËR KLASIKE E SHEKULLIT XX

I pari që e vuri re karakterin enciklopedik të veprës së Joyce-it ishte Ezra Pound-i kur shkroi se "Joyce ka ndërmarrë artin për të vazhduar atje ku e ka lënë Floberi" (*Literary Essays* of Ezra Pound, ed.Faber &Faber, 1920, f. 403). Është e çuditshme kur konstaton sot se edhe Floberi i shkruan të dashurës së tij Luise Colet, një shkrimtare e kohës, kështu: "Librat, prej të cilëve rrjedh një letërsi e tërë, si Homeri dhe Rabëleja janë enciklopedi e epokës së tyre" (Flaubert, *Correspondance II*, Pléiade, 1980, f. 545).

Uliksi është nga ata romane që i jep formë një bote të tërë. Duke qenë një roman total, ai i shumëfishon nivelet e leximit dhe përmbush një program enciklopedik. Nëse flitet për palimpsest, ai është një roman me shumë palimpseste, sepse çdo kapitull dhe çdo episod, siç i quan autori, ka një teknikë e simbolikë të veçantë si dhe një mënyrë rrëfimtare të ndryshme. Studiuesit e veprës dhe jetës së Joyce-it, të cilët kanë parë edhe dorëshkrimin, janë mahnitur, sepse kanë gjetur aty romanin shumëpërmasor. Joyce-i i ka lëvizur nga vendi praktikat e tjera të shkrimit. Valéry Larbaud që u bë bashkëpërkthyes i botimit dhe që shkroi hyrjen, e rrallë për epokën, pyet: "Atëherë ku është çelësi"; që arrihet të shkohet përtej klisheve. Në vend të lexuesit që i hutuar nga orteku i fakteve nuk di të orientohet, ai përgjigjet : "Eh, pra, ai është, si të thuash te titulli *Uliks*".

NDIKIMET

Vepra e Joyce-it ka ushtruar një ndikim të madh te shkrimtarë si Samuel Beckett, Borges, Alain Robbe-Grillet, Salman Ruzhdie, Philippe Sollers, Raymond Queneau, William S. Burroughs, Kerouac, Nathalie Sarraute e të tjerë. Flann O'Brien-i, shkrimtar irlandez e ka protagonist në një roman ku hija e Joyce-it hyn në bisedë me Shën Agustinin.

Një numër i madh kritikësh kanë shkruar se vepra e tij ka nxitur fiksionin modern dhe postmodern duke krijuar breza shkrimtarësh që e braktisën gramatikën, thurjen e ngjarjes, ndonjëherë të palexueshme (si në veprën e Burroughs-it dhe të tjerë të brezit të tij). Disa shkrimtarë si Bernard Shaw ose Paule Coelho janë mjaft të rezervuar për veprën e Joyce-it.

Megjithatë, teoricienët e letërsisë strukturaliste Tzvetan Todorov dhe Gérard Genette dhe të asaj poststrukturaliste, ndër të tjerë Umberto Eco dhe Robert Scholes e shohin Joyce-in si një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të shekullit. Eco e quan *Finnegans Wake* si një « univers ajnshtajnis[2]. Ndikimi i Joyce-it ka lënë gjurmë edhe në fusha të tjera. Kështu fjala "kuark" *Three Quarks for Mister Mark* në *Finnegans Wake*, është në origjinë të fjalës quark (kuark) përdorur në fizikë. Fraza këndohet nga një kor zogjsh deti.

*

Vepra e Joyce-it është bërë objekt studimesh në dhjetëra e dhjetëra libra studimorë, seminare, sesione shkencore dhe konferenca.

Filozofi Jacques Derrida ka shkruar një libër për përdorimin e ligjërimit në Romanin *Uliksi*; filozofi amerikan Davidson e krahason *Finnegans Wake* me tekstet e Lewis Carrol-it; psikanalisti Jacques Lacan i kushtoi seminaret e viteve 1975 dhe 1976;

Nabokov-i e vlerësonte shumë romanin *Uliksi*; ai e zhvilloi atë në kurset universitare midis veprave madhore të shekullit XX, si *Metamorfoza* e Franz Kafka-s apo edh ndonjë tjetër.

Shumë filma janë xhiruar për jetën e Joyce-it dhe Norës, si dhe për vepra të ndryshme të Joyce-it. Midis tyre regjisori amerikan Joseph Strick, më 1983 përshtati për ekranin e madh romanet *Ulysses* dhe *A Portrait of the Artist as a Young Man*.

Është orkestruar edhe një pjesë muzikore për fëmijë, me titull *Një lule për vajzën time*.

Herbert Gorman më 1941 botoi biografinë e parë për Joyce-in.

Richard Ellmann më 1959 botoi një biografi dhe e pasuroi atë më 1982.

Në Dublin, Joyce-i kujtohet duke festuar çdo vit 16 qershorin "Bloomsday".

Që nga 2011 në Monreal mbahet një festival i quajtur Joyce.

Në Dedham (Massachusetts) të ShBA-së në Shëtitoren Joyce, zhvillohen çdo vit veprimtari sportive dhe lexime të veprave të autorit.

Një kopsht në Paris quhet *Kopshti James Joyce*.

Për të ruajtur të gjallë kujtimin dhe veprën e shkrimtarit irlandez, në Cyrih ku ai kaloi një pjesë të rëndësishme të jetës, më 1983 është themeluar nga Fritz Senn *Fondacioni James Joyce*. Ai ka shkruar edhe parathënien e përkthimit të parë shqip të romanit *Uliksi*.

Sot është përkthyer në shqip një pjesë e madhe e veprës së Joyce-it.

KRITIKA FRANCEZE DHE ANGLO-SAKSONE

Uliksi (Ulysses anglisht) konsiderohet sot si kryevepër që e ka merituar shugurimin letrar të Joyce-it. Ai është një roman në lëvizje të përhershme, që përshkruan jetën në një ditë të vetme, në universin e hapur të një qyteti të vetëm, Dublin. Ideja filozofike e tij se jeta është një udhëtim, realizohet edhe nëpërmjet monologut të brendshëm të quajtur *përroi i ndërgjegjes (stream of consciousness)* nga kritika.

Në atë përditshmëri Joyce-i përpiqet të mbërthejë "atë që quhet jetë", në rrethanat historike të modernitetit në shekullin XX duke kapërcyer pengesat gjuhësore dhe duke e zhvendosur objektin e romanit nga rrëfimi i ngjarjeve, në vetërrëfim. Gjuha, dykuptimësia e ligjërimit dhe teknikat e ndryshme të shkrimit që ndryshojnë në çdo episod, përftuan një jehonë të gjerë qysh në fillim kur romani u botua në Francë dhe ndikuan në çmistifikimin e rrëfimit letrar tradicional. « Detyra që i kam vënë vetes teknikisht, është të shkruaj me tetëmbëdhjetë pikëpamje të ndryshme dhe me po aq me stile të gjithën, atë që duket e panjohur ose e pavënë re nga sivëllezërit e mi"[3]. Këto janë gjithashtu tetëmbëdhjetë orët e atij 16 qershori 1904 në Dublin që nis në orën tetë të mëngjesit dhe vazhdon gjer natën vonë.

Edhe pse një pjesë e kritikës e ka cilësuar romanin *Uliksi* si një parodi të poemës homerike, kuptimi i tij është shumë më i thellë. Vladimir Nabokov-i në kursin[4] për romanin, më 1980 shkruante: "*Uliksi* është një vepër e shquar e gjithëkohshme arti, por kritikët janë të interesuar më tepër për konsiderata të përgjithshme dhe ide sesa për veprën në vetvete… Unë duhet t'ju sqaroj se në zhvendosjet e Leopold Blumit atë ditë vere në Dublin, nuk duhet të shihni një parodi të ngushtë të poemës *Odiseja*, ku punonjësi i reklamave luajtka rolin e Odiseut, ku gruaja kurorëshkelëse e Blumit do të ishte e dëlira Penelopë, ndërsa Stiveni do ta shihte veten si Telemaku. Që ka një jehonë të vagullt të përgjithshme homerike në rastin e Blumit është e dukshme, ashtu si e thotë titulli dhe gjithashtu shohim një sërë nënkuptimesh klasike në libër, por do të ishte fare një humbje kohe, po të kërkoje paralele të ngushta me çdo personazh dhe çdo skenë… Prandaj, pas këtyre interpretimeve në shtyp, Joyce-i u detyrua t'i hiqte titujt pseudo homerikë nga kapitujt, sepse e mendoi se çfarë përfundimesh do të nxirrnin gjithë të mërzitshmit, të ditur dhe të paditur."

ZANAFILLA E TEKSTIT

Shqetësimi i Joyce-it për çështjen e formës dhe estetikën e shkrimit është shfaqur mjaft herët. Në fletoret e Parisit ai shkruan: "Ritmi duket se është raporti i parë, domethënë një raport i formës midis pjesëve të ndryshme dhe një të tëre, ose edhe midis cilësdo prej këtyre pjesëve dhe së tërës […] pjesët përbëjnë një të tërë kur ato plotësojnë një qëllim të përbashkët" (25 mars 1903)[5].

Ideja për romanin atij i lindi qëkur ishte duke shkruar *Dubliners* (Dublinasit) më 1903; ai deshi të shtonte edhe një tregim të titulluar *Ulysses*. Madje përcaktoi edhe emrat e dy personazheve kryesore: Stiven Dedalus dhe Leopold Blum. Por kjo ide u la për një vepër më të madhe.

Kemi edhe një gjenezë të dytë të romanit në

1 Revistë e avanguardës amerikane me bashkëdrejtues dhe bashkëpunëtorë Gertrude Stein, Shervood Andersom, T.S. Eliot. Romanin Uliksi të Joyce-it e rekomandoi aty Ezra Pound që ishte bashkëpunëtor për Europën. Revista e cilësonte si një nga veprat më të rëndësishme të shekullit XX, e cila do të transformonte krejt prozën narrative.

2 Umberto ECO, *L'Oeuvre ouverte*, ndarja 1: *La poétique de l'oeuvre ouverte*, Seuil, Paris, 1962, f.97.

3 Letër dërguar H.Weaver-it, 24 qershor 1921 në *Lettres 3 : 1915-1931*, Paris, Gallimard, 1981, f. 194.

4 Vladimir NABOKOV, *Littératures*, Paris, Robert Laffont, 2010, f. 1214. Në kurset e letërsisë në universitetet amerikane (1941-1958), Nabokov-i ka analizuar vepra nga Dickens, Flaubert, Stevenson, Proust, Kafka, Joyce ashtu si edhe ato të autorëve rusë: Gogol, Tourgenjev, Dostojevski, Tolstoi, Çehov dhe Gorki. Ai ka bërë një studim ikonoklast për *Don Kishotin*. Duke hedhur poshtë shumicën e ideve të pranuara për kryeveprat e letërsisë, Nabokov-i pohon me një humor të shkëlqyer dhe ironi konceptet e veta të pavarura. "*Litteratures*" nuk arriti të botohej në gjallje të autorit, por në sajë të një pune të paepur dokumentuese të profesorit amerikan Fredson Bowers, skicat e Nabokovit, shpesh në dorëshkrim dhe shënimet në kopjet e librave që i duheshin për citime në auditor, formuan librin e madh të kurseve universitare, që John Updike, në parathënie i quan Ese.

5 *Pléiade*, v. II, Paris, 1995, f. 901.

vitet që u ndalua në Amerikë nga viti 1921 deri në vitin 1934 dhe në Britaninë e Madhe deri më 1936. Është një aventurë më vete shpërndarja e romanit në mënyrë të fshehtë. Në shumë tregime moderniste dhe në intervista përshkruhet sesi e kanë kaluar përtej detit romanin e botuar në Francë në një valixhe me fund të dyfishtë apo të ndarë pjesë-pjesë, futur midis rrobave duke përjetuar makthin që i mbërthente nëpër dogana. Madje edhe nga Gjermania naziste, vepra mundi të dilte e të kalonte oqeanin prej një profesori amerikan të letërsisë.

NJË PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PËRMBAJTJES

Ngjarja, pra, fillon në mëngjesin e 16 qershorit. Arsyeja përse Joyce-i zgjodhi 16 qershorin është thjesht një datë simbolike e jetës së tij, data kur pati takimin e parë të dashurisë me Nora Barnacle (të cilën e kishte njohur një javë më parë), dhe që u bë bashkëshortja e tij e pazëvendësueshme.

Në dritën e imagjinatës së çliruar nga normat e ngushta letrare, personazhet kryesore jetojnë një ditë të zakonshme në qytetin e Dublinit me detin e tij, me diellin mbi det e me shkollat, me shtëpitë, me kishat dhe varrezat, me gazetat, bibliotekat, baret dhe tavernat, spitalet dhe shtëpitë publike e me të gjithë banorët. Në një anekdotë tregojnë se Joyce-i e ka përshkruar me aq saktësi Dublinin, sa po të ndodhte një apokalips, do të mjaftonte të merrnin romanin e tij për të rindërtuar qytetin ashtu si kishte qenë.

Me tetëmbëdhjetë episodet, ashtu si i ka quajtur Joyce-i, në tetëmbëdhjetë ligjërime përurohen sinoret (vend, pjesë e trupit, ngjyrë, fushë e mendimit ose e veprimtarisë), mënyrat e reja të shprehjes (tregimtari, retorikë, stil gazetarie, vazhdim i formave muzikore, evolucion i gjuhës etj.) si dhe temat që trajtojnë jetën, dashurinë dhe vdekjen, në të cilat përfshihen (shkolla, familja, arti, kultura, tradita, ëndrra, seksi, feja, gjendja politike e shoqërore...). Uniteti i tekstit sigurohet nga përdorimi i pikave të orientimit hapësirë-kohë dhe me teknikën e monologut të brendshëm, që mundëson sjelljen e së shkuarës në të tashmen.

Stiven Dedalusi është njëri prej personazheve kryesore që shfaqet qysh në romanin *Portreti i artistit në rini*. Ai jeton në kullën Martelo me mikun e vet Bak Maligan dhe një tjetër, pak i njohur nga Stiveni, quhet Hajnes dhe ka ardhur një natë më parë, por që del admirues i folklorit irlandez. Dedalusi është një i ri i zhgënjyer, disi pesimist dhe që e neverit shtirja e bashkëkombësve të vet si dhe rregullat e ngurta, prandaj nuk do që t'i shërbejë asnjë ideologjie, madje tallet me Rilindjen gaelike që vepron në rrethet letrare dublineze.

Kur niset atë mëngjes për në punë duke nxituar në ranishtën buzë detit edhe mendimet e tij lëkunden "si valët e detit". Përsiatjet filozofike për realitetin e botës dhe krijimin nga *ex nihilo*, vazhdojnë me kujtimet e Parisit kur lexonte Aristotelin dhe Shën Thomas d'Aquin-in. Ai që kishte synim të bëhej doktor apo shkrimtar, i kupton me hidhërim dështimet dhe vetminë që e shoqëron si artist. Duke menduar për ekzistencën e njëkohshme të Atit të përjetshëm dhe unit "terr që shkëlqen në dritë", ai përhumbet njëkohësisht në vërshimet e ndjesive të një bote në zhvillim të vazhdueshëm. Krenaria e tij e cenuar e shtyn të urrejë trupin, mishin dhe të pohojë një liri të vërtetë shpirtërore. Stiveni është mësues historie. Një nxënës që vjen vonë në klasë, i kujton fëmijërinë duke i ngjallur të kaluarën, dhe e bën të mendojë për dashurinë amnore si të vetmen gjë të vërtetë në këtë botë. Kur mbaron mësimin ai takon drejtorin, i cili i mban një ligjëratë misozhine[1] e antisemite. Në këto rrethana vjen fraza e famshme: "Historia është një makth, nga i cili dua të zgjohem".

Leopold Blumi, personazhi tjetër, Uliksi modern, shfaqet i heshtur, por plot andralla. Gjatë një dite ai do të përjetojë emocione të shumta e të ndryshme. Autor dhe shpërndarës reklamash, ai kryen një punë si gjithë të tjerët. I ati i tij ka qenë një hebre, i ardhur nga Hungaria dhe i kthyer në protestantizëm; aty në Irlandë ai e pati ndërruar mbiemrin në Blum. Pak pas vetëvrasjes së të atit, Leopoldi përqafoi katolicizmin për t'u martuar me një këngëtare


ULYSSES
by
JAMES JOYCE
will be published in
the Autumn of 1921
by
"SHAKESPEARE AND COMPANY"
— SYLVIA BEACH —
8, RUE DUPUYTREN, PARIS — VIe

që shëtit gjithë Irlandën me grupin e saj dhe "në ndryshim nga Penelopa e Homerit, ajo kishte pasur shumë dashnorë", thuhet në një koment, ndër dhjetëra e qindra të tillë që ka ngjallur figura e saj. Ata kanë një vajzë që ka mbushur 15 vjeçe dhe një djalë që jetoi vetëm 11 ditë. Blumi është njeri i thjeshtë, një borgjez i vogël, i sjellë, dashamirës dhe zemërgjerë dhe ne shohim sesi dita e tij ka gëzimet dhe zhgënjimet e saj. Në mbrëmje ai shkon në teatër dhe pastaj në një bordel ku edhe takohet me Stivenin. Aty përjeton disa halucinacione që Joyce-i i përshkruan me mjeshtëri.

Mund të ndalemi në ndonjë temë të poemës së Homerit që autori e risjell me një kuptim të ri bashkëkohor. Bie fjala, tema e Sirenave në të cilën jepet fuqia mizore e kumbimit tingullor, është model i krijimit ku i lihet liri imagjinatës. Për Homerin rreziku e ka burimin te kënga e dy sirenave. Siguristi te Joyce-i "rreziku" janë dy vajza të reja, por përtej tyre, është krejt episodi që nis e këndon. Lexuesi gjendet i magjepsur si Uliksi i poemës dhe i duhet të kthjellohet që të mos tralliset nga hutimi.

STRUKTURA

Joyce-i është ruajtur të mos ketë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me poemën *Odiseja* të Homerit, edhe pse në letërkëmbime ai u ka vënë tituj episodeve për ta bërë sa më të kuptueshëm tekstin. Skemat shpjeguese, të njohura si skema Linati[2] dhe skema Gorman[3] (madje është edhe një emër tjetër më pak i njohur), janë "një lloj çelësi" për të hyrë në vepër. Sipas Genette-it, kjo e bën romanin *Uliksi* një model të "hipertekstit".

Rrëfimi i romanit përbëhet nga tetëmbëdhjetë kapituj, të cilat Joyce-i vetë i quajti episode (Pléiade, faqe LXXIV), të ndara në tri pjesë të mëdha: duke rimarrë emrat nga poema *Odiseja*, si: *Telemak, Odise* dhe *Nostos* (Pléiade, f. LXXXI-LXXXIV), ose sipas skemës tjetër me tri metafora: *Aurora*, *Mëngjesi*, *Mesnata*, (Pléade, f. LXXVI-LXXX).

Pjesa e parë *Telamakiada* (sipas skemës Linati) përmban tri episode. Veprimi përqendrohet rreth Stiven Dedalusit, personazh që përfaqëson fushat shpirtërore dhe intelektuale, pra, atë që është e palëndët te njeriu, figurë që njëjtësohet me Joyce-in, si një vazhdim i jetëshkrimit *Portreti i artistit në rini* (Pléiade, f. LXXIV-LXXXIV), i cili mbyllej me fjalët e artistit :*"Do të farkëtoj në kudhrën time ndërgjegjen e paformuar të racës njerëzore."*

Pjesa e dytë zhvillohet në dymbëdhjetë episode dhe është pjesa më e rëndësishme e veprës. Aty gjejmë personazhin Leopold Blum, zëdhënës i fushës materiale dhe ndijimore të njeriut, Gjatë gjithë romanit, shtegtimet e Uliksit mund të ilustrohen në mënyrë hipotetike me zhvendosjet e Leopold Blumit në qytetin e lindjes. (Pléiade, f. LXXIV-LXXXIV).

Pjesa e fundit, e treta, përbëhet nga tri episode. Aty shfaqe sërish poeti i ri niset në kërkim të fatit. Monologu i fundmë i Mollit është quajtur më tepër një shtojcë sesa një episod.

Nga ndjesia e pikëllimit dhe zemërimit në hapje, kalohet në atë të gjendjes absurde e të lodhur në pjesën e dytë, për t'u mbyllur me pjesën e tretë muzikore. « Qëllimi im është të transpozoj mitin *sub specie temporis nostris*. Çdo aventurë nuk duhet vetëm ta kushtëzojë, por madje ta krijojë teknikën e vet»[4].

Veprimi në roman realizohet përmes gjuhës, nisur nga një skemë gjigante njerëzore. Disa komentues janë përpjekur ta minimizojnë fare rëndësinë e skemave të Joyce-it (Ezra Pound, kritiku i tij i parë, mendonte se është fjala për kombinime të pjesëve). Nga bisedat me Frank Budgen[5] shpërfaqet ideja se duke u nisur nga skema, Joyce-i kishte parasysh krijimin e një totaliteti imagjinativ historiko-kohor. Një skemë e tillë gjendet edhe te *Komedia Hyjnore*. Lacan-i ishte mahnitur nga kjo lloj skeme. « Që çdo kapitull i romanit *Uliksi* kërkon të mbahet me një lloj suazimi [...] është domethënëse, sepse lidhet me lëndën e asaj që tregon" [6].

INTERPRETIMI

Mëngjes qershori. Ditë me dritë të artë, me qiell të kaltër, me rrugë që zgjohen. Një ditë e re dhe një odise e re për njeriun. Stiven Dedalusi nuk ka shumë kohë që është kthyer nga studimet, ai është edhe i trishtuar edhe i gëzuar.

Ky është epilogu i romanit. Sipas kritikës kemi një lindje plot histori që e marrim vesh jo në një vijë rrëfimtare kronologjike, por në prerje horizontale. Pastaj shfaqet Leopold Blumi. Lexuesi i njeh historinë dhe jetën e personazheve si në një vepër të pikturës baroke në të cilën përdoret "edhe impresionizmi edhe kubizmi".

Përmes monologut të brendshëm ne takojmë shumë personazhe hije, të afërt dhe miq të këtyre personazheve, të vdekurit e Blumit të atin dhe të birin, miqtë e tij të rinisë, të atin dhe të ëmën e Stivenit dhe figura të tjera episodike. Sido që monologu i brendshëm nuk është mbizotërues dhe nuk përdoret i pashoqëruar me një ligjëratë të zhdrejtë, ai në të vërtetë mbetet shenja më dalluese e romanit. Vetëm monologu i Mollit në mbyllje është mbase i vetmi monolog i pastër.

Tetëmbëdhjetë episodet e romanit që përurojnë një grup të ri elementesh, janë një konceptim i ri të shkruari në fillimet e shekullit XX. Uniteti i veprës sigurohet nga përdorimi i shenjave dalluese, hapësirë-kohë dhe nga teknika e monologut. Romani është gjithashtu shumësi simbolesh dhe nënkuptimesh për historinë e mendimit perëndimor. *Uliksi* vetë **është një titull simbolik, ashtu si edhe personazhi kryesor, Leopold Blumi, i cili shndërrohet në simbol. Ai është hebre, përfaqësues i një populli me fat dramatik**[7]. Në parathënien[8] e botimit të parë, vendosjen e Blumit në qendër të romanit, përkthyesi I. Azizi e quan "akt themelor politik".

Ndryshe nga bashkëkohësit e vet shkrimtarë, Joyce-i nuk rrëmbehet nga përsiatjet morale dhe shoqërore. Në roman narracioni organizohet si kaos i një subjektiviteti fatmirësisht përparimtar, me një ironi që pastron vetëdijet, me një fragmentim të ngjarjeve dhe kujtimeve, ashtu si në jetë; ky model do të arrijë kulmin me *Romanin e ri* në Francë. Joyce-i kryqëzon idioma, vende, fjalë, ligjërime nën diellin e patriotizmit irlandez, shtegtime, këngë të trupit dhe shpirtit njerëzor, ngjyra dhe takime qytetërimesh, në të vërtetë të përziera prej kohësh. Të gjitha nën shigjetën sarkastike të deheroizimit të jetës në një përditshmëri natyrore të vjetër sa bota dhe në një vend të përbashkët ku kryqëzohen fatet njerëzore.

Nabokov-i ishte një lexues i vëmendshëm i Joyce-it. Ai e quante dhunti të veçantë shpikjen e fjalëve, lojën dhe tingëllimin e tyre. Por një moment që i kishte lënë shumë mbresa dhe që e komentonte në kurset e tij si një ide që do të formonte breza burrash të emancipuar, është ai kur Blumi i sjell mëngjesin në tabaka Mollit. Këtë pasazh ai e quante si "më të madhin e gjithë letërsisë". Në këtë cilësim përzihej entuziazmi i shkrimtarit, lexuesit dhe ligjëruesit në katedrën e letërsisë.

*

Kritika thotë se ka një poetikë universale ligjërimi te vepra e Joyce-it. Domethënë se mund të ekzistojë një Libër, forma e të cilit të shpjegojë ide universale. Umberto Eco e ka quajtur vetë titullin një "formë shprehëse" që flet për përmbajtjen. Kur Joyce-i kërkon të dënojë paralizën e jetës irlandeze[9] dhe, përmes saj paralizën dhe shkërmoqjen e botës, për shembull, ai regjistron fjalitë e zbrazëta të mbushura me një vetëbesim të tepruar të gazetarëve, pa dhënë vetë asnjë gjykim. Gjykimi qëndron thjesht te forma e kapitullit, në të cilin rigjejmë të gjitha figurat retorike dhe ku frazat e bisedës u përgjigjen paragrafëve, titujt e të cilëve na kujtojnë ata të artikujve të gazetave; një lloj retrospektive titujsh të gazetës viktoriane të mbrëmjes plot skandale. Umberto Eco e lidh këtë formë rrëfimi me një lloj epifanie. « Nuk bëhet fjalë më për magjepsje nga një epifani vegim, por për një epifani strukturë me përmbajtje të qartë karteziane"[10].

Forma e romanit është "ujdisur" që në kohën e Aristotelit me poetikën e një intrige që sa vjen dhe zhvillohet në kohë. Përkundrazi Joyce-i realizon një formë shkrimore me prerje horizontale, në të cilën brenda një dite ngërthehen kohërat: Antikiteti, Mesjeta, Moderniteti, madje jashtë përsiatjeve dhe bisedave nuk mbeten as *Upanishadat* që është faza e fundit e Vedave dhe që sipas filozofisë

1 Misogine (fr. me burim grek): Që urren ose përçmon gratë.

2 Carlo LINATI, shkrimtar dhe kritik italian (në *James Joyce, Œuvres complètes*, Gallimard, « Bibliothèque de la Pléiade », 1995, v. II, f. 910-911.

3 Herbert GORMAN, shkrimtar dhe biograf amerikan.

4 Letër dërguar Carlo Linati-it, 21shtator 1920 (në *James Joyce, Œuvres completes...* (vepër e cit.). Po aty.

5 Frank Spencer BUDGEN (1882 - 1971), piktor, shkrimtar dhe veprimtar socialist. Budgen dhe Joyce kanë kaluar shumë kohë bashkë në Zvicër, sidomos gjatë Luftës I botërore. Libri i tij me kujtime *James Joyce and Making of Ulysses,* 1934, përshkruan diskutimet e tyre të shumta rreth problemeve estetike të krijimit. Si piktor Budgen-i ka realizuar mjaft portrete të James Joyce-it.

6 Jacques LACAN, Le Séminaire, livre XIII, *Le sinthome*, Seuil, Paris, 2005, f.65.

7 Kur botoi Joyce-i romanin, shteti i Izraelit nuk ekzistonte.

8 Mendoj se ajo parathënie duhet ta shoqërojë librin në të gjitha ribotimet.

9 "Banorët e Dublinit janë bashkëkombësit e mi... por ata përbëjnë një racë sharlatanësh ... Dublinasi e kalon kohën duke dërdëllitur dhe duke shkuar nga kafeneja në kafene, në taverna dhe në bordel...". Citim nga një letër e Joyce-it në librin e Richard Ellmann-it, *Joyce.*

10 Umberto ECO, *L'Oeuvre Ouverte,* Du Seuil, Paris, f. 221.

Hindu shpreh te njeriu esencën shpirtërore të ndarë nga trupi.

Te *Uliksi* veprimet pa ndonjë rëndësi të jetës së përditshme, përftojnë vlera narrative. Perspektiva aristoteliane gjendet kështu e përmbysur; ajo që më parë ishte e dorës së dytë, bëhet kryesore. Aty nuk janë më gjërat e mëdha që ndodhin, por gjërat e vogla që shumohen përbëjnë ngjarjen. Herë-herë në roman ka biseda serioze, herë-herë dëgjohen thirrma vulgare ose shprehje formale, pa kuptim, herë-herë stili kalon në Yiddish ose në një gjuhë të pakuptueshme. Vështrimi i rastësishëm, mendimet dhe gjestet e atypëratyshme, marrin formën e një lloj automatizmi të jetës dhe janë lënda e parë për shkrimtarin. Sepse "arti është mënyra njerëzore për t'i dhënë lëndës së dukshme apo të padukshme një qëllim estetik" (Joyce, *Fletoret* e *Parisit*, 1905).

Kritiku Ernst R. Curtius shkruan se "*Uliksi* ka në bazë një nihilizëm metafizik; te ai makrokozmosi dhe mikrokozmosi prehen në zbrazëti dhe se qytetërimi katandiset në hirnajë si në një kataklizmë kozmike. Nihilizmi i tij është i lidhur me rregullin irracional"[11].

"Çrregullimin" në veprën e Joyce-it disa studiues e quajnë art, sepse çrregullimi aty jepet sipas një rregulli. Me këtë "gjenialitet të formalizmit", autori ia del të sigurojë ekzistencën e botës së re që ka zbuluar vetë. Pikërisht këtu qëndron shpikja kryesore në roman.

Metoda e Joyce-it që ndërton një monolog të përzier me përshkrimin e gjesteve dhe të historisë, është më afër krijimit poetik. Këtë e ka shpjeguar Budgen[12] që e vlerësonte mënyrën e paraqitjes psikologjike të personazheve te romanit. Në librin me kujtime ai shkruan " Metoda e thurjes së elementeve në prozën e Joyce-it ishte më shumë ajo e një poeti sesa e një prozatori. Fjalët që përdorte, ai i kishte të gdhendura thellë në mendje, para se të merrnin formë në letër". Budgen kujton edhe se, ndërsa njëherë e pyeste për ecurinë e romanit, Joyce-i i ishte përgjigjur se "kishte punuar gjithë ditën për të shkruar dy fraza". Dhe kishte shtuar se "i kishte tashmë në kokë fjalët, por i duhej të gjente rendin ideal". Ja dhe dy frazat: "A warm human plumpness settled down on his brain. His brain yielded. Perfume of embraces all him assailed. With hungered flesh obscurely, he mutely craved to adore. " (*Ulysses*, f. 637). Por përkthimi e ka të pamundur në cilëndo gjuhë qoftë, të ruajë rendin e fjalëve për shkak të zhvendosjes të theksit. Në anglisht fragmenti paraqitet si prozë poetike.

Shembujt e ndryshëm nga romani tregojnë se më shumë është fjala për një poetikë të brendshme të frazës sesa për një teknikë të mirëfilltë poetike. Ai është një art poetik që shpaloset mezidukshëm, një art që trazon dallimet e zakonshme mes poezisë dhe prozës. Valéry Larbaud shihte në këtë teknikë mjetin që Joyce-i të shkruante në mënyrë të natyrshme dhe ta zvogëlonte sa më shumë intrigën.

"Poetika e tij e re nuk ndalet vetëm në shfrytëzimin e sferës së unit lirik në gjendje nistore si në prozën e Woolf-it", por përfshin një material të shtrirë në hapësirë dhe kohë. Kritika shënon se shqetësimi i Joyce-it për tekstin nuk kishte të mbaruar. Ai dëgjonte me vëmendje dhe shënonte fjalë, të cilat i duheshin dhe kishte besim te ylli i frymëzimit të tij. Gjithçka që grumbullonte, e përdorte në kohën dhe në vendin e duhur. Dhe meqë *Uliksi* pati si temë jetën në të gjitha pamjet e saj, nuk kishte kufi në përdorimin e elementeve të ndryshme që do të luanin rol në ndërtesën e tij krijuese: ngjyrat e ditës; të qiellit; një parodi; emri i veçantë i një peshku; metodat që përdoreshin për dënimin e marinarëve në anijet shkollore; një frazë e pambaruar; ngërçi nervor i një të ftuari që vizatonte në gotën e tij rrathë bashkëqendrorë; një shaka në një sallë muzike, bisedat nacionaliste… Shkrimtari dhe kritiku Wyndham Lewis thotë: « Kjo është një metodë natyraliste e çuar gjer në makth të përkryer". Në këtë kuptim *Uliksi* lajmëron *Finnegans Wake*. Lexuesi e vë re se gjuha është ajo që shpesh i strukturon perceptimet.

11 Ernst Robert CURTIUS (1886-1956) , një prej figurave të mëdha të kulturës moderne europiane. Filolog dhe profesor letërsie në disa universitete të Gjermanisë, ai bëri studime për shumë autorë si Paul Valéry, Maurice Barrès, Valéry Larbaud, Paul Clodel, Marcel Proust, James Joyce, Emerson, T.S. Eliot, Hugo von Hofmannsthal e të tjerë. Ai është autor i veprës së shquar "*Letërsia europiane dhe Mesjeta latine*".

12 Frank Spencer BUDGEN, *James Joyce et la création d'Ulysse*, (përkth. nga angl.), Denoël, Paris, 2004, f.137.

Sylvia Beach dhe James Joyce në librarinë Shakespeare & Company me rastin e daljes nga shtypi të Uliksit (1922)

*

Joyce-i ka përfituar nga realizmi psikologjik i personazheve letrare, sidomos i atyre të shekullit XIX, por ai e ndërthur këtë në ekuacionin veprim / monolog. Ne shpeshherë lexojmë mendimet e një personazhi që përshkojnë monologun e një tjetri : përputhje të habitshme bëjnë që Blumi të mendojë atë që Stiveni kishte thënë për Shekspirin. Edhe Lacan-i e përmend këtë gjë. Ndonjë kritik hamendëson se Joyce-i ka për qëllim të vërtetojë një lloj transmetimi telepatik midis Blumit dhe Stivenit. Bie fjala, Stiveni në bibliotekë dhe Blumi në episodin "Sirenat" mendojnë pak a shumë të njëjtën gjë: poetika e trishtimit, roli i muzikës, vargje nga vepra e Shekspirit. Është fjala për një kryqëzim idesh: gjithçka ndodh sikur Joyce-i donte të thoshte se ekziston një nënvetëdije kolektive. Prandaj është e pranueshme për të gjithë kritikët xhoisjanë të flasin për një instancë të një narracioni specifik midis narratorit dhe autorit. Ai shfrytëzon mundësitë që krijon struktura e ligjërimit e bazuar mbi një lloj dialogjizmi me ndërhyrje që janë thyerje logjike në ligjërim.

Për Joyce-in "bota e re", e re në kuptimin që të ndërmarrësh një punë që nuk është provuar gjer atëherë, është më tepër « më e mira e botëve" të përhershme që rrjedh si lumë. Humori aty është i pranishëm çdo çast edhe pse gjejmë medoemos pesimizëm, hidhërim, keqardhje apo ironi. Humori shërben për të yshtur ankthin e vdekjes. Ndaj edhe dëgjojmë pareshtur të qeshura në të gjitha tonalitetet, një e qeshur që përfshin gjithësinë.

Kjo epope e *Uliksit*, e simbolizuar me një çifut hungarez, i shtënë pas shkencës, të cilit i



bashkohet artisti Stiven Dedalus, i përhumbur në ankthin e Historisë është e jashtëzakonshme. Një pjesë e romanit shquhet për monologun e brendshëm të personazheve, pjesa tjetër për një parodi stilistike dhe autonomie gjuhësore në raport me "subjektet", derisa gjuha bëhet vetë subjekt. Kështu kur përshkruan një skenë në maternitet Joyce merret me evolucionin e letërsisë angleze. Të gjitha shënimet që ka lënë ai, flasin për një enciklopedi të kulturës dhe historisë. Risjellja e së kaluarës në të tashmen, na kujton formulën e Dekartit : Mendoj, pra, jam[13], mënyrë faustiane për të kapërcyer tmerrin total. Jacques Derrida tregon se Emmanuel Levinas thoshte se Uliksi është "hero shumë hegelian". Në esenë *Uliksi gramafon,* ndër të tjera, Derrida shkruan: "Nga njëra anë, vepra (*Uliksi*) e Joyce-it është një makinë shkrimtarie, një korpus, në të cilin shpalosen dhe ndërthuren të gjitha: ligjërimet, gjuhët, dija. [...] Nga ana tjetër thjeshtësia e saj dhe mënyrat e tërthorta të paraqitjes, bëjnë që të triumfojë autori dhe gjithçka merr pjesë pastaj për ta bërë të pamundur deshifrimin e tekstit. E shkruar në një përzierje gjuhësh, vepra mban gjallë pështjellimin. [...] Ajo lë te lexuesi gjurmë të pashlyera duke e transformuar (nëse ia del ta lexojë; në më të shumtën e rasteve nuk ia del dot).Dhe lexuesi pret nga libri një zë profetik. Libri është si një thirrje në telefon që thotë: "Alo, jam këtu, po të dëgjoj".

PËRFUNDIM

Duke shkruar *Uliksin*, James Joyce-i kreu një udhëtim gjuhësor që zgjati tetë vjet e që u kurorëzua me një kryevepër botërore. Prandaj krijesat e Joyce-it ia behin nga hapësira e rrëfimit me gjithë plotërinë e tyre duke fituar lëndën prej mishi dhe kocke, jo të një demiurgu, por të një njeriu që është i mbërthyer thellë në "jetën e vërtetë".

Uliksi është një roman total, me një ndërtim shumëpërmasor që ka bashkuar disa regjistra shkrimorë për të shumëfishuar nivelet e leximit. Duke ecur në gjurmët e Homerit, por nga ana e kundërt e epikës, Joyce-i tregon jetën e zakonshme, komike dhe tragjike njëherësh, betejën ekzistenciale të njeriut. Uliksi i sotëm përmbledh në një ditë të vetme në Dublin, dhjetë vjetët e endjes së Uliksit homerik. Epopeja moderne është "parodike [...] e mishëruar te personazhi Leopold Blum, i cili nuk ka asnjë përmasë heroike në veprime, por vetëm në ëndrra. Bota në të cilën jeton ai është një pështjellim në vogëlsinë e vet dhe në përmasat mediokre"[14]. Forca e Blumit është të mos mposhtet nga negativja p<r t< siguruar vazhdimësinë e njerëzimit.

Para së gjithash romani është një sfidë vetjake për autorin, e cila mishëron një betejë gjuhësore në kërkim të fjalëve, prandaj është quajtur aventurë gjuhësore. Sintaksë, strukturë, tingull dhe stil, çohen gjer në atë pikë, sa fjalët dhe shkronjat e tyre fitojnë një jetë të pavarur. Simbolizmin që përshkon gjithë romanin dhe portretet psikologjike realizohen me anë të gjuhës. I syrgjynosur vullnetar i vendit dhe i gjuhës së tij, Joyce-i sajon gjuhën e vet, një gjuhë tjetër që e përvetëson, një gjuhë të krijuar prej tij që e shtyn lexuesin deri në kufijtë e të padukshmes. Thyerja e raporteve shkrimore të vendosura nga një traditë mijëvjeçare ishte guxim i madh krijues. Shkrimi i tij imiton shpërfaqjen e një mendimi të vetvetishëm.

Ecuri teknikash dhe lojërash gjuhësore, Uliksi i Joyce-it do të shquhet, ndër të tjera, për përdorimin e shkëlqyer të "përroit të ndërgjegjes", që mëton të përshkruajë pikëpamjet e personazheve si një barasvlerë të mendimit të tyre.

Të lexosh *Uliksin* është një përvojë e papërsëritshme, sepse ai është edhe një udhëtim i brendshëm që na përball me një pjesë të unit tonë të panjohur. Joyce-i e vendos subjektin para një pasqyre në të cilën mund të humbasësh ekuilibrin nga e vërteta e zbuluar, por që është edhe e vërteta jonë. Thuhet se Joyce-i e mbrojti njëherë të vetme romanin me thënien e papërsëritshme dhe magjiplote: "Atëherë, po të mos lexohet *Uliksi*, duket thënë se nuk duhet të jetohet jeta".

Efekti i "çuditshëm" i romanit lidhet me dendurinë e stilit, i cili është ekstravagant dhe plot kolorit. Këto "ushtrime" stilistike, nëse do t'i quajmë të tilla, nuk mbeten të ngujuara në një botë ëndrrash të ndarë nga jeta: ato hyjnë befasisht në mes të një historie që vazhdon të shtjellohet me gjakftohtësi në mes të një deti kulture. Dhe është kjo lëvizje kontradiktore me rënie dhe ngritje që e shndërron këtë tekst në një stinë të madhe jetësore ku jepen edhe qëndrimet kundër kishës dhe institucioneve, kryesisht ndaj Kishës katolike dhe Shtetit.

"Cilat janë arsyet e një suksesi botëror të *Uliksit*?"- pyet Typhaine Samoyault, kritike dhe profesore e letërsisë në universitetin Paris 8, e cila ka marrë pjesë në grupin e tetë përkthyesve të romanit për botimin e ri më 2004[15]. "Duke u bërë botëror, *Uliksi* është shkëputur nga kufizimet kombëtare, por gjithashtu edhe nga pozicioni i tij jashtëqendror duke e transformuar thellësisht idenë e autoritetit letrar. Joyce-i ka emancipuar gjuhën dhe kombin",- përgjigjet vetë ajo. Kurse Philippe Forest , edhe ky profesor letërsie dhe studiues i vepërs xhoisjane në ditë tona, mendon se "*Ulysse*" nuk është një libër i palexueshëm", ashtu si thuhet rëndom, "por një libër i lexueshëm; ai flet për jetën e atij që lexon dhe të atij që shkruan".

Në të vërtetë, qysh nga botimi i pjesshëm dhe deri në ndalimin e tij të plotë kemi një mungesë perspektive botimi, por njëkohësisht edhe një veprim çlirues, thotë kritika. Censura solli një solidarësi të veçantë me librin. Kemi gra të guximshme botuese si Margaret Anderson në Amerikë dhe Silvia Beach në Francë, postierë që rrëmbejnë kopje të revistës *Little Review* pas dënimit ku është botuar *Ulysses*, ka gjyqtarë dhe botues që e mbrojnë librin. Sigurisht ka edhe doganierë që zbulojnë kopje të librit dhe i djegin.

Por është për t'u theksuar, se botues me emër kanë luftuar ta heqin censurën mbi librin duke marrë pjesë me guxim në një proces të madh gjyqësor në mbrojtje të romanit për vite të tëra. Prandaj mund të thuhet se romani mbarti një fuqi transformuese: "*Uliksi* ka karakter transformues, ai nuk ka ndryshuar vetëm rrjedhën e letërsisë, por edhe përkufizimin e letërsisë në sytë e ligjit"[16].

Vepra e Joyce-it karakterizohet kryesisht nga një zotërim mahnitës i gjuhës dhe nga përdorimi i formave letrare të reja, të shoqëruara me krijimin e personazheve si Stiven Dedalus, Leopold Blum dhe Molli Blum që janë individualitete të një humanizmi të thellë.

Burimet: Veprat kryesore të Joyce-it, botimet *Pléiade* dhe arkiva *Universalis*.

13 Cogito ergo sum (lat.)

14 Robert LOUIS, *James Joyce, Une epopee parodique*, Magazine Littéraire, Paris, janar, 2004, f. 55.

15 Përkthimi i ri i romanit u bë më 2004 nga Shtëpia Botuese Gallimard, Paris, me një grup prej tetë vetësh të formimeve të ndryshme universitare, kryesuar prej Jacques Aubert.

16 Kevin BIRMINGHAM, *The Most Dangerous Book: The Battle for James Joyce's Ulysses,* 2014, f. 92.

BASHKIM HOXHA

ASNJËHERË TË MARTËN

OnufriRoman